



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.
2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
3. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës, Elva Margariti, Ministre e Kulturës.
4. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë, zonja Dajna Sorensen (për arsimin profesional).
5. Seancë dëgjimore me RTSH-në për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.
6. Seancë dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.
7. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2020” me Akademinë e Studimeve Albanologjike.
8. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2020” me ATSH-në.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Sot mbledhjet në komision janë të përcaktuara në disa seanca.

Fillimisht do të diskutojmë dhe do të miratojmë kalendarin për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Para se të fillojmë me kalendarin, shoh se kemi një anëtar të ri në komision, zotin Erion Piciri.

Mirë se erdhët, zoti Piciri! Punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fillojmë me diskutimin dhe miratimin e kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Ditën e sotme, në orën 10:00-11:00, është parashikuar diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës Besa Shahini, ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Në orën 11:00-12:00 kemi diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës Elva Margariti, ministre e Kulturës.

Në orën 12:00-12:30 është parashikuar diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë, zonjës Dajna Sorensen, lidhur me arsimin profesional.

Në orën 12:30 është parashikuar një seancë dëgjimore me RTSH-në për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Në orën 13:00 kemi një seancë dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Në datën 15.11.2019, në orën 10:00-11:00, është parashikuar seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të Tiranës.

Në orën 11:00-12:00 është parashikuar një seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të rretheve.

Në orën 12:00-13:00 është parashikuar një seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Akademinë e Shkencave dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Në orën 13:00 është parashikuar një seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me ATSH-në.

Raporti për diskutimin në parim do të dorëzohet në Komisionin e Ekonomisë brenda datës 20 nëntor.

Në datën 25 nëntor 2019, në orën 10:00-11:00, është parashikuar seancë dëgjimore me sindikatat për arsimin: me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimitarëve.

Në orën 11:00 është parashikuar një seancë dëgjimore me shoqërinë civile, ku kemi të ftuar Shoqatën e Botuesve Shqiptarë; për arsimin kemi Koalicionin për Arsimin në Shqipëri (ACE); Shoqatën e Prindërve për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, Organizatën Ballkan-Egjiptiane të Shqipërisë; Shoqatën e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, Down Syndrome Albania Foundation, si dhe Qendrën “Për arsimin cilësor”.

Në datën 26.11.2019 është parashikuar diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Raporti për diskutimin nen për nen do të dorëzohet në Komisionin e Ekonomisë brenda datës 4 dhjetor.

Në lidhje me kalendarin e punës për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, mund të them se është tepër i ngjeshur.

Në fakt, sot kemi parashikuar t’i nisim seancat dëgjimore me ministren e Arsimit, zonjën Besa Shahini, ndërkohë që nga Ministria e Arsimit ende nuk ka ardhur raporti apo relacioni. Deputetët duhet të njihen me relacionin. Ne nuk jemi njohur me relacionin. E njëjta gjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pak kohë në dispozicion, por e njëjta gjë është edhe për ne. Pak kohë kemi në dispozicion për të shqyrtuar raportet dhe mbi të gjitha për të nxjerrë konkluzionet për këtë buxhet.

E njëjta gjë edhe për Ministrinë e Kulturës. Ndërsa kemi një relacion, që është paraqitur dje vonë nga zëvendësministri e Financave dhe Ekonomisë.

A ka ndonjë vërejtje për kalendarin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Doja t’i bëja me dije komisionit që ne kemi miratuar, sipas prioriteteve që ka edhe kalendari i Kuvendit, dy kalendarë pune, që lidhen me dy akte për të cilat ka përgjegjësi komisioni ynë, projektbuxheti dhe paketa për amendimin e ligjit të medieve audiovizive, për të cilin kemi rënë dakord të bëjmë edhe një kalendar.

Për arsye të prioriteteve, mendoj se duhet të bëhet me dije që ne i kemi dhënë prioritetin numër nr.1 projektbuxhetit, i cili ka një datë të caktuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit, si dhe prioritet kalendarit të amendimeve të ligjit për mediat audiovizive, i cili akoma nuk ka një datë punimesh në kalendarin e Kuvendit.

Kështu që, edhe për ta ndarë me kolegët deputetë këtë, ramë dakord për një kalendar, por për arsye të prioriteteve ne përshtatëm kalendarin, ndaj dhe po marrim një vendim për kalendar punimesh për projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2020” në këtë mbledhje komisioni.

Fatjona Dhimitri – E kuptoj, por nuk kuptoj gjithë këtë lloj urgjence për t’i ngjeshur dëgjesat vetëm për ta kaluar buxhetin 2020 brenda afatit të parashikuar nga qeveria në seancën plenare. Ne ende nuk kemi raportet e ministrive përkatëse e më tej për t’i dëgjuar ato.

Si mund të realizojmë dëgjesa pa pasur relacionet përkatëse?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Na demotivoni ju me këto lloj papërgjegjshmëri dhe mungesash.

Megjithatë, nuk mendoj se prania e raporteve, qoftë nga Ministria e Arsimit, qoftë nga Ministria e Kulturës, mund ta shmangë kaosin ku është zhytur arsimi apo kultura në vendin tonë në këta 6 vjet qeverisje.

E hedhim në votim projektkalendarin.

Kush është pro? Kundër?

Me shumicë votash miratohet kalendar.

Në orën 10:00 do të kemi të pranishme, shpresoj, ministren e Arsimit. Më tej do të vijojmë me paraqitjen e raportit për buxhetin e vitit 2020.

Faleminderit!

Po, medie, për pak do të jeni të pranishme.

Faleminderit për prezencën tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në momentin kur do të vijë ministrja. Më mirë ashtu...

Besoj se edhe 10 minuta do të kemi mundësi dhe kohë të presim. Unë e kuptoj që mezi prisni, por sa të vijë ministrja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, patjetër.

Do të flasësh, Erion?

Erion Piciri – Deri sa të vijë ministrja e re, është mirë të dëgjojmë edhe ish-ministren, që ka një përvojë të gjatë, për mënyrën se si e shoh buxhetin e ri të arsimit. Kështu që, nja dytri fjalë nuk do të ishin keq. Ta kuptonim edhe ne në qoftë se edhe brenda Partisë Socialiste ka më shumë rryma. Buxheti për arsimin e lartë më duket se është diku te 2,2%, apo jo?

(Deputetja Lindita Nikolla flet pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Unë këtu jam si relatore e vendimmarrjes së këtij komisioni.

Para se të kalonim tek ajo që po ndodh me buxhetin që i takon arsimit, sportit dhe rinisë, mendoj se do të ishin të nevojshme, nëse e çmon komisioni kështu, pak fjalë për buxhetin në tërësi. Më pas, patjetër, të respektojmë edhe dëgjesën e ministrave, për të konkluduar me opinionin dhe vendimmarrjen e komisionit. Në qoftë se nuk shihet e nevojshme, patjetër, ju e keni relacionin përpara dhe e çmoni ju. Kur them “ju”, e kam fjalën për komisionin, jo për ju personalisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Brenda afatit të parashikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duke qenë se kemi vendosur orare, besoj se do t’i respektojmë ato.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duke qenë se është një ditë e ngarkuar, është menduar t’u lihet nga një orë dy ministreve, gjysmë ore zëvendësministres dhe më pas do të vazhdojmë me nga gjysmë ore me dëgjesat e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besoj se do të lihet një hapësirë për pyetje dhe diskutime.

Milva Ekonomi - Zoti Piciri, a mund t’ju jap një sugjerim, shumë miqësisht? Ju mund ta keni parasysh këtë, por kur fillova punën si deputete, një nga gjërat që më ishte bërë si libër

ishte e Rregullorja e Kuvendit për punën në komision, sepse ka gjëra të vogla, për të cilat herë pas here duhet t'u kthehesh...

(Deputeti Erion Piciri ndërhyr pa mikrofon.)

Nuk e kam për rastin konkret, por në përgjithësi.

(Deputeti ndërhyr pa mikrofon.)

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 09.50

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Besa Shahini - Ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,

Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Mirela Bimo - drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë,

Ina Dhaskali- përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave,

Lorisa Kushi – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri – Ashtu sikundër e parashtrova në fillim të mbledhjes së komisionit, sot kemi të pranishme në komision për dëgjuesë për buxhetin e vitit 2020 zonjën Besa Shahini, ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; zonjën Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe zonjën Mirela Bimo, drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Zonja Ministre, mund të vijojmë me dëgjuesën për buxhetin e vitit 2020, por pse nuk keni sjellë një relacion në komisionin tonë? Unë e kuptoj që koha është shumë e kufizuar, por kjo nuk është vetëm për ju, por edhe për ne që do ta studiojmë atë relacion.

Besa Shahini – Faleminderit!

Unë mendoj që përgjigjen për pyetjen që bëtë ju e dhatë vetë. Koha ishte jashtëzakonisht e shkurtër për të përgatitur një relacion të detajuar.

Fatjona Dhimitri – Ju duhet ta kishit përgatitur paraprakisht.

Besa Shahini – Koha ishte jashtëzakonisht e shkurtër për të përgatitur një relacion të detajuar në formën që mund t'ju hyjë juve në punë. Besoj që të gjithë e kemi pasur ...

Fatjona Dhimitri – Ju keni qenë në dijeni që do të diskutohej buxheti dhe mund ta kishit përgatitur paraprakisht një relacion të tillë.

Besa Shahini – Unë jam e bindur që e kemi pasur të gjithë projektbuxhetin që do të diskutohet. Ju vetë keni bërë leximin dhe analizat e nevojshme, kështu që besoj se sot këtu mund të bëjmë një diskutim të mirëfilltë së bashku.

Ju falenderoj për ftesën për të prezantuar projektbuxhetin e vitit 2020! Unë mendoj që është e qartë, edhe nga leximi që ju i keni bërë projektbuxhetit, se për qeverinë tonë prioritet ishte dhe mbetet arsimi. Kemi pasur një rritje të vazhdueshme të buxhetit për arsimin, i cili është reflektuar në të gjitha fushat që mbulon jo vetëm Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por edhe të gjitha fushat që janë pjesë e veprimtarisë së arsimit, si arsimi profesional i mbuluar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, arsimi parashkollor i mbuluar nga bashkitë dhe arsimi specifik, siç është, për shembull, siguria dhe mbrojtja, të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga Ministria e Brendshme.

Kjo rritje sivjet është në masën prej 3%, nëse merret parasysh ndryshimi që ka ndodhur në buxhetin e vitit 2019 me aktin normativ, kurse me buxhetin e planifikuar për vitin 2019 rritja shkon rreth 9%, konkretisht 8,7%.

Dy prej fushave kryesore ku do të shikohet e reflektuar rritja e buxhetit për arsimin janë Pakti për Universitetin, e cila është një politikë e ndërmarrë në vitin 2019 për të përmirësuar jo vetëm cilësinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, por i vjen në ndihmë edhe eksperiencës studentore në universitetet publike në Shqipëri dhe, së dyti, infrastruktura në arsimin parauniversitar dhe atë universitar.

Për vitin 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë planifikuar 42 534 000 000 lekë, mirëpo nëse merret parasysh i gjithë sektori i arsimit, ku përfshihet edhe arsimi profesional, që nuk është pjesë e Ministrisë së Arsimit, arsimi parashkollor, si dhe mbrojtja dhe siguria, buxheti total për sektorin e arsimit shkon në 59 miliardë lekë.

Buxheti për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë përbën 8% të buxhetit total. Është një përqindje goxha e madhe dhe reflekton edhe rëndësinë që ka sektori për qeverinë shqiptare.

Do të vazhdoj pak me përshkrimet për pjesë të ndryshme që mbulon buxheti i sektorit të arsimit, ku në fokus të veçantë do të jetë buxheti për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Kështu që, ta kemi gjithmonë parasysh që nuk do të prezantojmë në shumë detaje pjesën tjetër të buxhetit që mbulohet nga ministritë e tjera apo edhe nga bashkitë.

Fondet e planifikuara për arsimin në vitin 2020 janë në masën 42 534 000 000 lekë, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 3,1%. Rritja e parashikuar është e destinuar në rritjen e fondeve për shpenzimet operative, si dhe fondet për shpenzimet kapitale, pra, një rritje me 389 milionë lekë për shpenzimet kapitale. Theksojmë se fondi i parashikuar për shpenzime personeli, ku përfshihet fondi i pagave të punonjësve, si dhe fondet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020, ka një rritje nga viti 2019 në shumën prej 433,4 milionë lekë. Kjo për të mbuluar efektin e rritjes së vazhdueshme të pagave të mësuesve. Është një detyrim i marrë përsipër shumë vite më parë dhe që do të vijojë deri në vitin 2021, në mënyrë që të arrijë masën 40% të rritjes së pagave të mësuesve nga baza e vitit 2017.

Pjesa tjetër e shpenzimeve korrente të rritura prej 470 milionë lekësh është parashikuar për rritjen e shpenzimeve korrente, ku rritja më e madhe është e planifikuar në rritjen e fondeve grant për financimin e IAL-ve publike. Siç e thashë edhe më parë, fondet e miratuara për vitin 2020 arrijnë në masën 8% ndaj shpenzimeve publike dhe në masën prej 2,4% ndaj produktit bruto vendas, kjo nëse nuk merret parasysh i gjithë sektori. I gjithë sektori arrin në masën 3,2% -3,3 % të produktit bruto vendas.

Fondet për shpenzime personeli, do të fillojmë nga kjo pjesë dhe pastaj do të zbërthejmë arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, për vitin 2020 janë 26,9 miliardë lekë ose 63% e të gjithë buxhetit. Natyrisht, ne jemi të vetëdijshëm që një pjesë e madhe e buxhetit shkon për pagat e personelit. Kemi 31 mijë mësues në sistem dhe jo vetëm buxheti i vitit 2020, por edhe

buxheti afatmesëm gjithmonë planifikon që të mbulohen pagat e personelit, ku të përfshihet edhe rritja e parashikuar.

Për periudhën 2020-2022 dhe konkretisht për buxhetin 2020, është parashikuar të mbulohen shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pagës minimale për 1500 punonjës praktikantë me kontratë të përkohshme për zhvillimin e praktikës për arsimin parauniversitar. Pra, përveç që do të paguhet mësuesit e rregullt dhe kemi një rritje të vazhdueshme të pagave, çdo vit planifikohet një numër prej 1500 praktikantësh, të cilëve u paguhet një pjesë e sigurimeve shëndetësore dhe sociale. Ata shfrytëzojnë këtë periudhë 1-vjeçare për të bërë praktikën për t'u bërë mësues.

Duhet të nënvizojmë që çdo vit në sistemin e arsimit parauniversitar kemi nevojë për një numër prej 1000-1300 mësuesish që zëvendësojnë ose mësuesit që dalin në pension, ose mësuesit, që për arsye të ndryshme, largohen për një periudhë kohe nga puna. Për të mbuluar këtë numër të mësuesve gjithmonë parashikohet një numër pak më i madh sesa kufijtë. Pra, çdo vit 1500 praktikantë pranohen dhe paguhet nga buxheti i shtetit për të bërë praktikën. Këto janë shpenzime që planifikohen nga viti në vit.

Përveçse paguajmë për mësuesit dhe për praktikantët, kemi fonde që mbulojnë shpenzimet për transportin e 30 - 32 mijë nxënësve që kanë vendbanim mbi 2 kilometra nga shkolla, si dhe transportin për rreth 9 – 12 mijë mësues që punojnë mbi 5 kilometra nga vendbanimi, qendra e përhershme e punës, në shkollë. Diskutimin për mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit që jetojnë më larg shkollës dhe për mësuesit që duhet të udhëtojnë për të shkuar në shkollë e kemi bërë vazhdimisht në këtë komision. Kjo shumë arrin rreth 800-850 milionë lekë në vit, në varësi të numrit të nxënësve dhe mësuesve që kanë nevojë për këtë shërbim. Ky është një shpenzim i vazhdueshëm që planifikohet në buxhet. Dua të theksoj që, siç kam thënë edhe herën e kaluar, kur isha për raportim në komision, që ne po bëjmë përpjekje të vazhdueshme për të rritur sasinë e lekëve që marrin mësuesit dhe nxënësit për të subvencionuar transportin, por është një diskutim që ende po vazhdon dhe çfarëdo intervenimi nga ky komision do të ndihmonte në këtë proces.

Që prej vitit 2018 kemi fonde të planifikuara për të mbuluar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore për rreth 230 - 250 mijë nxënës të arsimit parauniversitar. Siç e dini, në vitin 2018 ne filluam me projektin e librave falas, ku pajisëm të gjithë nxënësit e klasave nga e para në të katërtën dhe të gjithë nxënësit e tjerë, që u përkasin kategorive të ndryshme të veçanta në nevojë për ndihmë nga shteti nga klasa e pestë deri në klasën e dymbëdhjetë.

Në vitin 2019 kemi përfshirë plotësisht në nismën për të marrë librat falas edhe klasën e pestë. Planifikojmë që në vitin 2020 do të përfshijmë edhe klasën e gjashtë dhe të shtatë, në

mënyrë që në vitin 2021 të përfshijmë klasën e tetë dhe të nëntë. Në këtë mënyrë do të mbulojmë të gjithë nxënësit e arsimit të detyrueshëm me libra falas.

Kjo nismë ka rezultuar e suksesshme në dy aspekte. E para, buxheti familjar lirohet nga barra e blerjes së teksteve shkollore. Kështu që familjet do të kenë mundësi që këto lekë t'i shpenzojmë në aspekte të tjera për arsimimin e fëmijëve. Së dyti, ka dhënë rezultat edhe në ngritjen e vetëdijes të nxënësit për rëndësinë e librit dhe për ruajtjen e librave. Jemi të lumtur të raportojmë që rreth 80% e të gjithë stokut të librave që janë shpërndarë në vitin 2018, janë ruajtur në masë të mirë dhe janë kthyer për ripërdorim. Kështu që, sa më shumë të kemi mundësi të ripërdorim libra të vjetër, aq më shumë do të kemi mundësi të shtojmë edhe klasa të tjera në nismën e librave falas, duke kursyer edhe buxhetin.

Gjithashtu, kemi fonde që planifikojmë çdo vit për të mbuluar shpenzimet për bursat, kuotat ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta. Janë rreth 1300 – 1400 nxënës nga viti në vit. Shuma që mbulon këtë kategori të nxënësve shkon nga 70-75 milionë lekë në vit.

Dy organizatat e reja që janë themeluar, ASCAP dhe DPAP, kanë të planifikuara veprimtaritë e tyre, siç është rishikimi i kurrikulës dhe hartimi i programeve të arsimit parauniversitar, që planifikohet të mbulohet me masën 70-75 milionë lekë në vit.

Kemi fonde për të mbuluar shpenzimet e veprimtarisë së maturës shtetërore, që përsëri është një shpenzim që planifikohet çdo vit. Kjo arrin nga viti në vit vlerën 25-30 milionë lekë.

Fondi i planifikuar për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, që do të fillojë për herë të parë me inspektime më të detajuara në shkolla dhe me vlerësim të cilësisë së arsimit në shkolla, është rreth 10 milionë lekë në vit.

Trajnimi i mësuesve është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që mësuesit të arrijnë të mbajnë nivelin me kërkesat moderne të arsimit parauniversitar. Parashikohen 70 - 80 milionë lekë të reja në vit për trajnimin e vazhdueshëm të 10 - 15% të mësuesve nga viti në vit. Ajo çfarë ndodh zakonisht në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është që nëse ka nevojë për trajnime më shumë sesa ky numër i planifikuar, atëherë duhet të bëhet një rishikim i buxhetit më vonë. Kjo është për sa i përket arsimit parauniversitar.

Kemi edhe disa projekte të tjera që në vitin 2020, gjithsesi, do të reflektohen, siç janë oficerët e sigurisë, që i kemi filluar si nismë në vitin 2018: janë persona që punojnë në kuadër të shkollës dhe ndihmojnë në mbajtjen e disiplinës dhe në parandalimin e dukurive të ndryshme negative. Sot kemi 150 oficerë sigurie nëpër shkollat e mesme. Ky projekt do të zgjerohet edhe më tej, pasi do të bëhet një vlerësim i rezultateve që ka arritur ky projekt në sistem.

Për sa i përket nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, pra ku nxënësit rrinë pas orarit të mësimi për të bërë detyrat e shtëpisë dhe për të përforcuar mësimet për të nesërmen, sot që flasim kemi diku rreth 10 000 nxënës që përfitojnë; ky numër do të zgjerohet përsëri në vitet në vijim me të njëjtën masë si është kaluar nga viti 2017 në vitin 2018.

Një kërkesë e vazhdueshme edhe nga komisioni juaj, një diskutim që e kemi pasur vazhdimisht, ka të bëjë me numrin e psikologëve dhe të punonjësve socialë në sistem. Kemi bërë një riorganizim të personelit mësimor nëpër shkolla dhe një rivlerësim të nevojave për mësues dhe personel tjetër mësimor nëpër shkolla, si dhe një shtim të buxhetit të kjo kategori, në mënyrë që të mundësojmë pasjen e psikologëve dhe të punonjësve socialë për një numër më të vogël nxënësish. Pra, sipas udhëzimit që kemi në fuqi, për çdo 2.500 nxënës duhet të jetë një psikolog ose punonjës social në shkollë. Ky numër do të zvogëlohet, në mënyrë që sa më shumë nxënës të kenë qasje të ky shërbim më se i nevojshëm.

Për sa i përket financimit të universiteteve, institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, në periudhën 2020-2022 janë planifikuar fonde në formë granti me burim financimi buxhetin e shtetit në shumën prej 9 miliardë e 730 milionë lekë. Kjo është për vitin 2020. Shpërndarja e fondeve me burim financimi buxhetin e shtetit për financimin e institucioneve të arsimit të lartë do të realizohet në përputhje me kërkesat e neneve 7, 108, 110, 111, 112 dhe 113 të ligjit “Për arsimin e lartë”. Fondet e miratuara në masën prej 9,9 miliardësh në vitin 2020...

Ndoshta do të kaloj pak tek elementet kryesore që do të mbulohen nga ky grant. Është mbështetja studentore që, siç e dini, në janar të vitit 2019 kemi filluar edhe shpërndarjen e grantit të ri për të mbështetur jo vetëm përgjysmimin e tarifave për të gjithë studentët e ciklit të parë, e ciklit të integruar, por edhe dhënien e bursave për të gjithë studentët ekselentë, duke zgjeruar ekselencën për të përfshirë jo vetëm ata që kanë notë mesatare 10, por të gjithë studentët që kanë notë mesatare nga 9 deri në 10 dhe studentët e ndryshëm, të cilët u përkasin kategorive të ndryshme në nevojë. Kjo politikë do të vijojë të zbatohet, pra nuk është një politikë që është zbatuar vetëm në vitin 2019. Gjithsesi, kjo është reflektuar edhe në buxhetin që e keni përpara.

Një element tjetër është fondi i vazhdueshëm që planifikojmë për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e tyre nëpër konvikte, që parashikohet rreth 350 milionë lekë në vit. Është buxhetim i zakonshëm, por duhet nënvizuar që tani studentët do të akomodojnë në konvikte shumë më cilësore, me kushte më të mira, për shkak se në vitin 2019 një pjesë të madhe të buxhetit e kemi dedikuar për rinovimin e konvikteve. Puna ka filluar në tri qytete, duke u shtrirë edhe në Gjirokastrë dhe në Elbasan së shpejti. Kështu që deri në pranverën e vitit 2020 të gjitha konviktet do të jenë të rikonstruktura dhe studentët që vijnë

kryesisht nga familje në nevojë, studentët konviktore, do të jetojnë në kushte shumë më të mira dhe në banesa moderne, të cilat ata i meritojnë në kohën ku po jetojmë.

Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë është në masën 896 milionë lekë. Ndjesë, kjo është për vitin 2022, sepse paraqet një rritje, ndërkohë që për vitin 2020 granti është në masën 630 milionë lekë.

Granti i punës kërkimore-shkencore për vitin 2020 është 730 milionë lekë. Dua të nënvizoj këtu faktin se për herë të parë në vitin 2019 kemi ndarë një pjesë të këtij buxheti për kërkimin shkencor për të investuar në infrastrukturën kërkimore për universitetet, ku të gjitha universitetet publike kanë aplikuar me projekte specifike, si dhe në varësi të projekteve është ndarë edhe granti. Por ne do të vijojmë që grantin për kërkimin shkencor ta ndajmë në dy drejtime, njëri do të jetë që të financohet kërkimi shkencor, pra puna kërkimore, ndërsa tjetri do të jetë që, gjithsesi, të vijojë të përditësohet infrastruktura kërkimore në të gjitha universitetet.

Ndër të tjera, Shqipëria merr pjesë edhe në nisma të ndryshme europiane, si “Horizon 2020”, nga të cilat përfitojmë fonde. Mirëpo që të marrim pjesë në ato fonde, duhet, gjithsesi, të marrim pjesë me buxhetin e vetë universiteteve. Kështu që edhe kjo është e parashikuar në buxhetin e vitit 2022.

Shumë shkurt, atëherë, për infrastrukturën dhe investimet që kemi planifikuar për vitin 2020:

Për arsimin bazë parashikohet që për vitin 2020 janë diku rreth 1,5 miliardë lekë për ndërtim të objekteve të reja, ku mbulohen diku rreth 20-25 objekte shkollore me rreth 300 klasa ose laboratorë mësimorë me vlerë financimi 400 milionë deri në 500 milionë lekë për çdo vit, ku parashikohet të përfitojnë afërsisht 10 000 nxënës dhe diku rreth 600 punonjës mësimorë. Por, natyrisht, nuk planifikohen vetëm ndërtimet e reja, për shkak se shkollat edhe amortizohen. Për rikonstruksione është parashikuar shuma 3,5 miliardë lekë për rreth 80-90 objekte shkollore, me rreth 900 klasa ose laboratorë mësimorë. Nga buxheti i rikonstruksionit do të përfitojnë rreth 25 000 nxënës dhe 1500 punonjës mësimorë. Natyrisht, shkollat e reja dhe të rikonstruktura duhet të pajisjen me mobilje, me laboratorë... Edhe kjo shkon diku në masën prej 120 milionë lekësh ose 200 respektivisht për mobilje dhe për laboratorë.

Kemi një fond që përcillet nga viti në vit, por sivjet e kemi rritur, i cili është fondi për pasurimin e bibliotekave shkollore, që shkon në 45 milionë lekë të rinj. Nga ky fond parashikohet të përfitojnë 30 000 nxënës dhe punonjës arsimorë. Kjo ishte për arsimin bazë.

Për sa u përket gjimnazeve, për ndërtime të reja planifikohen rreth 12 objekte shkollore, kurse për rikonstruksione janë diku rreth 60 objekte shkollore. Nga ndërtimet e reja përfitojnë

8 000 nxënës dhe 12 000 deri në 13 000 nxënës nga rikonstrukcionet. Këto shkolla, njësoj si për arsimin bazë, duhet të pajisen me mobilje dhe me laboratorë. Kështu që edhe kjo është parashikuar në buxhetin 2020.

Unë do ta ndërpres këtu prezantimin fillestar. Besoj se bëra një hyrje të përgjithshme që nënvizon edhe rëndësinë që i kushtojmë arsimit, por edhe projektet specifike që kemi ndërmarrë të adresojmë jo vetëm përmirësimin e cilësisë së arsimit në arsimin parauniversitar, por edhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë.

Masat që kemi ndërmarrë në vitin 2019 për studentët kanë qenë një ndihmesë e madhe për familjet, në mënyrë që të mbulohet një pjesë e shpenzimeve që studentët kanë. Kjo është një politikë që do të vijojë me përgjysmimin e tarifave dhe dhënien e bursave. Por që të përmirësohet eksperiencia studentore, ne kemi parashikuar, siç e shihni, edhe fonde për investime infrastrukturore si në arsimin bazë, ashtu edhe në arsimin e mesëm dhe në atë të lartë. Unë do ta mbyll këtu pjesën fillestare. Nëse keni pyetje apo çështje për diskutim, shprehemi të hapur për të vazhduar diskutimin.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Përpara se t'ia jap fjalën relatores së projektligjit, zonjës Nikolla, përfaqësueset e ministrisë: zonja Bimo, zonja Gjini, keni diçka për të thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, fjalën e ka zonja relatore.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin tejet shterues të të gjithë buxhetit, i ndarë në zëra dhe në sektorë të rëndësishëm, për të përmbushur objektivat e reformës së ndërmarrë në sistemin arsimor: në arsimin bazë, në atë të mesëm e të lartë, po ashtu, edhe në arsimin e lartë!

Sigurisht, pasi të kemi një relacion më të detajuar, siç ju e prezantuat këtu, çdo anëtar i komisionit do ta ketë shumë më të lehtë për të bërë edhe krahasimet në raport me rritjet që buxheti ka në çdo sektor, krahasuar me buxhetin e vitit 2019. E rëndësishme është të themi se ky buxhet i kënaq objektivat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në të gjitha fushat, edhe pse nga ju nuk u prezantua buxheti për sportin. Por besoj se gjatë diskutimeve në vijim do të përmbushet edhe ky aspekt.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë që ky buxhet vijon nismën shumë të rëndësishme të ndërmarrë në sistemin arsimor të reformës kurrikulare, e përmbyllur kjo në të gjithë sistemin, nga parashkollori deri në klasën e 12-të.

Gjithashtu, vlen të theksohet që buxheti i detajuar i pushtetit vendor do të mundësojë uljen e raportit të fëmijëve për edukator. Është shumë e rëndësishme të thuhet se si në ato bashki, ku kjo mesatare kap shifrën 26, ulet në 18 fëmijë për edukatorë dhe po kështu në rang vendi, duke kapur një mesatare 15 vogëlushë për një edukator. Investimet që kemi parashikuar në sistemin e arsimit bazë dhe të gjimnazeve, pra të arsimit të mesëm-të lartë, patjetër që do të mundësojnë uljen e numrit të nxënësve për klasë, në krahasim kjo me bashkitë më të mëdha të vendit, sepse në zona më të vogla ne kemi një situatë të përmirësuar të mësuesve për klasë.

Më vjen mirë që buxheti për projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe i oficerëve të sigurisë adreson fonde, në mënyrë që të thellohet më shumë. Kjo është një nismë e mirëpritur nga komuniteti i prindërve, por ajo që është shumë e rëndësishme është fakti se ul pabarazinë e fëmijëve në një komponent të rëndësishëm, siç është edhe ai i burimit të përgatitjes mësimore, që sërish mbetet shkolla. Pra, edhe ata fëmijë, të cilët e kanë të pamundur nga niveli ekonomik ose kulturor i familjeve të tyre, i prindërve të tyre, të kenë të njëjtin burim me ata që e kanë të mundur, që është shkolla, kjo e fundit kthehet në vendin, ku fëmijët marrin jo vetëm informacionin e përditshëm të dijes, por edhe përgatiten për ditën shkollore të nesërme.

Po ashtu, unë do të doja të ndalesha edhe te buxhetet që i adresohen arsimit të lartë. Ju e theksuat që duket sikur është një rritje e lehtë. Në fakt, vitin e kaluar u ndërhy në mes të vitit akademik për buxhetin dhe buxheti fillestar nuk e reflektonte rritjen, të cilën e kemi pasur të konsiderueshme, falë edhe lëvizjes studentore, për të përmbushur kërkesat që studentët patën për uljen e tarifave. Qeveria i rimbursoi gjysmë për gjysmë të gjitha tarifat për studentët dhe pati zero tarifë të paguar nga studentët e ekselencës. Kjo është një nismë që vijon edhe këtë vit.

Ndërkohë, dua t’u them anëtarëve të komisionit që ministrja në prezantimin e saj, në fakt, nuk referoi një ndër komponentët e rëndësishëm që duhet të jetë në vëmendjen tonë: faktin se tek universitetet adresohen buxhete edhe nga ministrinë e linjës, sepse kemi një sërë komponentësh apo një sërë nismash të përbashkëta ndërmjet universiteteve specifike dhe ministrive të linjës, që, gjithashtu, kanë dedikuar buxhete dhe fonde, si në infrastrukturë apo në projekte të ndryshme të përbashkëta, gjë që do të thotë më shumë buxhet për arsimin e lartë.

Nuk është e nevojshme ta përsërisim faktin që ende ne kemi shumë nevojë për të financuar arsimin e lartë dhe arsimin në tërësi në përputhje me atë që, në fakt, është trendi rritës i përqindjes në prodhimin e brendshëm bruto. Kemi ende shumë nevojë, por e rëndësishme është të themi që efienca e përdorimit të buxhetit ka bërë që treguesit, në fakt, sepse është mirë të flasim me tregues, kur e matim arsimin, dhe jo për të dhënë konsiderata personale, shpeshherë nihiliste, janë patjetër rezultatet e nxënësve dhe të studentëve çdo vit, por shumë të

rëndësishme janë edhe matjet ndërkombëtare që i bëhen arsimit në Shqipëri dhe çfarë thonë ato për cilësinë e sistemit arsimor në Shqipëri.

Për të vijuar më tej, grantet që ministria i përmendi të detajuara për punën dhe infrastrukturën kërkimore, ishin 730 milionë?

Besa Shahini – Po.

Lindita Nikolla – Granti prej 730 milionësh i arsimit të lartë është një grant i detajuar konform projekteve që vijnë nga universitetet, që jo vetëm e kthejnë edhe një herë vëmendjen e universitetit tek ajo që është, në fakt, shumë e rëndësishme, krahas punës pedagogjike të përditshme dhe rritjes së nivelit të punës kërkimore. Besoj se do të sjellë një vlerë të shtuar në punën kërkimore-shkencore të universiteteve, që në fund janë një produkt për vendin në fusha të ndryshme të zhvillimit të tij. Por ajo që është shumë e rëndësishme në raportin që ka paraqitur Ministria e Arsimit dhe që i atashohet projektbuxhetit të vitit 2020 është vendosja për herë të parë edhe e disa treguesve të matshëm, se sa duhet të jetë sipërfaqja për studentë, si duhet të jenë postet e punës në laboratorë për studentë e me radhë. Kjo do të thotë se janë në vëmendjen e investimeve të kësaj qeverie për arsimin e lartë dhe do të mundësohet një histori të re krahas cilësisë në institucionet tona të arsimit të lartë. Ndaj, patjetër, edhe me pyetje të tjera shteruese ne do të kërkojmë edhe më shumë informacion për zëra të caktuar. Besoj se vendimmarrja e këtij komisioni do të jetë më e qartë kur flasim për buxhetin dedikuar arsimit, rinisë dhe sporteve.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Do të hapim seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve.

Do të vijoj unë fillimisht me disa pyetje dhe më pas të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit, sipas një kohe të përcaktuar. Në fakt, pyetjet e përgatitura prej meje ose, më mirë të themi, prej Grupit Parlamentar Demokrat do t'i depozitohen edhe zonjës minister, për të pasur më tepër lehtësi në dhënien e përgjigjeve.

Zonja Ministre, a jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka lidhur një marrëveshje me spitalet private për shërbim mjekësor të favorizuar për studentët? Kush i mbulon shpenzimet në këtë rast të spitaleve private? Në qoftë se këto shpenzime janë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, përse ky shërbim nuk ofrohet nga spitalet publike, por mund të ofrohen nga spitalet private? Pra, më thoni, a është kjo një mënyrë për të financuar spitalet private me buxhetin e shtetit, apo pranohet që spitalet publike nuk arrijnë t'i ofrojnë shërbimet bazë dhe jeni të detyruar t'u drejtoheni spitaleve private?

(Deputeti Beqiraj ndërhyr pa mikrofon.)

Përderisa kemi një shërbim që u ofrohet studentëve, normalisht edhe ministrja duhet të ketë informacion për këtë.

(Deputeti Beqiraj ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Beqiraj, mos ndërhyrni! Kur t'jua jap fjalën, atëherë mund t'i drejtoni edhe ju pyetje ministres!

Pra, zonja Ministre, edhe një herë, ju po financoni me buxhetin e shtetit spitalet private, apo po pranoni dështimin e shërbimit publik dhe gjithë këtë të mirë po e shihni si një të mirë për studentët?

Së dyti, është deklaruar më parë se fondi për rojet e universiteteve shkon diku te vlera 6 milionë euro, sepse universitetet kërkojnë siguri. Pra, kur thoni: “6 milionë euro”, për çfarë sigurie e keni fjalën, për sigurinë e materialeve që ndodhen brenda universiteteve, apo për sigurinë e personave që frekuentojnë universitetin? Në qoftë se është për sigurinë e materialeve, nuk di se çfarë vlere madhore kanë ato fakultete, kur nuk i intereson askujt të vjedhë kompjuterë ose laboratorë kimikë, fizikë apo të tjerët. Për rrjedhojë, mund të thuhet se ka probleme me sigurinë publike të personave. Pra, edhe një herë, 6 milionë euro flitet vetëm për Universitetin e Tiranës, pa llogaritur të tjerat. Universitetet janë të detyruara të sigurojnë mjediset e tyre, sepse Policia e Shtetit me buxhetin që ka nuk është në gjendje të sigurojë rendin publik dhe për më tepër tempullin e dijes. Unë nuk marr për bazë arsimin europian, sepse është në nivele të tjera. Pyetja që parashtrohet, zonja Ministre, është: si mund ta shpjegoni ju dhe si është e mundur që të gjitha këto shuma shkojnë për gjëra që nuk garantojnë nga strukturat, të cilat duhet ta kryejnë këtë detyrë dhe nuk shkojnë për libra, revista apo kërkime shkencore?

Gjithashtu, mund të them me bindje se sistemi arsimor në vitet e qeverisjes së rilindjes është në gjendjen më të mjeruar se kurrë më parë. Një sistem monist si në aspektin organizativ, ashtu edhe në atë të cilësisë së mësimdhënies. Kurrë më parë sistemi arsimor nuk ka pasur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Nikolla, po bëj pyetjet, më pas mund ta merrni fjalën.

Kurrë më parë sistemi arsimor nuk ka pasur një infrastrukturë të rrënuar si sot, cilësi të ulët të mësimdhënies, ku në mësimdhënie, si shpeshherë, janë punësuar militantë partie dhe jo ofrues të dijes. Bashkitë, në të cilat para zgjedhjeve lokale qeveriste opozita, kanë qenë të cenuara në përvetësimin e fondeve publike në arsim. Mjafton të përmendim shkollën “Azem Hajdari” në Shkodër dhe gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhet kjo shkollë, pasi qeverisej nga një bashki e opozitës dhe fondet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore kanë munguar. Ju mund ta shihni edhe vetë gjendjen në të cilën ndodhet kjo shkollë në Shkodër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është gjendja aktuale e shkollës. Në qoftë se ka më keq se kjo, ju mund të keni një përgjigje përse janë më keq.

Cilat janë masat e parashikuara në buxhetin e shtetit për kthimin në normalitet të kësaj shkolle? Pra, cilat janë masat e parashikuara në buxhetin e shtetit për kthimin në normalitet të kësaj shkolle dhe akomodimin e nxënësve aty?

Gjithashtu, zonja Ministre, sa është respektuar “Pakti për Universitetin” nga qeveria dhe si është reflektuar në buxhetin e vitit 2020? Rritja e buxhetit për arsimin është parashikuar me 5% të GDP-së, me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi dhe përmirësimin e mësimdhënies e infrastrukturës si në universitete, ashtu edhe në konvikte. Po ashtu, jam në dijeni të protestave të studentëve të ditëve të fundit në Qytetin Studenti, të cilët nën dhunën e policëve protestojnë ende për tarifat, studimet dhe kushtet në konvikte. Çfarë mendoni ju?

Gjithashtu, një ndër kërkesat e studentëve ka qenë pajisja me kartën e studentit, a është realizuar pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit për vitin 2019 dhe cilat janë parashikimet për vitin 2020?

Si do të jetë ecuria e investimeve në arsim përmes treguesve të paraqitur në projektbuxhetin e vitit 2020 dhe cili është raporti krahasuar me vitet e mëparshme në shifra realë?

A ka një shpërndarje të drejtë të investimeve në arsim në të gjithë territorin e Republikës në përputhje me kërkesat?

A ka një parashikim për mbështetjen e studentëve për projektet, laboratorët dhe praktikat profesionale?

Zonja Ministre, për sa i përket Akademisë së Shkencave, komisioni ynë ka marrë një shkresë nga kryetari i vetëshpallur i Akademisë së Shkencave, i cili kërkon pak financim për realizimin e projekteve në Akademinë e Shkencave, madje, ndër të tjera thuhet se Akademia e Shkencave duhet të ngrejë pranë saj edhe këshillin ndërakademik për gjuhën shqipe, së bashku me akademinë e shkencave, strukturën për hartimin e enciklopedisë shqiptare e të fjalorit të madh të gjuhës shqipe, të historisë së shqiptarëve, si dhe hartimin e strategjive për studim, kërkime dhe hulumtime arkeologjike. Cili është fondi i parashikuar në buxhetin e shtetit për Akademinë e Shkencave lidhur me hartimin e enciklopedisë shqiptare? A keni ju një shpërndarje të fondeve për Akademinë e Shkencave për realizimin e një projekti të tillë? Gjithashtu, thuhet se Akademia e Shkencave do të marrë hapa të mëtejshëm për të nxitur, organizuar e koordinuar kërkimet dhe studimet shkencore, kryesisht për nanoteknologji, bioteknologji, gjenetikë e të tjerë. A ka një fond të përcaktuar në buxhetin e shtetit për

realizimin e të tilla projekteve dhe kush do t'i realizojë këto projekte në Akademinë e Shkencave, sepse edhe Kryeministri juaj e ka thënë që Akademia e Shkencave është kthyer në një azil pleqsh, ku ulen në kolltuk shkencëtarë kuazi injorantë? Këtë e ka thënë vetë Kryeministri.

Lindita Nikolla- Pikërisht këtë gjë solli ligji i ri, e hapi Akademinë për shkencën.

Fatjona Dhimitri- Meqenëse në ligjin e ri është parashikuar një organikë e re për administratën e Akademisë së Shkencave, a ka një fond të përcaktuar, sipas zërave të buxhetit, lidhur me organikën e re për administratën e Akademisë së Shkencave?

Lindita Nikolla- A mundem?

Fatjona dhimitri- Jo , nuk mundeni. Të mbaroj unë me pyetjet.

Lindita Nikolla- Për procedurë, zonjë.

Fatjona Dhimitri- Zonja Ministre, kryetari i Akademisë së Shkencave është vetëshpallur kryetar, pak a shumë si Zogu, sikurse krahu juaj politik pretendon, por që ju Zogun e urreni, ndërsa këtë tjetrin e lartësoni në cilësitë e dijes. Si mendoni ju, zonja Ministre, se duhet të buxhetohet një i vetëshpallur, që ta dimë edhe ne që të vetëshpallemi dhe si të paguhemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është gallatë, por në momentin që juve nuk ju interesojnë problematikat e shqiptarëve, aty ku vetë shqiptarët cenohen, normal që ju do të kundëreagoni. Zonja Ministre, besoj se mund të keni përgjigje, kështu që mund të vazhdoni.

Lindita Nikolla- Ju lutem, zonja kryetare, unë e di që jeni e re në këtë komision...

Fatjona Dhimitri- Por kjo nuk do të thotë që unë nuk i njoh problematikat.

Lindita Nikolla – Nuk i njeh problematikat.

Fatjona Dhimitri – I njoh shumë mirë.

Lindita Nikolla- Nuk i njeh problematikat, sepse nuk mund t'i shpenzosh kohë të vyer këtij komisioni duke bërë pyetje pa vend, sepse nuk është ministria...

Fatjona Dhimitri- Ku mendoni se janë pyetje pa vend, atje ku cenohen ...

Lindita Nikolla- Pyetjet që i bën ministres së Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit...

Fatjona Dhimitri- Pse bëni ju avokatin mbrojtës të ministres, kur ndërkohë ajo ka dy përfaqësuesit e saj?

Lindita Nikolla – Unë jam relatores dhe pyetjet janë jashtë fushës së përgjegjësisë. Kështu që mund ta shikoni edhe një herë ligjin e ri të Akademisë, edhe ligjin e vjetër dhe të kuptoni që pyetjet e bëra janë jashtë fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Arsimit.

Fatjona Dhimitri – Zonja ministre i njeh shumë mirë kompetencat e saj, e njeh fushën e veprimtarisë së saj, kështu që mund të përgjigjet...

Lindita Nikolla- Nuk i njihni ju, ministrja i njeh.

Fatjona Dhimitri – Unë i njoh shumë mirë, por kur nuk i intereson qeverisë suaj dhe do ta zhysë vendin akoma më shumë në kaos, normal që kështu do të thotë.

Erion Piciri – Për procedurë. Sa të përgatitet ministrja, sepse pyetjet ishin të shumta dhe besoj se duhet të recitojë edhe një herë nga fillimi tërësisht buxhetin, në qoftë se më lejohet, dua vetëm 60 sekonda të bëj dy komente.

Pavarësisht se në vendet e lindjes thuhet që sipas qeverisë jetojmë mirë, por realisht është gjithnjë e më keq, dua të them se janë dy shifra, me të cilat do të raportohet buxheti i arsimit të lartë, është 2,2% në një kohë që vendet e EOCD-së e kanë 4,5% mesataren.

Milva Ekonomi- Të kujt?

Erion Piciri- Të GDP-së.

Milva Ekonomi- E paske të vjetër informacionin.

Erion Piciri- Pse, sa ka qenë?

Milva Ekonomi- Vjet ka qenë 3,2%.

Erion Piciri- Nuk e besoj, por po ju jap një raport tjetër të Bashkimit European, që është 4,7% dhe, nëse nuk ju pëlqen as kjo e dyta, po ju jap një të tretë, që sot e kemi 570 dollarë investimin për studentë, në një moment që këto vende e kanë 10800 dollarë. Është një diferencë prej 20 herësh. Unë e thashë që diferenca midis GDP-së është 1 me 2, por ka një diferencë prej 20 herësh. Në qoftë se e shohim për një periudhë të gjatë se çfarë ka ndodhur me arsimin e lartë shqiptar në 100 vjetët e para, diferenca është e madhe.

Meqenëse ndërhytë, po ju jap disa të dhëna të tjera, që lidhen me faktin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, 60 sekonda.

Unë mund t'ju them që universiteti më i mirë shqiptar, ai i Tiranës, është diku i 6000-ti në rankimin global, ndërsa në këtë lloj forme, ku shihet se sa lekë i kemi dhënë arsimit, jo vetëm që nuk është prioritet kombëtar, por ky është ndër të fundit. Në qoftë se ambicia e shqiptarëve është për t'i shkolluar fëmijët e tyre, ajo që po ndodh me arsimin shqiptar është një katastrofë. Unë doja t'i bëja ministres një pyetje, por meqenëse tha që ishte shumë e lumtur për buxhetin, pyetja ime nuk kishte sens, megjithatë, unë po e bëj. Sa do të donit që buxheti të ishte? Sot është 2,2, ndoshta e doni 5 ose 7. Mbaj mend që në një projekt të BE-së dhe EU-së për politikën amerikane në universitetin e Harvardit kishin bërë dy pyetje, njëra pyetje ishte sa e ke buxhetin, ndërsa tjetra ishte sa do të dëshiroje ta kishe dhe kjo është pyetja ime: sa do të

doje ta kishe buxhetin dhe si Universiteti i Tiranës nga vendi 6000 në botë mund të arrijë i 500 dhe të mos ndodhë që 67% e të rinjve duan të ikin nga Shqipëria dhe 55% e tyre të thonë që jepen para dhe ka korrupsion të madh në universitetet publike? Këto janë ato, me të cilat duhet të merreni, sepse esenca e një liderशिpi të vërtetë është pikërisht të diagnostikojë siç duhet fenomenin dhe t’i japë zgjidhje. Arsimit shqiptar është i nënfinancuar, sa do të investoni ju nga Ministria e Arsimit për shkollimin dhe trajnimin jofiktiv të mësuesve shqiptarë me profesorë vendas dhe të huaj? Çfarë do të ndodhë në qoftë se ka një projekt, sepse këtu flasim për shqiptarin global, për një konkurrencë europiane dhe globale të Shqipërisë? Sa keni investuar dhe sa dëshironi që të merrni profesorë të huaj në universitetin shqiptar dhe në të gjitha nivelet? Kjo është sfida më e madhe, sepse është një ndër vendet që është një nga tre më të fundit të Europës dhe në të gjitha klasifikimet jemi nga fundi i kësaj bote. Po të doni, ju jap edhe shifra, por është diçka që nuk funksionon siç duhet. Prandaj nuk duhet të recitojmë shifra, sepse ato me numra e miliarda nuk i kuptojnë njerëzit, por Shqipërinë reale që 60% e shqiptarëve duan të ikin nga vendi, këtë kuptojnë njerëzit. Njeriu i thjeshtë kupton realitetin, pastaj shifrat. Propaganda e fjalime ne mund të mbajmë sa të duam, por Shqipëria reale nuk ndryshon.

Fatjona Dhimitri- Po, zonja Ministre, mund t’u përgjigjeni pyetjeve, në qoftë se keni.

Besa Shahini – Faleminderit për fjalën!

Kam përgjigje për të gjitha pyetjet.

Mua më pëlqen pasioni, me të cilin diskutoni në këtë komision. Do të doja që me të njëjtin intensitet që diskutoni këtu, të kishit edhe rigorozitet në faktet që sillni. Kështu që me shumë dëshirë do të adresoj disa nga çështjet që u ngritën, për të qartësuar keqprezantimin që iu bë disa fushave këtu.

Zonja Nikolla, është e vërtetë që nuk e adresova buxhetin për rininë dhe sportin, por është gabim yni. Për vitin 2020 janë planifikuar rreth 500 milionë lekë të rinj për këta dy sektorë. Duhet të nënvizoj që javën e shkuar ne kaluam ligjin “Për rininë”, i cili na mundëson që për herë të parë të financojmë organizatat rinore dhe për të rinjtë. Kjo do të reflektohet në mënyrën se si do ta shpenzojmë buxhetin dedikuar për rininë. Ne jemi të lumtur që do të rritet edhe përfaqësimi i të rinjve në organet vendimmarrëse, por do të kemi mundësi që të stimulojmë organizimin e të rinjve, në mënyrë që të adresojmë edhe nevojat që të rinjtë shqiptarë kanë. Kjo do të jetë e reflektuar në buxhetin e vitit 2020, por që do të kemi një rritje në vitet 2021 dhe 2022, për shkak se edhe strukturat, të cilat do të kenë mundësi të bëjnë këtë financim, do të stabilizohen gjatë vitit 2020 dhe do të rritim edhe buxhetin për to.

Lidhur me atë që u tha këtu, që cilësia e arsimit është më e keqe se kurrë, dua të nënvizoj se që nga viti 2014 e deri sot na është dashur të bëjmë përpjekje të pafundme për të përmirësuar

disa nga dëmet që i janë bërë sistemit të arsimit deri në atë pikë. Dua të nënvizoj se universitetet private, të cilat kanë shitur diploma, si: Kristali, Vitrina e të tjerë, jo vetëm e kanë prishur tregun e punës, por e kanë dëmtuar edhe cilësinë e mësuesit, sepse një pjesë e tyre kanë prodhuar mësues që për një periudhë të caktuar kohore kanë shërbyer në sistemin e arsimit dhe kjo ka shkaktuar dëme në të gjithë sistemin. Pra, një mësues i dobët reflektohet edhe në cilësinë e arsimit parauniversitar. Trajnimi i mësuesve deri në vitin 2014, kur paraardhësja ime, Lindita Nikolla, mori drejtimin e Ministrisë së Arsimit, ka qenë plotësisht fiktiv. Mësuesit kanë paguar për të marrë një certifikatë dhe nuk kanë bërë fare trajnim. Pra, një mësues që është futur i dobët në sistem, nuk është punuar me të që të përmirësojë aftësitë e tij. Kjo sot ka ndryshuar plotësisht, sepse sot kemi trajnim të mësuesve që jo vetëm është i mirëfilltë, por bëjmë edhe monitorim në terren, që të sigurohemi që mësuesit shkojnë realisht në këto trajnime. Kjo reflektohet edhe në cilësinë e mësuesve që kemi nëpër shkolla. Të mos përmendim edhe një herë portalin “Mësues për Shqipërinë”, i cili ka siguruar që mësuesit e rinj, të cilët vijnë në shkolla janë më të mirët e fushave të tyre që kemi në sistem. Kështu që nuk mund të flitet fare për një përkeqësim, përkundrazi, me punën kolosale që është bërë, edhe nga paraardhësja ime, por edhe nga ekipi sot, ne po përmirësojmë dëmin që i është bërë arsimit nga udhëheqësit, para se të vinim ne në pushtet. Nuk kemi nevojë të flasim vetëm me përshkrime të tilla, sepse ne kemi shifra që e tregojnë këtë. Testi “PISA”, i cili mat aftësitë bazë të nxënësve, ku janë 76 vende pjesëmarrëse, ka treguar se Shqipëria ka pasur një përmirësim të aftësive në matematikë, gjuhë dhe shkenca nga viti 2012-2015 dhe tani do të kemi rezultatet e testit të vitit 2018, që unë jam e bindur se do të reflektojë një përmirësim tjetër. Shifrat flasin vetë dhe nuk kemi çfarë të detajojmë te kjo pjesë.

Lidhur me pyetjen për kartën e studentit, dua t’ju them se kjo kartë ofrohet nga Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe, siç e dini, karta e studentit ofron shërbime të ndryshme jo vetëm nga institucionet publike në nivel nacional, por nga institucionet publike në nivel bashkiak, si dhe nga institucione të ndryshme private. Uljet në çmime që ofrohen nga institucionet private reflektohen te karta e studentit. Kjo ofrohet për herë të parë, edhe pse ka qenë një kërkesë ligjore e reflektuar në ligjin e vjetër të arsimit të lartë. Këtë e kemi marrë përsipër ta ofrojmë ne bashkë me bashkinë, për shkak se universitetet nuk ishin plotësisht në gjendje që ta ofronin kartën e studentit. Për të gjithë studentët jashtë Tiranës këtë shërbim e ofrojmë me Postën Shqiptare. Deri në fillim të vitit 2020 besoj se do të mbulohen të gjithë studentët me këtë shërbim. Kartat kanë filluar shpërndarjen, por duhet pak kohë deri sa të regjistrohen edhe studentët e vitit të parë, të cilët jo të gjithë kanë marrë numrat e tyre të regjistrimit nëpër universitetet dhe fakultete e tyre përkatëse.

Ju ngritët problemin për një shkollë në Bashkinë Shkodër. Unë dua t'ju informoj edhe një herë, sepse e kemi diskutuar shpesh në këtë komision, por ndoshta vlen ta përsëris, që të investohet në një shkollë specifike, duhet që bashkia të bëjë aplikim në kohën kur hapim thirrjen për aplikimet e bashkive për...

Fatjona Dhimitri - Me sa jam në dijeni, aplikimet janë bërë, por nuk janë pranuar nga qeveria juaj.

Besa Shahini - Nuk janë bërë aplikime. Mund t'i thoni kryetares së Bashkisë Shkodër që për shkollën në fjalë apo për çdo shkollë tjetër, që ajo mendon se duhet të rikonstruktohet, duhet të sjellë aplikimin.

Fatjona Dhimitri- Për bashkitë e opozitës nuk ka pasur të njëjtën shpërndarje fondesh. Tani ka bashki moniste.

Besa Shahini- Nëse keni shqetësim për një shkollë specifike apo për shkollat në përgjithësi, është mirë që të njoftohet kryetarja e bashkisë që të aplikojë me projekt specifik apo të shqyrtohet bashkërisht me projektet e tjera. Ne e kemi prezantuar edhe më parë, por nëse keni nevojë për këtë informacion, mund ta dërgojmë përsëri, që shpërndarja e investimeve në territor është pak a shumë e barabartë kudo, por varet nga nevojat, nga amortizimi i shkollave dhe nga lëvizja e nxënësve. Pra, në zonat rurale ku ka më pak nxënës. Natyrisht që do të ketë më pak investime në të ardhmen sesa në zona urbane, ku numri i nxënësve po rritet dhe presioni demografik kërkon të investohet në më shumë shkolla. Gjithsesi, ne do t'ju sjellim një hartë me listën e të gjitha investimeve që janë bërë ndër vite, në mënyrë që ju ta keni këtë informacion.

Ju folët për rritjen e buxhetit të arsimit në 5% bruto të produktit vendor. Si pjesë e “Paktit për Universitetin”, ne nuk kemi thënë që do ta rrisim në 5%. Në fakt, ne kemi sqaruar një gjë shumë bazike, që është e rëndësishme të përmendet. Në vendet, ku arsimi mund të ofrohet plotësisht falas dhe arrin në 5% bruto të produktit vendor, qytetarët taksohen në 45-65% të të ardhurave të tyre. Në Shqipëri është bërë një debat i madh kombëtar për sasinë e të ardhurave personale që qytetarët pranojnë të tatohen, ata që kanë të ardhura të ulëta, tatohen zero ose pak dhe ato me të ardhura më të larta, tatohen më shumë. Ky është një sistem tatimi progresiv që mesatarisht, me të ardhurat që kanë qytetarët shqiptarë, i bie që qytetarët tatohen me rreth 5%. Në qoftë se bëhet një debat tjetër kombëtar dhe vendoset që qytetarët të tatohen shumë më shumë se ky 5%-shi që përmenda, atëherë edhe mund të arrijë buxheti në 5%. Kështu që ky nuk është një synim që duam të arrijmë. Gjithsesi, ne duam ta rritim buxhetin nga viti në vit. Nëse keni parë edhe planifikimin afatmesëm, ka rritje të mëdha të planifikuara për vitin 2021 dhe sidomos për vitin 2022. Shpresoj që shumë shpejt do të arrijmë në 4,2% në 4,5% të

produktit të brendshëm bruto, por kjo do të shikohet dhe do të rikalibrohet sipas rritjes ekonomike.

Besoj se i trajtova të gjitha çështjet që ngritët në pjesën e parë. Kështu që jemi të hapur për pyetje.

Fatjona Dhimtri – Jo, nuk janë mbuluar të gjitha, janë dhënë përgjigje në ajër, por jo përgjigje konkrete për zgjidhjen e tyre.

Besa Shahini – Çfarë mbeti pa u përgjigjur, sepse unë i mora të gjitha shënim. Më falni, pyetja që adresoi zonja Nikolla për Akademinë e Shkencave, me ligjin e ri është institucion buxhetor më vete, kështu që nuk i mbulon Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Fatjona Dhimtri – Vazhdojmë me pyetjet nga anëtarët e tjerë të komisionit.

Kush e dëshiron fjalën?

Urdhëroni, zoti Ylli!

Fidel Ylli - Zonja Ministre, unë nuk dua të bëjë një analizë të thellë të gjithë raportit të buxhetit, por kryesisht do të përqendrohem te buxheti i sportit. Ka disa vite që buxheti i sportit është po njësoj, pavarësisht se qeveria në këta 6 vjet ka bërë investime në një shumë prej 30 milionë eurosh, duke përmendur stadiumin e Elbasanit, stadiumin e Shkodrës, stadiumin e Kukësit, Tirana Olimpik Park, Qendrën Olimpikë të Korçës. Për mendimin tim, ky është një zë që futet në zërin e investimeve në sport, por unë po flas për sportin elitë, kryesisht për 25 federata dhe dua të bëj një krahasim, që unë nuk mund ta pranoj dot si një njeri i sportit. Ju keni lidhjet tuaja në Kosovë dhe pyesni ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve se sa është zëri i federatave sportive në Kosovë, në krahasim me federatat sportive në Shqipëri. Për mua është e pafalshme që ne të kemi një buxhet relativisht 7 herë më të vogël se ai i Kosovës. Kjo është përgjegjësi e qeverisë dhe ne kemi pasur një tavolinë të rrumbullakët me iniciativë të Federatës së Futbollit në muajin prill, në mos gaboj, në hotel “Tirana”, ku kanë qenë të gjithë aktorët dhe faktorët e qeverisë që kanë të bëjnë me buxhetet, ministri i Financave, deputetë, kryetari i komisionit dhe të gjithë anëtarët e këtij komisioni. Në këtë tavolinë të rrumbullakët Kryeministri u zotua dhe tha që brenda 30 ditësh do të ngrihet një task force me të gjitha institucionet sportive dhe jo vetëm, por edhe me ministrinë përkatëse për të bërë një reformë radikale në sport, sepse ne nuk mund të kërkojmë para vetëm nga buxheti i shtetit për sa i përket zërit të sportit. Sporti ka shumë aksesore të ndryshëm, pra ne kemi mundësi të marrim nga të ardhura të tjera nga Lotaria Kombëtare, aksesore që mund t’i merren biznesit për sa u përket akcizave të duhanit, të alkoolit dhe shumë gjëra të tjera, me të cilat ne kemi mundësi ta rrisim buxhetin e sportit dhe ta çojmë në nivelin që i takon. Thashë që janë bërë disa investime të mëdha, por kemi mbetur në buxhetin e federatave në një nivel shumë mjeran.

Madje, kemi pasur shumë debate edhe me sportistët elitarë, që na kanë nderuar në kampionatet botërore dhe ato europiane, të cilët kërkojnë shpërblimet e tyre.

Në ligjin që ne kemi aprovuar në vitin 2017 është një pike që në qoftë se një sportist elitar del në këto vende në këtë rang liste në kampionate botërore dhe europiane, shteti e ka detyrim ligjor që ta fusë në punë në Ministrinë e Brendshme ose në Ministrinë e Mbrojtjes. Këto duhet të parashikohen në buxhete që të kemi mundësi që ato ligje, të cilat i votojmë vetë në parlament, t'i zbatojmë në realitet, sepse më vjen zor që të gjithë njerëzit e sportit vijnë dhe trokasin tek unë. Thonë: “Je në komision, pse nuk e ngre zërin, pse nuk flet, pse kemi këto buxhete?!” Unë ndihem shumë keq. Prandaj, unë po jua ngre juve këtë problem. Çdo vit, edhe kur ka qenë zonja Nikolla, e kam ngritur problemin që për sa i përket sportit, buxhetet janë shumë të pakta. Ne kemi sportistë elitarë, kampionë bote, kampionë europianë, që na i kanë zili vende, si Gjermania dhe Italia, por nuk kemi mundësi t'u plotësojmë kushtet minimale me paga dhe kur pësojnë dëmtime, nuk kemi mundësi për t'i çuar për t'u kuruar dhe për t'u stërvitur. Për shembull, Shkodra nuk ka një palestër. Ne nuk mund të mburremi vetëm me palestrën e ekipit kombëtar të Qendra Olimpikë, por peshëngritja bëhet në Elbasan, bëhet në Shtërmën, bëhet në Peqin, bëhet në Shkodër, bëhet në Tiranë dhe në Durrës. Duhet të futen në lojë edhe bashkitë në këto buxhete, që ne të kemi mundësi që sportin elitar ta bëjmë edhe në klube, jo vetëm në ekip kombëtar. Prandaj unë do t'ju lutesha edhe një herë... Nuk e kuptoj tani se si do të zgjidhet kjo situatë, kur shikoj këtë buxhet, në një kohë kur Kryeministri ka premtuar se do të rriten buxhetet e sportit dhe do të bëhet një ligj i veçantë. Unë nuk e di, por me këtë buxhet për sa i përket sportit jam totalisht i pakënaqur.

Besa Shahini – Të gjitha shpërblimet për fituesit në olimpiada, në kampionate botërore dhe europiane janë dhënë dhe punësimi është në proces për sportistët elitarë. Nëse ata nuk kanë qenë të kënaqur me ofertën, kjo nuk do të thotë se nuk u është ofruar. Është një diskutim i gjatë, të cilin e kemi ezauruar edhe bashkë, është edhe një diskutim publik që e ka përcjellë këtë çështje. Kështu që nuk është më çështje, nuk e kuptoj pse e ngritët këtu. Ndërsa për reformën në ligjin “Për Sportin”, ju jeni pjesë e të gjitha grupeve ku po bëhet ky diskutim. Diskutimet po vijnë dhe do të jetë një reformë gjithëpërfshirëse në sport që të përfshijnë jo vetëm lehtësira fiskale, por edhe elementet e tjera që janë të domosdoshme për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë. Ajo do të vijojë në muajt në vijim, deri sa të përfundojë që, më pas, reflektohet edhe në buxhetin e vitit tjetër, pra kur të mbyllet e gjithë reforma në sport.

Fatjona Dhimtri – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Selami Jenishehri – Kam një shqetësim që vjen nga takimi që kreu si deputet në bazë. Në Shkodër janë rreth 20 persona, të cilët kanë mbaruar universitetin, kanë bërë masterin në universitetin “Luigj Gurakuqi”, kanë bërë edhe një vit praktikë dhe janë thirrur për të dhënë provimin, kanë shkruar edhe emrat, kanë paguar edhe lekët, por nuk i kanë lejuar të futen në provim. Më duket paradoks. I pyeta se çfarë kanë bërë për këtë gjë, por më thanë që kanë takuar ministren në atë kohë, zonjën Nikolla. Në ato ditë zonja Nikolla ka lënë detyrën dhe u ka thënë të gjithëve se do t’i lejonte që të hynin në provim për të hyrë në punë, por do ta firmoste ministrja e re që do të vinte. Këta qytetarë më kërkuan që të interesohem pranë Ministrisë së Arsimit. Meqenëse ju kam këtu, e ndiej shqetësim dhe detyrim si deputet që ata njerëz të marrin atë që i lejon ligji. Ata kanë mbaruar universitetin, masterin dhe kanë bërë edhe një vit praktikë, kanë paguar edhe lekët për të hyrë në provim, sepse i kanë aprovuar që të hynin në provim, kur shkojnë në provim, nuk i lejojnë.

Edhe një gjë tjetër, sepse nuk kam qejf ta them, ata kanë bindjet e tyre politike. Ata janë qytetarë dhe nuk kemi të drejtë t’u ndërhyjmë fare se për kë votojnë. Ata e dinë dhe nuk kemi të drejtë që t’i orientojmë. Në qoftë se kanë të drejtë, ata njerëz janë shumë seriozë dhe jam i sigurt që këto fjalë që më kanë thënë janë të sakta, duhet t’i ndihmoni për t’u dhënë atë të drejtë që ua jep ligji.

Faleminderit!

Fatjona Dhimtri – Urdhëroni!

Lindita Nikolla – Ky është një nga rastet të zallamahisë që është kryer në arsimin e lartë me universitetet private të paakredituara. Diplomat që ata kanë marrë në universitetin “Argenti”, kanë qenë të paakredituara. Domethënë, universiteti i Shkodrës i ka pranuar në studimet master me një diplomë të paakredituar. Kur ne kemi bërë investigimin në universitete, që bëmë verifikimin e kriterëve të ligjit, universiteti “Argenti” ishte një prej universiteteve që u është hequr licenca. Është konkluduar që kjo diplomë është e paakredituar, pra është marrë në mënyrë të jashtëligjshme. Nuk është vetëm ai kontingjent, është edhe një kontingjent i universitetit të sporteve “Apollon” në Fier. Patjetër që kjo do një vendimmarrje shteruese për t’i parë rast pas rasti. Unë kam biseduar me rektorin dhe të zgjedhurit e universitetit të Shkodrës që ata të na sjellin një vendimmarrje për studimin që u kanë bërë kurrikulës, krediteve më të thelluar akademike, në mënyrë që të na orientojnë drejt një vendimmarrjeje të drejtë. Kjo ka qenë situata që kemi diskutuar me studentët.

Selami Jenishehri – Të lutem, a mund të them diçka?!

Fatjona Dhimtri – Vetëm shumë shkurt, sepse jemi në fund!

Selami Jenishehri – Zonja Nikolla, këta persona ma thanë edhe këtë, sepse harrova ta them dhe kërkoj ndjesë. 2 vjetët e para universiteti “Argent” ka qenë i paakredituar, pastaj është akredituar. Ata e kanë vazhduar shkollën dhe diplomën e kanë marrë kur universiteti ka qenë i akredituar. Universiteti “Luigj Gurakuqi”, a është i akredituar dhe a i ka pranuar ai për të marrë masterin?! Universiteti i akredituar e ka marrë dhe i ka dhënë diplomën, pra ai ka diplomën e masterit të një universiteti të akredituar. Ju e keni çuar 1 vit në punë zotërinë atje, ka bërë edhe praktikën, i thoni do të vini në provim dhe, kur shkon në provim, nuk e pranoni. Megjithatë, ju e dini si do të merrni një vendim.

Fatjona Dhimtri – Urdhëroni!

Erion Piciri – Zonjë, e verifikova shifrën dhe në vitin 2019 është 5% dhe jo 3,2% siç e thatë. Sapo e verifikova, ishte një krahasim nga *OECD.org* për vendet OECD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shqipëria e ka 2,2% me të dhënat që na kanë ardhur mbrëmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po të shikoni projektbuxhetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hajde bëjmë garë për shifrat, por jo këtu, sepse nuk është ky vendi, shkojmë diku tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po të shikoni projektbuxhetin që miratuar vjet, sepse ju harroni një gjë, buxheti i ministrisë nuk është vetëm buxheti i arsimit, por vjen edhe nga sektorë të tjerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, unë nuk ju bezdisa kur folët! Po ju bëj sqarimin. Projektbuxheti që na vjen këtu për diskutim nga Ministria e Arsimit nuk është vetëm projekti i Ministrisë së Arsimit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zotëri, të lutem, a mund ta mbaroj fjalën?!

Duhet të kuptoni një gjë, kur flasim për arsimin dhe përqindjen e tij ndaj GDP-së, nuk është vetëm buxheti i Ministrisë së Arsimit, por është edhe buxheti i enteve të tjera shtetërore që i dedikojnë arsimit. Totali i kësaj shifre vjet në vitin 2018, kur miratonim buxhetin për vitin 2019, ka qenë 3,18%.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo shifër është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe është miratuar nga parlamenti. Prandaj kontrollojeni shifrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet, të lutem se po flas!

Shifra 5% është objektiv i OECD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja ministre po ju shpjegon se si bëhet diskutimi publik në Shqipëri për shifrën 5% të GDP-së që ju mendoni. Nuk kemi objektiv as të “Pakti për universitetin” për sa për qind të GDP-së, sepse kemi të ardhurat personale që taten me një vlerë më të ulët sesa të ardhurat

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimtri – Këtu po e mbyllim seancën dëgjimore...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet, a keni për të shtuar diçka, para se ta mbyllim seancën dëgjimore?

Diskutimi i fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetë e keni përcaktuar dhe e keni miratuar kohën.

Urdhëroni!

Fadil Nasufi – Hapët një debat shifrash, por buxheti nuk është thjesht shifra. Sot që flasim për arsimin, kryefjala është reforma për hapjen e të gjitha rrugëve të financimit. Reforma në arsim është një reformë shembullore. Për të gjithë ata që e morën fjalën këtu: ka një nga niseimi dhe ku shkojmë, se ku shkojmë dhe ku duhet të kemi ambicie. Jam dakord me zotin Piciri se sa duhet të jetë trendi i GDP-së për arsimin. Por duhet të kujtohem se ku ishim para 6 vjetësh, kur arsimi u la me 35 milionë lekë borxh, me paga të pambuluara, me shpenzime të pambuluara, pa transport të siguruar dhe me një katrohurë të plotë në arsimin e lartë dhe në arsimin bazë; me 600 shkolla me infrastrukturë në rrezik; me mbi 4 mijë mësues që merrnin pagat si rrogetarë shteti, por nuk bënë asnjë punë. Është bërë një reformë e plotë në mbulimin e librave dhe në të gjitha çështjet tjera që ne kemi artikuluar herë pas here këtu. Duhet të jemi me këmbë në tokë sa është fuqia e shtetit. Mua më vjen më mirë që buxheti i mbulon të gjitha zërat; edhe tekstet falas i mbulon deri në klasën IX deri në vitin 2022; edhe paketën për ligjin për universitetin në arsimin e lartë e mbulon shumë mirë.

Ftoj anëtarët e komisionit që në mbledhjen e radhës të shkojmë të bëjmë një vizitë në qendrat studentore se si janë përmirësuar kushtet nga vjet në sivjet dhe si duhet të punojmë me donatorë të tjerë, që të gjejmë burime financimi që kushtet për studentët të jenë të standardeve bashkëkohore, por të ketë edhe rritje të pagave. Në këtë aspekt, kam edhe unë vërejtjet e mia. Ne kemi hedhur hapa dhe kemi modele shembullore në zonat urbane për investimet në shkolla, por ka diferenca në zonat rurale, ku ka shkolla të rrënuara. Nuk e di çfarë problemi hapi tërmeti në zonat që u prekën dhe a u mbuluan ato me financime nga Ministria e Arsimit për të dalë

jashtë rrezikut ose jashtë gjendjes së amortizuar. Do të shtroj një pyetje: a ka një platformë për shkurtimin e orëve të mësuesve që janë në prag të pensionit ose për nxjerrjen tyre në pension të parakohshëm, për t'u krijuar mundësinë e futjes në portal dhe në sistemin e mësimdhënies mësuesve të rinj që dalin nga shkollat? Ka edhe probleme të tjera që e shëndoshin atmosferën dhe e mbështesin këtë reformë të rëndësishme, të cilën e kemi sfidë jo si qeveri, por si shqiptarë, pra, që arsimin ta kemi ekonominë më të mirë të të gjitha familjeve.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Seancën dëgjimore me ministren e Arsimit e përfundojmë këtu.

Milva Ekonomi – Zonja Ministre, ju lutem, komentet që sollët te ne në formë diskutimi, na i depozitoni edhe me shkrim, mundësisht që sot! Edhe hartën e investimeve që na i keni sjellë një herë, ju lutem ridërgojeni për arsye që, kur të kalojmë në diskutimin nën për nen, të jemi edhe më të qartë vetë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Seancën dëgjimore me ministren e Arsimit e përfundojmë me kaq dhe do të vijojmë me seancën tjetër dëgjimore me Ministrinë e Kulturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - Bëjmë 5 minuta pushim.

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, me pjesëmarrjen e zonjës, Elva Margariti, Ministre e Kulturës.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Elva Margariti - Ministre e Kulturës,

Entela Çipa - sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës,

Shpëtim Shehu - drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,

Alma Mile - këshilltare për mediat në Ministrinë e Kulturës.

Ina Dhaskali- përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave,

Lorisa Kushi – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri - Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2010”. Kemi të ftuar ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti, zonjën Entela Çipa, sekretare e Përgjithshme, zotin Shpëtim Shehu, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe zonjën Alma Mile, këshilltare për mediet.

Sikurse ia bëmë të ditur edhe ministres së Arsimit, nëse nga Ministria e Arsimit nuk kishim marrë një relacion apo raport, raportin tuaj e kemi marrë pak minuta më parë. Pra, nuk kemi mundësi ta studiojmë brenda një afati kohor kaq të shkurtër.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Elva Margariti - Do të mundohem të jem shteruese.

Faleminderit!

Relacioni i përgatitur për buxhetin e vitit 2020 bazohet në politikat e qeverisë shqiptare. Ministria e Kulturës duke hartuar programin buxhetor afatmesëm 2020-2022, është fokusuar gjithmonë në politikat e saj për zhvillimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe muzeve.

Ky program është hartuar dhe në bazë të rishikimit dhe rivlerësimit të kufijve në 3 programe buxhetore dhe në shpërndarjen e fondeve, ruajtjen e ekuilibrave, mbështetur në politika, prioritet dhe objektivat e këtyre 3 shtyllave, konkretisht: planifikim, menaxhim, administrim; trashëgimi kulturore dhe muze; art dhe kulturë.

Vijmë sot këtu me këtë program buxhetor pas një analize të thelluar që i kemi bërë dhe vetë buxhetit të vitit 2019, por edhe mbi një sërë politikash, përveç arritjeve dhe prioritetëve të shtuara gjatë 6-mujorit të dytë, kjo edhe në bazë të politikave të qeverisë shqiptare. Këto politika detyrimisht do të reflektohen edhe në buxhetin e vitit 2010, por përpara se të filloj me këto reflektime, më lejoni që shkurtimisht të përmend se gjatë vitit 2019 analiza që kemi kryer dhe në të cilën jemi bazuar në shifra, mund të përkthehet në programin: “Art, kulturë dhe libër”, një fond total prej 137 milionë lekësh. Ministria ka mbështetur 150 projekte brenda aparatit të Ministrisë së Kulturës me vlerën 85 milionë lekë, të ndara këto në kategori: 110 prej këtyre projekteve janë financuar me skemën tonë me thirrje të hapur, 40 projekte të brendshme, të cilat kanë pasur dhe rishikime gjatë vitit, që mund të përmenden si iniciativat e muajit të muzikës, muajit të trashëgimisë kulturore, muajit të librit dhe përfaqësime ndërkombëtare.

Mbështetur në politikat e qeverisë në këtë vit na është dashur të rishikojmë programet tona, si në rastin për “Paktin e universitetit”, ku jemi angazhuar plotësisht përmes punëve

konkrete, një prej të cilave dhe më e fundit është pasurimi i 3 bibliotekave universitare në Universitetin e Arteve, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Histori- Filologji dhe në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës. Ministria e Kulturës me të 3 këto fakultete ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të “ Paktit për universitetin”.

Ndër këto aktivitete një rëndësi të veçantë në promovimin e artit dhe kulturës shqiptare ia vlen të përmendim Bienalen e Venecias, e cila zë një shumë prej 20 milionë lekësh, Panairin e Librit në Lajpcig prej 2,5 milionë lekësh dhe Festivalin e Librit në Mantova në shumën prej 1,6 milionë lekësh. Janë zhvilluar rreth 1500 aktivitete të realizuara nga institucionet e artit dhe të kulturës me një vlerë prej 52 milionë lekësh. Pra, nga vlera 137 milionë lekë e kësaj shtylle, 40% u kanë shkuar institucioneve të artit dhe të kulturës, 35% projektet e mobilitetit. Këtu vlen për t’u ritheksuar se janë riparë në kuadër të paktit 25%, realizimi i aktiviteteve të skenës së pavarur artistike. Janë përmbushur të gjitha detyrimet për anëtarësimet dhe përfaqësimin e denjë të Shqipërisë në rrjetet ndërkombëtare si: *Creative Europe*, *TRADUKI* dhe Europa për qytetarët.

Për të kaluar në shtyllën tjetër në fushën e trashëgimisë kulturore, në fondin e mirëmbajtjes, rreth 9,7 milionë janë arritur që të restaurohen deri tani 72 objekte dhe të mirëmbahen 71 të tilla. Parashikohet që deri në fund të vitit 2019 të përfundojnë dhe të mirëmbahen 35 objekte të tjera, janë 8 objekte kulti, 15 banesa dhe 12 objekte si: kala, ura, porta e të tjera.

Në një historik shumë të shkurtër, të gjitha punëve të ministrisë në këto kohë vlen për t’u cituar edhe ndihma e donatorëve. Kjo është një punë e vazhdueshme e ministrisë, si: Fondi Amerikano-Shqiptar i Zhvillimit, KSHZH-ja, TIKA, *Cultural Heritage without Borders*, FZHR-ja kanë realizuar ndërhyrjen në 13 objekte të trashëgimisë kulturore me një impakt të madh, flasim për 4 qendra historike, 6 objekte kulti dhe ura. Ne kemi punuar për përmirësimin, shtimin e shërbimeve dhe të institucioneve në trashëgiminë tonë kulturore. Konkretisht, përtej sistemit të biletarisë elektronike që ekzistonte në 10 site, kemi arritur që të funksionojë edhe biletaria *online*, një risi që vjen për herë të parë si shërbim nga Ministria e Kulturës.

Një tjetër risi është në Muzeun Kombëtar Ikonografik “Onufri”, ku u implementua për herë të parë sistemi digjital i audioguidave. Po i përmend këto, sepse të dy këto risi janë zëra, të cilat parashikohen të implementohen në vijim dhe në site të tjera për vitin 2020.

Rendita shkurtimisht disa nga arritjet dhe performancën në shifra të buxhetit të vitit 2019, ku vihet re se ka një shtim të aktiviteteve, ka një shtim të ndërhyrjeve në objektet e trashëgimisë, shërbime të reja, të cilat kanë sjellë rezultat të lexueshëm në shtimin e

audiencave dhe të vizitorëve. Kjo me të dhënë më të fundit. Mjafton të përmend se për herë të parë për periudhën janar- tetor kemi arritur shifrën 1000 vizitorë në *sitet* e trashëgimisë kulturore. Kjo na vë përpara sfidave dhe përgjegjësi të reja. Patjetër që e kemi analizuar në prioritetet dhe politikat për buxhetin e vitit 2020.

Në fokusin e ministrisë për vitin 2020 nuk do të jetë vetëm trashëgimia kulturore dhe muzetë, jo vetëm promovimi i artit dhe i kulturës brenda dhe jashtë vendit, por qasja drejt institucioneve me sa më shumë të rinj. Ka qenë një nismë të cilën e kemi ndryshuar gjatë gjithë vitit 2019, por një fokus të veçantë për vitin 2020 do të ketë edhe trashëgimia jomateriale, që zë një vend shumë të ndjeshëm në buxhetin e këtij viti, pasi do të kulmojmë me Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Në total për vitin 2020 buxheti shënon një rritje prej 11, 7% krahasuar me atë të vitit 2019, pra nga 2 miliardë e 165 milionë e 867 në vitin 2019, do të kemi 2 miliardë e 419 milionë e 204 mijë në vitin 2020, një diferencë prej 253 milionë e 337 mijë. Duke parë kërkesat buxhetore sipas zërave tashmë të ndara në projektbuxhet për vitin 2020 krahasuar me buxhetin e vitit 2019, zëri: paga, sigurime shoqërore nuk rritet, qëndron në të njëjtën vlerë, pavarësisht se në bazë të ligjit të ri “Për trashëgiminë kulturore”, i miratuar vitin që kaloi. Ministria ka bërë hapa të mëdhenj për rristurimin e institucioneve të varësisë dhe krijimin e institucioneve të reja, ku ky zë nuk ka shënuar ndryshime, duke bërë një rialokim edhe në organigramë, por ka sjellë vështirësi në disa performanca.

Shpenzimet korrente në krahasim me vitin 2019 kanë parashikuar një rritje prej 5,6%. Kjo rritje lidhet kryesisht me pjesëmarrjen në Bienalen e Arkitekturës në Venecia, është një zë në zërin buxhetor të Ministrisë së Kulturës, ku pjesëmarrja dhe përfaqësimi i denjë ndërkombëtar kanë një fokus të veçantë.

Në zërin: me financim të brendshëm në krahasim me vitin 2019 do të ketë një rritje me 6,3%. Pra, 45 milionë lekë, ku fokusohemi në kontratën shtesë për Teatrin Kombëtar të Operës dhe të Baletit për të përfunduar më së miri të gjithë veprën madhore, e filluar 3 vjet më parë. Gjithashtu, me fillimin e rikonstruksionit të Galerisë Kombëtare të Arteve, që më pas sipas riorganizimit dhe ligjit të ri “Për trashëgiminë”, do të quhet Muzeu i Arteve të Bukura. Ky projekt madhor i ri, Muzeu i Arteve të Bukura, do të përmbushë nevojat për hapësira që ka në këtë moment jo vetëm Ministria e Kulturës, por i gjithë komuniteti i artit dhe i kulturës. Ky institucion i rëndësishëm do ta marrë parasysh këtë ndërhyrje jo vetëm gjatë vitit 2020, por në një plan 3- vjeçar në të njëjtin shembull dhe model siç është kryer edhe shtrirja e projektit të Teatrit të Operës dhe Baletit.

Për sa i përket analizës sipas 3 programeve, 3 shtyllat që citova në fillim, projeksioni për projektet e vitit 2020 krahasuar me buxhetin e vitit 2019 aparati, planifikimi, menaxhimi parashikojnë një rritje 3%, arti dhe kultura, krahasuar me vitin 2019 ka një ulje 11,6%, ndërsa trashëgimia kulturore dhe muzetë kanë një shtim prej 14%.

Duhet të theksohet edhe njëherë se viti 2020 është viti i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Për të ruajtur ekuilibrat brenda programit tonë buxhetor, kemi parashikuar këtë rritje në trashëgiminë kulturore dhe në muzetë, si dhe ulje në art dhe kulturë.

Fondi prej 80 milionë lekësh i kërkuar për festivalin është gjithsesi i pamjaftueshëm dhe ministria vendos në dispozicion një mbështetje në zërin e projekteve, pikërisht për këtë projekt madhor.

Fondi i planifikuar për shpenzimet korrente për vitin 2020 përbën 21,8% të totalit të shpenzimeve dhe do të përdoret në fushën e trashëgimisë kulturore në 35,6 milionë lekë në shpenzimet korrente, kryesisht në mirëmbajtje, në objekte dhe restaurime. Do të përballohen aktivitete në fushën e trashëgimisë materiale dhe jomateriale. Duhet të theksojmë se një përqindje të madhe e shpenzimeve korrente e zë ruajtja e objekteve me shërbimin e rojeve, është 20% e totalit të buxhetit.

Në fushën e artit dhe të kulturës është ulja siç ju thashë prej 15,4 milionë lekësh në krahasim me vitin 2019. Mendojmë që do të vazhdojmë me të njëjtat politika që kanë të bëjnë me konsolidimin e vlerave artistike, me promovimin si brenda dhe jashtë vendit. Nuk kemi ulur asnjë zë buxhetor në pjesëmarrjen e Shqipërisë jashtë vendit. Do të vazhdojmë me programin “Edukimi përmes kulturës” dhe akoma më tepër me programet e “Paktit për universitetin”, por kemi menduar se kjo ulje në këtë buxhet, në këtë sektor të veçantë duhet të sjellë edhe një rishikim të të gjithë politikës, të një skeme të re për projektet me thirrje, që nuk do të jenë më me fonde të copëzuara, por do të mbështesim projekte më të mëdha.

Duam të krijojmë traditën e qëndrueshme në zhanre të ndryshme artistike dhe këto politika gjithsesi në vlerësimin tonë do të kenë një impact. Vërtet do të kemi një ulje të këtij buxheti, por duke parë një skemë të re, do të kemi një impakt më të madh me projekte më të mëdha. Ne kemi kërkuar të kemi një mbështetje financiare për këtë zë, kemi kërkuar një buxhet prej 75 milionë lekësh.

Shpenzimet kapitale kanë një rritje prej 45 milionë lekësh. Siç e thashë për vitin 2020 si objekt kryesor kemi shlyerjen e rikonstruksionit të TOB-it me një vlerë prej 200 milionë lekësh për shtesën e kontratës dhe fillimin e rikonstruksionit të Arteve të Bukura. Për vitin 2020 është planifikuar vlera 497 milionë lekë për këtë projekt, ndërsa projekti në total kap shifrën e 1,3 miliardë lekëve, të cilat do të shtrihen edhe gjatë 2021-2022. Dua të theksoj

se projekti që disponon Ministria e Kulturës nuk parashikon disa zëra që lidhen me zhvendosjen e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, të restaurimit të tij, të rivlerësimit ekonomik dhe gjetjes së një hapësire të re për periudhën tranzitore që do të kalojë Galeria Kombëtare e Arteve gjatë rikonstruksionit.

Për këtë arsye kemi menduar që gjatë vitit 2020 të kemi një rishikim të buxhetit në këto zëra të projektit që ende nuk e disponojmë. Në këtë rast do të shfrytëzojmë eksperiencën e fituar edhe në 3 vjetët e rikonstruksionit të TOB-it që ka ndërmarrë të njëjtët hapa, por duke pasur parasysh specifikat konkrete të institucionit në fjalë.

Kemi planifikuar në zërin e projekteve 20 milionë lekë për projektin “Parku i artit”, që është projekt i IPA-s që do të ketë një impakt prej 1 milion eurosh.

Është një sfidë e madhe për Ministrinë e Kulturës që të angazhojë fondin e saj të investimeve përsëri, për herë të dytë për 3 vjet radhazi për një objekt të vetëm. Këtë dua ta theksoj, sepse është një punë e madhe që ministria ka bërë në këta vjet dhe do të jetë një ritëm i vështirë për t’u përmbajtur, jo vetëm në realizimin e një vepre të tillë madhore, por edhe për impaktin që ka në komunitet që Ministria e Kulturës të gjithë zërin e investimeve e angazhon në një titull të vetëm, ashtu siç kemi bërë në vitin 2019 me vazhdimin e hartimit të projekteve dhe rishikimin e fondeve buxhetore për të mbështetur projekte madhore. Në rastin konkret këtë vit kemi çuar përpara rikonstruksionin e “Mësonjëtores”. Mendojmë të vazhdojmë në të njëjtën mënyrë dhe me rishikimin e projekteve të tilla të ngjashme dhe përgjatë vitit 2020.

Gjithashtu, të ardhurat nga biletat, zëri i fundit është në shtim. Në krahasim me vitin 2019 deri tani kemi plus 11% të ardhura, rreth 233 milionë. Duhet theksuar se këto janë të ardhura, të cilat mund të përdoren nga institucionet tona deri në një tavan të caktuar, të planifikuar më parë.

Një nga politikat e Ministrisë së Kulturës, por jo vetëm, e mbështetur fort nga qeveria, është ngritja e të gjitha tarifave të biletave dhe shtimi i shërbimeve në të gjitha sitet e trashëgimisë.

Në parashikojmë, gjithashtu, që përtej rritjes së çmimit të biletave, i cili nuk do të sillte impakt, nëse tavanet do të vazhdojnë të ngelin të njëjtat, ato të planifikuarat, do të çojnë përpara në qeveri edhe kërkesën tonë për rishikimin e buxhetit, i cili të kalojë nga një fond mirëmbajtjeje në një fond të dedikuar të institucioneve, që t’i ngelë institucioneve si në rastin e Butrintit. Kjo do të sillte dy politika të gërshetuara bashkë, që do të sillnin më shumë restaurime, më shumë mirëmbajtje nga vetë institucionet dhe automatikisht edhe më shumë vizitorë që do t’i frekuentonin.

Për financimet e huaja dua të theksoj se, edhe pse nuk lidhen detyrimisht me buxhetin e vitit 2020, Ministria e Kulturës ka në fokus thithjen e të gjitha donacioneve nga të huajt, që janë një nga zërat me të rëndësishëm dhe me impakt më të madh në sitet e trashëgimisë kulturore. Përmenda disa pak më sipër, megjithatë gjatë vitit 2020 në fokusin tonë kemi të tjera projekte, siç citova, Parkun e Artit, një projekt IPA 1 milionë euro, ngritja e qendrës së digjitalizimit nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, i cili është në proces, ngritja e Qendrës Muzeore Hebraike në Vlorë, restaurimi i mozaikut në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar, rehabilitimi dhe restaurimi i sallës së koncerteve të Akademisë së Arteve, përmirësimi i infrastrukturës muzeore dhe muzetë në Gjirokastrë, projekti DEA për investime në qendrën historike të Përmetit, muzealizimi i “Mësonjëtores” pasi për vitin 2019 kemi garantuar vetëm restaurimin e godinës, por jo muzealizimin e ri të Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë, si dhe projekte të tjera, por këto janë titujt më të mëdhenj.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës a do ta marrë kush fjalën?

Do të vijojmë me pyetjet dhe diskutimet.

Po filloj së pari unë. Po i referohem së pari zonës që unë përfaqësoj. Për restaurimin e pazarit historik të Gjirokastrës është shpenzuar për investime në fasada, çati, kalldrëme me gurët që po lëvizin çdo ditë dhe ju e dini shumë mirë, por Gjirokastra historike nuk vlerësohet vetëm nga këto fasada, por shihet si një ansambël i tërë. Në kalanë madhështore të Gjirokastrës, një ndër monumentet historike kryesore, rreth dy vjet më parë, janë shfaqur kërkesa dhe ankesa për ndërhyrjet në kala, çarjet në anën veriore të kalasë. Po vjen dimri e do të fillojnë shirat, ndaj shtroj pyetjen: A do të ketë parashikime në buxhetin e vitit 2020 për të përmirësuar gjendjen e kalasë? A ka ndonjë investim për kalanë apo ta lëmë të përparojë më tepër në çarjet që janë shkaktuar?

Së dyti, në lagjet historike, si Manalat dhe Dunavat po humbasin dita- ditës historinë e tyre si pasojë e degradimit. Në këto lagje nuk ka asnjë lloj investimi dhe ky është një detyrim nga UNESCO, si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonja Ministre, lagjet po bien për shkak të pamundësisë së banorëve, por edhe për shkak të braktisjes së tyre. Në këto lagje po humbet historia. Cilat janë parashikimet në buxhetin e shtetit për ruajtjen e historisë në lagjet historikë të Gjirokastrës dhe a ka një fond të projektuar për ristrukturimin e këtyre banesave?

Lidhur me strukturën aktuale të Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Gjirokastrë, ku pesë punonjës realizojnë menaxhimin e mirëmbajtjes së Monumenteve të Kulturës, a mendoni ju se një numër i tillë punonjësish është i mjaftueshëm për të realizuar mirëmbajtjen? Cili është fondi i mirëmbajtjes dhe investimeve për Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Gjirokastrë i parashikuar për vitin 2020? Për të mos folur më tej për manastiret të cilat gjenden mes malesh, ku duhet 3 orë për të shkuar dhe për të çuar materialet e nevojshme për rikonstruksionin e këtyre objekteve të kultit?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Jeni në kundërshtim me Rregulloren e parlamentit. Kërkoj fjalën për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, Ismet!

Ismet Beqiraj – Kjo është një ngjarje e veçantë dhe e shenjtë, do të thosha, sepse na jepet mundësia të fillojmë diskutimin e projektbuxhetit. Të gjithë deputetët kanë të drejtë të pyesin, të sqarohen, të marrin përgjigje, të japin opsionet e tyre. Ne nuk do ta kthejmë këtë sallë dhe këtë komision në pazar, por të japim modelin e kulturës së komunikimit edhe me qytetarët dhe të jemi ne modeli, të mendojmë për hallet dhe problemet e tyre sipas sektorëve dhe fushave jetësore dhe jo të bëjmë shoun e radhës.

Unë do të sugjeroja që të respektosh me seriozitet dhe me korrektësi ligjin dhe Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.

Fatjona Dhimitri – Po e respektoj më së miri, por ju më ndërhyini kur unë bëj pyetje.

Ismet Beqiraj – Që këtu po e shkel, se ndërhyin dhe nuk respekton mendimin e tjetrit. E drejta e fjalës është për të gjithë. Gjithsecili nga ne ka të drejtën ligjore të thërrasë në dëgjuesë çdo ministër për kontroll parlamentar për veprimtarinë e punës së tij dhe të nxjerrim të gjithë këto problematika që dalin, sepse të gjithë ne anëtarët e nderuar të komisionit që jemi këtu kemi probleme në zonat që përfaqësojmë.

Sot u paraqit një projektbuxhet.

Të lutem, fute komisionin në veprimtari normale, në hullinë e diskutimeve të problematikave që kemi për projektbuxhetin dhe jo ju e para, mezi prisni të merrni fjalën sa mbaron prezantimin ministria! Ç'është kjo, pa folur relatori, pa marrë mendimin tonë?! Duhet të kesh më shumë respect!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne e kemi kohën të limituar. Kemi planifikuar sot edhe në program që seancat të jenë të limituara dhe po ju them të mos keqpërdorni mikrofonin. Nëse keni 20-30 pyetje që janë jashtë kësaj teme që po diskutojmë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Nuk janë jashtë diskutimit këto çështje. Si qenkan jashtë? A kemi të ftuar ministren e Kulturës këtu? Vetëm pyetjet tuaja qenkan brenda diskutimit?!

Urdhëroni, zonja Kumbaro për procedurë!

Mirela Kumbaro – Faleminderit, që më dhatë fjalën!

Për procedurë dua të propozoj dy gjëra:

E para, besoj se pas fjalës së ministres, duhet ta ketë fjalën relatorja, nëse do ta marrë për të vazhduar.

Propozoj që, përveç pyetjeve tuaja, të bashkojmë të gjitha pyetjet së bashku, që të kursejmë kohë, duke qenë se kemi një axhendë ditore shumë të gjatë. Pra, pyetjet tuaja dhe të të gjithë kolegëve t'ia japim zonjës Ministre, në mënyrë që ajo, në mënyrë të përmbledhur, të na japë përgjigje, të cilat mund të jenë edhe sintetike për të na kursyer kohë.

A jemi dakord me këtë propozim?

Së dyti, dua të bëj vetëm një replikë, meqenëse m'u drejtuat mua personalisht.

Për sa i përket Gjirokastrës dhe çfarë kam bërë unë, qoftë si deputete apo si ministre, po ju them se Gjirokastra, por jo vetëm Gjirokastra, por edhe Përmeti, dhe ju e dini shumë mirë, se keni lindur në Përmet, kurse unë sepse e kam zgjedhur, pra kam vullnetin, dëshirën dhe dashurinë brenda, kurse origjinën e kam nga Gjirokastra, pra në të dyja këto qytete janë bërë investime në trashëgiminë kulturore sa nuk janë bërë në 25 vjet së bashku. Pazari i Gjirokastrës nuk ka më nevojë për avokat, as për ju, as për mua dhe për asnjërin nga ne këtu, sepse, në fakt, atë ekonomi që po prodhon Gjirokastra sot, në fakt po kthehet në një model zhvillimi.

Për sa i përket kalasë, po ta kishit parë dhe po ta kishit ditur, nuk do ta kishit bërë pyetjen...

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë po jua kursej përgjigjen e plotë dhe të detajuar, se nuk dua të të nxjerr keq, zonja kryetare...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Jo, jo nuk ka pse të më nxjerrësh keq se e njoh mirë gjendjen e kalasë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Po qetësohu, qetësohu!

Fatjona Dhimitri – Po, se nuk po thua të vërtetën, pra...

(Diskutime pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Të lutem shumë, “ki shumë kujdes me të vërtetën”, zonjë, thotë Dritero Agolli. Është fjalë e rëndësishme dhe mos e shpërdoro!

E vërteta është e shtrenjtë për mua. Të lutem, ki kujdes kur flet për të vërtetën!

Kalaja e Gjirokastrës është pjesë e projektit të Bankës Botërore për të cilin mbase nuk keni informacion, por unë jam e bindur se ministria do të jetë shumë e lumtur t’ua vërë në dispozicion projektin e filluar në vitin 2016 e duke vazhduar në vitet 2017, 2018 dhe në vitin 2019 është konkretizuar, ndërsa në vitin 2020 do të fillojnë projektet e BB-së aty në vijim të kalldrëmeve që janë gjithashtu pjesë e projektit të BB-së.

Shtegu i Ali Pashait, nuk e di a e dini, me siguri nuk e dini, në të cilën do të bëhet një ndërhyrje shumë e thellë me mbi 1 milionë euro investim. Ky do të jetë një projekt, i cili, në fakt, ka pasur nevojë të bëhet që në vitet ’60 dhe ’70, kur kanë filluar të konstatohen problemet e para dhe këtë e kanë të gjitha studimet, për aq sa janë bërë, se nuk ka ende një studim të plotë të kalasë së Gjirokastrës, as studim topografik të saj, as studim gjeologjik, por të gjitha këto ju nuk i dini dhe unë ju falënderoj që më jepni mundësinë sot që t’i them edhe një herë, ndonëse ky komision i nderuar i ka dëgjuar në dëgjesat e bëra disa herë për Gjirokastrën.

Unë mendoj që të mbledhim të gjitha pyetjet, pastaj ministria, në mënyrë sintetike të na i japë përgjigjet.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit për iluminimin!

Vazhdojmë, zonja Ministre.

Elva Margariti – Për Gjirokastrën do t’ju përgjigjem shkurtimisht dhe pres përmbledhjen e të gjitha pyetjeve të tjera.

Ndoshta nuk doli shumë në pah, ndoshta nuk e përmenda aq sa duhet, se viti 2020 nuk do të jetë vetëm viti i trashëgimisë kulturore dhe i muzeve, por edhe viti i trashëgimisë jomateriale dhe në fokus të Ministrisë së Kulturës dhe të vetë politikës së qeverisë shqiptare është Festivali Folklorik i Gjirokastrës. Festivali folklorik nuk do të thotë vetëm aktivitet artistik, se fondi i vënë në dispozicion shkon, gjithashtu, edhe për restaurime, edhe për aktivitete të tjera ekonomike dhe ajo çfarë do të ndodhë në Gjirokastrë për vitin 2020 në vijim të të gjitha programeve dhe projekteve të ndërmarra, do të sjellë një frymë të re edhe për 5-vjeçarin tjetër.

Shuma e vënë në dispozicion do të prekë së afërmi edhe të gjitha aktivitetet, që nga ato të hotelierisë, restoranteve e të tjera të Qafës së Pazarit.

Për më tepër, ju thashë që në fondin e Ministrisë së Kulturës kemi një ulje në buxhetin “art dhe kulturë”, por një rritje në projektet e trashëgimisë kulturore që lidhen me Festivalin e

Gjirokastrës. Kjo përkthehet në më shumë mirëmbajtje, përkthehet në më shumë projekte dhe në më shumë nisma për Gjirokastrën.

Për sa u përket kalldrëmeve, ato do të vazhdojnë në të gjithë qytetin, jo vetëm në Qafën e Pazarit. Ajo çfarë ndodhi në Gjirokastrë këtë vit është që, përtej fasadave, përtej nevojës për të rikthyer kartolinën e memories së Gjirokastrës, për herë të parë u fol edhe për nevojat bazike dhe për sistemet më bazike të kanalizimeve, të cilat sollën edhe këtë ndërhyrje unike, por që do të vazhdojë dhe do të përsëritet edhe në zona të tjera të Gjirokastrës. Jo më larg se një javë më parë kemi pasur edhe në Këshillin Kombëtar të Restaurimit prezantimin e projektit të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë rrjetin e Gjirokastrës. Në Gjirokastrë po investohet jo vetëm në trashëgimi kulturore, por në të gjitha aspektet dhe të gjitha këto të gërshetuara bashkë kanë në fokus zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Ndoshta nuk i keni pasur në vëmendjen tuaj, por modeli i aplikuar është gjithmonë një model investimi, ku bashkëngjitet një plan menaxhimi. Në rastin konkret tipi i Gjirokastrës është ai që do të sjellë në të njëjtën mënyrë, ashtu si edhe në Korçë, ashtu si edhe në Pazarin e Tiranës, ashtu si edhe në qendrën historike të Vlorës, të njëjtin model, i cili, nëse nuk do të ekzistonte, do t'i çonte investimet në një vrimë, vetëm në restaurime muresh. Pra, nuk do të doja që të fokusoheshim vetëm në restaurimin e monumenteve, por të shikonim me të njëjtin vizion, siç shikon edhe qeveria shqiptare, që është një zinxhir i tërë përpjekjesh, projektesh, ku, jo vetëm buxheti i shtetit, por edhe një nga projektet më madhore është përmirësimi i infrastrukturës muzeore në muzetë e Gjirokastrës nga BB-ja, me vlerën 1 milionë euro, siç tha edhe zonja Kumbaro.

Kjo do të thotë që Gjirokastrën ta kthejmë në një tjetër model, që është modeli i muzeut në qiell të hapur dhe kjo, për herë të parë në Shqipëri, do të bëhet në Gjirokastrë.

Mund të vazhdoj me çarjen e kalasë, po njësoj me BB-në, më së fundi jemi duke konkretizuar edhe projektin gjeologjik. Projektet kanë qenë të shumta. Jemi në bashkëpunim më të mirë me BB-në me fokus Gjirokastrën. Po të flas me teknikalitete, ndoshta nuk e dini se, kur ndërmerret një proces restaurimi ose konsolidimi, zërat e papritur gjatë projektimit mund të jenë të shumta. Kështu ka ndodhur edhe me çarjen e shpatit të kalasë së Gjirokastrës, masa të cilat janë marrë me hartimin e një projekti gjeologjik të detajuar. Kjo, normalisht që ka sjellë një vonesë në realizimin e projektit fillestar, por kjo nuk do të thotë që nuk kemi marrë të gjitha masat që ai fond emergjence të përdoret.

Fokusi i Festivalit të Gjirokastrës për vitin 2020 do të jetë një aktivitet kulmor, i cili është zhvilluar në të gjithë këto vite me projekte të ndryshme, sidomos edhe në ndërveprimin

e banorëve me të gjitha projektet që ka ndërmarrë si ministria, si pushteti vendor dhe tani së fundi edhe donatorët e huaj.

Braktisja e monumenteve të kulturës nuk mund të jetë një politikë e Ministrisë së Kulturës, pra rikthimi i qytetarëve me dhunë fizike, por gjithë kjo atmosferë që ju tregova, e gjithë larmia e prekjeve, si në nivelin e menaxhimit, si në nivelin e shtimit të aktiviteteve të reja, si në Qafën e Pazarit, incentiva për të gjithë vitin 2020, përgatitjet për festivalin që fillojnë qysh tani dhe të gjitha aktivitetet ekonomike që ndodhen në Gjirokastrë fillojnë dhe i paraprijnë pjesës kulmore. Pra, të gjitha këto, jam e bindur që do të sjellin edhe një ripopullim të Gjirokastrës.

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Zonja Ministre dhe stafi që keni në krah, ju falënderoj dhe ju kërkoj ndjesë për tensionin që pati këtu, por kështu e ka traditë ky komision, ndaj si duket zakoni del më pas se del shpirti. Duke parë edhe përqindjen dhe trendin që ka ky buxhet, i krahasuar me buxhetin e një viti më parë, që e pranojnë të gjithë se nuk ka qenë një vit normal, por shumë i vështirë, por prapë nuk është ndalur trendi i rritjes në shumë tregues.

Kjo do të thotë që, sado të grihemi e të zihemi ne politikanët, njerëzit e thjeshtë që janë atje në bazë kanë ura më të mira bashkëpunimi dhe komunikimi me njëri-tjetrin sesa ne këtu. Peshore të tilla do të kemi gjithnjë në tavolina të tilla.

Kërkesa nuk ka kufi, nuk ka tavan, por duke parë edhe planifikimin buxhetor, krahasuar me një vit më parë, ju e keni buxhetin 11, 7 % më të lartë se viti 2019. Sigurisht, realizon në mënyrë optimale gjithë projeksionin që ju keni për vitin tjetër buxhetor, 2020-ën, si dhe për atë afatmesëm, 2020-2022.

Unë personalisht, por edhe kolegët e tjerë deputetë, ndjehemi krenarë që kemi diskutuar gjatë dhe kemi votuar ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i cili i ka dhënë efektet e tij pozitive.

Nuk kemi pse të shikojmë se mos gjejmë njolla të murrme në punët e njerëzve, por të shikojmë edhe rezultatet pozitive. Të ardhurat nga biletat dhe nga numri i vizitorëve në sitet, muzetë arkeologjike, kulturore e të tjera e të tjera, që kap ky institucion, të ardhurat e realizuara nga janar – tetori i 2019-ës, krahasuar me 2017-ën, janë rritur 48, 8 %. Pothuajse po arrihet dyfishimi.

Unë vetëm një pyetje kam, lidhur me financimet e huaja. Sigurisht, ashtu si dhe ju më përpara, duke filluar nga ish-ministrja, edhe unë e kam bërë dhe vazhdoj ta bëj këtë pyetje. Para disa kohësh, ambasadori i BE-së, zoti Soreca, në kuadër të financimeve për bashkitë, në lidhje

me investimet rurale, ujësjellës e kanalizime, ka deklaruar një financim, një fond prej 6 milionë eurosh për Parkun Arkeologjik të Bylisit.

Me sinqeritet, e kam uruar ish-ministren, Mirelën, por edhe juve po ashtu. Kishim vënë një bast edhe me mikun tim, Musain. Sinqerisht, u surprizova, por ama do të interesohem, jo vetëm për medien. Është një investim, një projekt vazhdimësie shumë ambicioz, por deri më tani, përveç këtij deklarimi nuk ka asnjë informacion në lidhje me kur do të fillojë, cili është projekti, cilat janë kushtet apo detyrimet e qeverisë. Prandaj, ju lutem, na e sqaroni këtë çështje, për interes të atij komuniteti e më gjerë.

Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Le të japë përgjigjen njëherë ministrja, meqë e nisi.

Elva Margariti – Faleminderit që ma rikthyet në fokus! Ka qenë një angazhim i qeverisë shqiptare, por që e kam vazhduar edhe vetë me Delegacionin e Bashkimit European. Kemi punuar për të gjitha termat e referencës së këtij projekti dhe tashmë kemi finalizuar përzgjedhjen e agjencisë, e cila do të hartojë projektin e zbatimit.

Pra, ai hap i rëndësishëm, i cili konkretizon këtë investim madhor të Delegacionit European, është ndërmarrë. Ajo që do të ndodhë për gjithë vitin 2020 e më pas, do të jetë jo vetëm futja e Bylisit në hartat kërkimore, jo vetëm në fokusin gjithnjë e më të përqendruar të partnerëve të huaj për të bashkëpunuar në Bylis, jo vetëm në futjen e një harte turistike, e cila tashmë ekziston, po që do të marrë një vlerë tjetër, por mbi të gjitha është ajo që thashë edhe në fillim; plani i menaxhimit të Bylisit do të bëjë që jo vetëm zona arkeologjike, por e gjithë zona përreth të shndërrohet në motor zhvillimi.

Atë që kemi pasur në fokus në të gjitha prekjet që kemi bërë, nuk e kemi parë asnjëherë si prekje të veçuar vetëm për emergjencën e restaurimit, por gjithmonë, aty ku kjo prekje restaurimi, do të mund të sillte një rrijetëzim e zhvillim ekonomik jo vetëm të sitit ku bëhet ndërhyrja, por të të gjitha komuniteteve përreth.

Fatjona Dhimitri – Zonja Kumbaro. Vetëm pak shkurt, se po mbaron edhe koha.

Mirela Kumbaro – Në radhë të parë dua të falënderoj ministren për gjithë prezantimin. Siç rezulton edhe nga pyetjet që u bënë, në fakt janë më shumë gjëra nga ç'arriti të thoshte ministrja, për efekt të kohës. Kësisoj, në një farë mënyre, pyetjet tona ndihmojnë për të nxjerrë në pah sa më shumë nga punët e bëra, por edhe nga parashikimet për vitin 2020.

Meqenëse pak më parë kolegu foli për rritjen që ka pësuar buxheti për Ministrinë e Kulturës për vitin 2020, edhe për informacionin tuaj, zonja kryetare, por mirë është ta dinë edhe mediet, se krahasuar me vitin 2013, në vitin 2020 kemi më shumë se dyfishim të buxhetit. Në fakt, në qoftë se Ministria e Kulturës nuk ka qenë asnjëherë objekt i rritjes së buxhetit, e në lidhje me këtë mund të shikoni buxhetin e vitit 2010, 2011, 2012, 2013, ju garantoj, e për këtë mund të shikoni shifrat, buxheti i vitit 2020 për ministrinë e Kulturës është më shumë se dyfishi i vitit 2013. Kjo nuk tregon gjë tjetër, veçse atë që kemi thënë që në fillim të mandatit të parë të kësaj qeverie, se kultura është prioritet, jo për fasadë, por sepse e konsiderojmë një tjetër sektor të rëndësishëm ekonomik lidhur me turizmin dhe agroturizmin.

Në këtë kuptim, sinqerisht që është për t'u përshëndetur buxheti i vitit 2020 në lidhje me këtë rritje.

Thënë kjo, unë kam disa pyetje.

Në radhë të parë, tek shpenzimet kapitale vë re se kemi një rritje, të cilën ju, zonja Ministre, e shpjeguat shumë saktë dhe në mënyrë shumë të detajuar. Është një rritje prej 45 milionë, krahasuar me vitin 2019, që ka të bëjë me përfundimin e një projekti të madh, pa diskutim projekti më i madh në investimet skenike, të bëra ndonjëherë nga të gjitha qeveritë shqiptare, që prej 1990-ës, lidhur me rindërtimin dhe rikonstruksionin e Teatrit të Operas dhe Baletit. Nuk është thjesht rikonstruksion, sepse do të kemi një teatër i cili, sa u përket parametrave të teknologjisë, do të na bëjë të ndjehemi krenarë jo vetëm brenda Shqipërisë por edhe brenda rajonit e më gjerë.

Lidhur me këtë investim, kam dy pyetje:

E para, qofsha e gabuar, por i gjej të disproporcionuara shpenzimet kapitale në fushën e artit, krahasuar me trashëgiminë. Pra, si është menduar të mbulohen? Si do të gjendet zgjidhja? Si e keni ndarë ju buxhetin në lidhje me shpenzimet kapitale në fushën e trashëgimisë?

Mirëmbajtjet janë një gjë, këtë e kam shumë të qartë, por janë mirëmbajtje të cilat përbëjnë jetën e përditshme të restaurimeve në pasuritë kulturore, në monumentet e kulturës. Sa u takon investimeve, të cilat për fat të keq, duke pasur parasysh gjendjen në të cilën i gjetëm në 2013-ën, nuk dalin as një mandat e as dy mandate për t'i mbyllur të gjitha gropat e rrënit të monumenteve të kulturës. Si do të kompensohet kjo, përtej financimeve që bëhen nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë?

Pyetja e dytë, e cila ka të bëjë po me këtë zë, është: në llogari të Ministrisë së Kulturës ka qenë, por në dijeninë time duhet të jetë edhe sot, ai që quhet fondi grek ose fondi i qeverisë greke, në shumën prej 2, 5 milionë eurosh, i dedikuar për Teatrin Kombëtar, që në marrëveshje

me qeverinë greke u dedikuar më pas për Teatrin e Operas dhe Baletit. Nëse nuk përdoret për Teatrin e Operas dhe Baletit, si mendoni ta përdorni atë?

Pyetja tjetër, së cilës ju i dhatë përgjigje deri diku, ka të bëjë me Festivalin e Gjirokastrës, që është një ngjarje vërtetë e rëndësishme, jo thjesht një monument ose një kala e trashëgimisë kulturore materiale, siç e kam quajtur dikur, por është edhe një impuls i madh ekonomik për të gjithë qarkun e Gjirokastrës. Sepse, që ta dini ju, zonja kryetare, në festivalin e kaluar, ishte i gjithë qarku që përfitoi e jo thjesht nga promovimi, por edhe nga ekonomia, sepse rreth 10 mijë artistë e spektatorë rrotullohen brenda harkut kohor të një jave, të cilët flenë, hanë, konsumojnë në të gjithë qarkun. Kjo është një ngjarje shumë e rëndësishme, e cila pastaj krijon vazhdimësi.

A kemi tashmë një buxhet të dedikuar për festivalin, të detajuar dhe të parashikuar për 2020-ën? A do të ketë, e këtë e them edhe si deputete, fonde të dedikuara për qarqet? Sepse përpara se të vijmë te festivali, do të duhet të kemi festivalet e qarqeve. Nga eksperiencia, ndërkohë kam këtu edhe ish-kryetarin e bashkisë së Beratit, që e njeh shumë mirë këtë punë, unë di se janë qarqet ato që duhet të marrin përsipër, me mbështetjen e ministrisë. Nuk e di nëse kemi një parashikim në lidhje me këtë.

Pyetja e katërt ka të bëjë me paketën fiskale. Paketa fiskale, në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, e di që ka të bëjë më shumë me Ministrinë e Financave, por ka një gjë që dua ta sjell edhe në vëmendje, gjë për të cilën kërkoj edhe mbështetjen e kolegëve, që ta mbështesim ministren. Në paketën fiskale të këtij projektligji flitet për përjashtimin e sportistëve nga taksat, për dëmshpërblimet, përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të shpërblimeve që u jepen sportistëve; gjithashtu dhe për personat fizikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm në vlerën mbi 100 mijë lekë, që shumat e sponsorizuara njihen si shpenzime të zbritshme për efekt të llogarisë.

Pra, ka shumë incentiva fiskale, të cilat shkojnë me shumë të drejtë në mbështetje të aktiviteteve sportive.

Kur e kemi nisur këtë iniciativë, me zëvendësministrin e Arsimit dhe Sportit, në mos gaboj, i ngarkuar konkretisht për Sportin, e kemi nisur për të përfshirë brenda edhe Artin e Kulturën.

Ndjesë që mund të jem subjektive, por besoj se arti ka shumë më tepër nevojë, sepse është shumë më pak komercial se sporti, gjë që sigurisht nuk do të thotë të përjashtojmë sportin. Nga ana tjetër, efektet që kjo jep mbi buxhetin e shtetit, janë shumë më të pakta se të sportit, për shkak se është edhe komunitet më i vogël, ka më pak produkte, është më i lirë sesa kostoja

e sportit. Në këtë paketë nuk shoh asnjë rresht incentivimi apo përjashtimi, çlirimi a si të doni, të taksave për artin dhe kulturën.

Domethënë, nuk e di nëse ju, zonja Ministre, keni informacion në lidhje me këtë. Çfarë mund të shpresojmë dhe si mund t'ju ndihmojmë juve, për ta shtyrë përpara dhe për të mos e lënë artin? Sepse, qofsha e gabuar, por vërej këtu një lloj lobimi më të fortë për sportin, nga ç'është bërë për ne, do të thosha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë, dakord, hajde ta mbështesim. Unë dua të di nëse ka një gjë në lidhje me këtë.

Ndërkohë, edhe diçka tjetër, e cila ka të bëjë me...

Fatjona Dhimitri – Mirela, është duke pritur zëvendësministria, kështu që le të mbarojmë.

Mirela Kumbaro – E kam të rëndësishme këtë.

Fatjona Dhimitri – Vetë e keni miratuar kalendarin, kështu që vetë e keni parashikuar edhe orarin. Ç'të bëjmë?

Mirela Kumbaro – Pyetja e fundit ka të bëjë prapë me paketën fiskale. Në paketën fiskale për vitin 2019 kemi miratuar një përjashtim nga taksa për pronën e pronarëve që posedojnë pasuri kulturore, që do të thotë se kanë një banesë trashëgimi kulturore, siç ka në Gjirokastrë, Berat, Korçë, Durrës, në të gjithë Shqipërinë, pronarë që kanë përfutur dhe ia kanë ndjerë efektin. Nuk e shoh këtë gjë brenda projektligjit që quhet paketë fiskale për vitin 2020. Do të detajohet më vete? Si është parashikuar? Do ta kemi prapë këtë gjë sivjet? Kujtoj këtu, se është një parashikim, të cilin e keni të përfshirë edhe në ligjin e ri të trashëgimisë kulturore.

Kam edhe një pyetje të fundit, shkurt: kur është parashikuar hapja e qendrës së librit dhe të leximit, e miratuar me VKM në fillim të këtij viti? A ka një parashikim në buxhet në lidhje me këtë gjë, nëse do të hapet?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Elva Margariti – Po, është e vërtetë, siç thashë edhe në fillim, se një nga sfidat më të mëdha të Ministrisë së Kulturës është përmbushja e një nevoje emergjente për hapësira për artin dhe kulturën. Kështu që, disproporcionin e investimeve në fushën e trashëgimisë, nëse në fushën e trashëgimisë do të konsideronim vetëm pjesën e restaurimeve e mirëmbajtjeve të siteve të mëdha, jemi munduar ta mbushim jo vetëm me fondet e donatorëve të huaj, por edhe me dy politikat kryesore: rritjen e biletave, por mbi të gjitha krijimin e fondit vetiak të këtyre institucioneve.

Me krijimin e këtij fondi të dedikuar, mendoj se do të japim një impet të mirë fillestar për 2020-en, mbi të gjitha edhe duke aplikuar ligjin e trashëgimisë, të miratuar vitin që shkoi. Kuptohet, asnjëherë nuk do të jenë të mjaftueshme, ashtu sikundër nuk janë as në vende më të zhvilluara, me kapital shumë më të madh ekonomik dedikuar Ministrisë së Kulturës. Ajo që kemi pasur në fokus është që, paralelisht me aplikimin e ligjit të trashëgimisë, me krijimin e këtyre fondeve të posaçme, me rritjen e këtyre biletave, me rritjen e shërbimeve në site... Ky ka qenë një element deri diku i munguar, të cilin e kemi në fokus, sikundër dhe autoguidat, sikundër edhe shërbimet e tjera, që të shtojmë elementë plus, për ta bërë atraktive, por për ta bërë edhe ekonomikisht më të qëndrueshme.

Për sa ai përket fondit grek, po, ka qenë pjesë e një diskutimi dhe takimesh të shumta. Fatkeqësisht, për momentin, përtej gjithë vullnetit të mirë të qeverisë sonë, kjo është një çështje që i përket parlamentit. Kështu që, në aspektin diplomatik kam ende disa rezerva, për të cilat nuk do të doja të shprehesh unë.

Festivali i Gjirokastrës ka një buxhet të detajuar, të dedikuar. Siç thashë, jo vetëm në zërat e projekteve për trashëgiminë kulturore kemi shtuar akoma më tepër buxhet, por në lidhje me buxhetin e detajuar për qarqet, puna do të fillojë menjëherë. Janë 9, 6 milionë lekë të dedikuara për të dymbëdhjetë qarqet, që të fillojnë aktivitetin. Është e vërtetë që ne jemi mësuar të themi se Gjirokastra do të marrë përfitime, por në të vërtetë përfiton i gjithë qarku.

Në paketën fiskale, sponsorizimi i artit, po, edhe aty kemi qenë pjesë e tryezave të gjera të diskutimeve. Kemi ndërmarrë shumë bisedime, edhe në kuadër të disa kornizave ekonomike.

E di që duket sikur është evituar pjesa e artit, por në të vërtetë jemi fokusuar te implementimi i disa kapitujve të veçantë në lidhje me artin, për krijimin e shoqërive kulturore ekonomike, të cilat do të incentivohen nga shteti.

Pra, kemi vlerësuar faktin se deri tani, nevoja kryesore për investime, në përgjithësi për artin dhe kulturën, është për hapësira. Kjo nuk është asnjëherë apetibël për asnjë investitor, i cili do të vinte e të investonte në një bibliotekë të re kombëtare, po themi.

Kemi bërë një parashikim të gjerë të zërave, të cilët do të donim t'i çonim përpara për vitin 2020, por deri diku këto nuk mund të përmbushin një parashikim të mbështetjes nga shteti për këtë vit, por nëpërmjet shoqërive kulturore ekonomike, me krijimin e një aktiviteti të ri, që ka të bëjë jo vetëm me vlerësimin e artit viziv, jo vetëm me shitjen e tij, duke e çuar në formula akoma më të frytshme ekonomike. Duke mbështetur këtë, do të krijojmë edhe një sektor të ri, në mbështetje të artit e të kulturës.

Paketa fiskale për taksën. Edhe kjo është diskutuar gjithashtu. Jemi ende në tratativa. Faktikisht, për paketën fiskale në përgjithësi, jemi ende në disa rishikime dhe në një propozim final nga Ministria e Kulturës.

Sa i përket qendrës së librit e të leximit, vërtetë ka qenë një nga nismat e mira të marra nga Ministria e Kulturës, e cila tashmë konkretizohet me shpalljen e fituesit të drejtorit të qendrës së librit. Për momentin, për 2019-ën nuk kemi pasur fonde disponibël për ta vendosur edhe fizikisht qendrën në një ambient, gjë që do të fillojë shumë shpejt në 2020-ën.

Fatjona Dhimitri – Zonja Nikolla, si relatore e projektligjit, mund të thoni diçka.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Do të doja të falënderoja ministren për gjithë shpjegimin shterues, si edhe për informacionin e detajuar që ka sjellë në lidhje me buxhetin, jo vetëm duke evidentuar rritjen prej 11, 7 %, por ç'është më e rëndësishme, edhe eficiencën e burimeve buxhetore në të gjithë këto programe. Nuk do të zgjatem më shumë sepse tabloja ishte e qartë, falë edhe pyetjeve që u bënë nga kolegët, por do të doja të sillja në vëmendjen e komisionit dy momente kryesore, meqenëse jemi komision për kulturën dhe për arsimin, të një shprehjeje të qartë që buxheti për arsimin, ashtu sikurse u evidentua edhe nga zonja Milva, nuk reket vetëm në atë se çka janë fondet dedikuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Këtu patëm një shembull konkret nga ministrja e Kulturës, për dy projekte të rëndësishme, ai i edukimit përmes kulturës, i cili është një projekt që lidhet me Ministrinë e Kulturës, por në fund të ditës është proces edukues, duke na dhënë edhe shifra se sa mijëra nxënës janë përfshirë në këtë projekt, si dhe investimet që lidhen me paktin për universitetin, të cilat na i përmendi ministrja e Kulturës, pra janë fonde që duhen llogaritur te fondet për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Faleminderit dhe suksese, zonja Ministre!

Elva Margariti – Faleminderit!

E fundit, për ta përmbyllur me një tjetër aspekt për “Paktin për Universitetin”, gjithmonë në kuadër të “Paktit për Universitetin”, Ministria e Kulturës në bashkëpunim, duke shtrirë paktin jo vetëm në angazhimin që ka si patronazhim të Universitetit të Arteve, le të themi që Universiteti i Arteve është universiteti kryesor që patronazhohet nga Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Universitetin e Gjenovës, me Fakultetin e Arkitekturës, Politekniku këtu në Tiranë, kemi zhvilluar një *work shop* 10-ditor ku kemi përkthyer të gjitha nevojat e paraqitura për hapësira, teknologji, programe të reja të Universitetit të Arteve në një projekt, ku kemi një studim fizibiliteti tashmë të detajuar i përkthyer në një studim me fokus eficiencën energjetike. Këtë e kemi bërë gjithmonë duke qëndruar në kuadër të faktit në

bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës për Universitetin e Arteve dhe fakti që jemi ndalur te efienca energjetike është fakti që sot direktivat e Bashkimit European jo vetëm na detyrojnë, por edhe na mbështesin në këtë aspekt.

Pra, shumë shpejt këtë projekt do t'ua paraqesim edhe donatorëve të tjerë dhe mendoj se do të jetë një projekt i suksesshëm.

Fatjona Dhimitri – Këtu po ndërpresim seancën dëgjimore me Ministrinë e Kulturës...

Milva Ekonomi – A mund të shtoj diçka?

Fatjona Dhimitri – Po.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin tuaj!

Pas dëgjesave që bëjmë për projektbuxhetin në parim kemi nevojë për diskutimin nën për nën të tij, kështu që mendoj se do të jetë shumë e nevojshme që përfaqësues nga ministria juaj të jenë prezent në këtë komision kur të diskutohet projektbuxheti nën për nën.

Kjo ishte për t'ju vënë në dijeni.

Fatjona Dhimitri – Këtu përfundon seanca dëgjimore me Ministrinë e Kulturës.

Mbyllet pika e tretë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më, 14.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

4.Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me pjesëmarrjen e zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë, zonjës Dajna Sorensen (*për arsimin profesional*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave,

Stavri Lako – përfaqësues i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave,

Elira Demiraj - drejtore e Përgjithshme në Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Ina Dhaskali- përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave,

Lorisa Kushi – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Vijon pika e katërt e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri – Viojmë me diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me pjesëmarrjen e zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë, zonjës Dajna Sorensen.

Të ftuar në komision janë zoti Stavri Lako, përfaqësues i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, zonja Elira Demiraj, drejtore e Përgjithshme në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe zonja Etleva Gjellaj, drejtore në Shërbimin Kombëtar të Punësimit

A është e pranishme zonja Etleva? Nuk është e pranishme.

Fjalën e ka zonja Sorensen.

Dajna Sorensen – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Kënaqësi që ndodhem sërish në komisionin tuaj. Reforma në sistemin e arsimit dhe të formimit profesional është përqendruar në cilësinë e ofertës së arsimit dhe formimit profesional dhe lidhjen që ajo ka me tregun e punës. Harmonizimi i aftësive të ofruara nga arsimi dhe formimi profesional me nevojat e tregut të punës dhe motivimi i sektorit privat për të qenë partnerë në këtë proces reformimi janë dy sfidat më të mëdha me të cilat përballlet arsimi dhe formimi profesional sot në Shqipëri. Në këta 4 vjet, në veçanti i është vënë një theks i rëndësishëm bashkëpunimit me sektorin privat, ku vetë kemi qenë dëshmitarë të faktit që ka pasur rezultate pozitive, veçanërisht sa i takon pjesës së praktikave profesionale në biznes në formën e të mësuarit bazuar në vendin e punës, sikurse edhe në angazhimin e sektorit privat në bordet drejtuese në të gjitha institucionet e arsimit dhe të formimit profesional. Zhvillimi dhe reforma në fushën e arsimit dhe formimit profesional është e bazuar në strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020. Në tetor të këtij viti është shtyrë deri më 2022-in, me anë të miratimit të planit të veprimit për strategjinë kombëtare të punësimit dhe aftësive deri në 2022-in. Synimi i kësaj strategjie përveç objektivave që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me punësimin, është ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë, por edhe personat në të gjitha moshat, duke vënë theksin në mënyrë të vazhdueshme për të nxënin gjatë gjithë jetës, ku çdo individ në shoqëri duhet të ketë një angazhim maksimal për të përditësuar njohuritë e tyre dhe për të mbetur relevant në tregun e punës.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga INSTAT-i për vitin 2018, shkalla e punësimit, sipas nivelit arsimor, është dukshëm më e lartë për ata njerëz që janë diplomuar dhe kanë arsim profesional.

Konkretisht, shkalla e punësimit e personave me arsim të mesëm profesional është 68,3% krahasuar me 53% për ata që kanë mbaruar arsimin e mesëm të përgjithshëm. Ky është një element shumë pozitiv, që nënvizon faktin se ka më shumë nevojë për persona që të ndjekin arsimin e mesëm profesional, sikurse edhe kurse të formimit profesional. Në vitin e ri akademik 2019-2020 në shkollat e mesme profesionale janë regjistruar 18 211 nxënës, por për këtë vit i rëndësishëm është fakti që është rritur ndjeshëm numri i personave që ndjekin arsimin profesional nga zonat rurale. Në Shqipëri, kemi pasur në mënyrë të vazhdueshme një mbulim të vogël të zonave rurale me shërbime të arsimit profesional, aktualisht rreth 45,3% të atyre që ndjekin arsimin e mesëm profesional që vijnë nga zonat rurale.

Gjithashtu, ka një rritje të numrit të personave që vijnë nga grupet vulnerabël që ndjekin arsimin e mesëm profesional, konkretisht kemi një rritje të numrit nga komuniteti rom dhe egjiptian, nga 519 që ishte vitin e kaluar në 580 për këtë vit, sikurse edhe një rritje të numrit të personave me aftësi të kufizuar.

Teksa gjatë viteve kemi pasur një ndërhyrje shumë të madhe për rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm profesional, po aq e rëndësishme është edhe rritja e cilësisë së ofertës që ofrohet nga institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe një element shumë i rëndësishëm i cilësisë është edhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve që janë të angazhuar në sistemin e arsimit profesional. Njohuritë pedagogjike dhe teknike e kërkojnë këtë trajnim të vazhdueshëm, në mënyrë që të mundësojnë mësimin e njohurive bashkëkohore në një mënyrë të kuptueshme. Për këto arsye, kurset e avancuara të trajnimit, të cilat kanë filluar që në vitin 2016, aktualisht për 3 vjet janë trajnuar dhe formuar 491 mësues dhe instruktorë, ndërsa gjatë vitit 2019 janë trajnuar edhe 120 të tjerë.

Për të përmbushur nevojat e tregut të punës me punonjës të aftë deri tani janë zhvilluar 13 përshkrime dhe standarde të kualifikimit profesional, 6 kurrikula kornizë. Është shumë e rëndësishme që përtej këtyre arritjeve që listova në lidhje me arsimin profesional të themi edhe faktin që kemi konsoliduar kuadrin institucional dhe ligjor sa i takon arsimit dhe formimit profesional tashmë me krijimin e 2 agjencive primare, të cilat kanë një rol shumë kyç në lidhje me formimin profesional: Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, e cila është agjencia përgjegjëse, e cila duke filluar nga tani do të marrë përgjegjësinë e menaxhimit të të gjithë ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, të cilat janë shkollat dhe qendrat e arsimit profesional.

Agjencia tjetër është Agjencia Kombëtare për Arsim dhe Formim Profesional dhe e Kualifikimeve, e cila është në një proces të zhvillimit të dy kualifikimeve krejt të reja në lidhje

me programin dhe teknologjitë bujqësore, të cilat janë elemente të futura rishtazi nga agjencia tjetër.

Siç ju përmenda edhe pak më parë, në kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore sa i takon arsimit profesional kemi miratuar rishtazi rregulloren e elementeve thelbësorë të të nxënësve nëpërmjet punës. Kjo është një rregullore që rregullon në nivel kombëtar dhe saktëson rolet dhe përgjegjësitë si të institucioneve publike, ashtu edhe të sektorit privat që angazhohet në programet e të nxënësve nëpërmjet punës. Një fokus të veçantë në arsim dhe formimin profesional kuptohet që ka edhe digjitalizimi, i cili është një prirje globale dhe një domosdoshmëri në tregun tonë.

Me fondet e buxhetit të shtetit shkollat dhe departamentet e formimit profesional janë rikonstruktuar dhe janë në proces ndërrhyrjeje dhe rikostruktimi 7 shkolla dhe reparte të praktikave profesionale.

Po fokusohem pak te projektbuxheti i vitit 2020 për programet e arsimit të mesëm profesional. Politika e programit 2020-2022 synon të përmbushë objektivat në fushën e arsimit dhe të formimit profesional, siç janë të specifikuara në strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi. Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe zhvillimit profesional, i cili garanton arsimin dhe formimin profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet, në radhë të parë, përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe formimit profesional, nëpërmjet ndërrhyrjeve infrastrukturore; zhvillimin e kompetencave të mësuesve të arsimit dhe formimit profesional; përmirësimin e modelit të praktikave profesionale të biznesit në sistemin e ofruesve të shërbimeve publike të arsimit dhe formimit profesional; futjen e kualifikimeve të reja të rishikuara sipas nevojave të tregut të punës; krijimin e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe pilotimin e komiteteve sektoriale të arsimit dhe formimit profesional. Objektivat që synohen në këtë program buxhetor janë rritja e aksesit në arsimin profesional dhe sigurimi i cilësisë në AFP.

Sa u përket treguesve të performancës, këtu kemi të bëjmë me ndjekjen e atyre që diplomohen në arsimin dhe formimin profesional dhe për të parë se sa për qind e tyre rezultojnë të punësuar, pasi kanë konkluduar arsimin e mesëm profesional, kuptohet edhe *bench marking* krahasuar me ata, të cilët ndjekin arsimin e përgjithshëm parauniversitar, numri i të diplomuarve, përqindja e mësuesve të trajnuar me trajnim të vazhdueshëm, përqindja e nxënësve në arsimin profesional krahasuar me ata që ndjekin arsimin parauniversitar, numri i nxënësve femra me synimin që të kemi sa më shumë vajza që ndjekin arsimin dhe formimin profesional, sikurse edhe pjesëmarrja e grupeve vulnerabël, siç janë personat me aftësi të kufizuara, romët, egjiptianët e të tjerë.

Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020 për arsimin e mesëm profesional janë rritur në mënyrë modeste me rreth 1% krahasuar me 2019-ën, por duhet të kemi parasysh faktin që ndër vite ka pasur një rritje substanciale të buxhetit për arsimin profesional. Përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 8%, ndërsa buxheti i arsimit profesional krahasuar me buxhetin e përgjithshëm është 0,18%. Në materialet që ju kemi paraqitur, kemi bërë edhe ndarjen se si janë zërat buxhetorë. Aktualisht, për vitin 2020 buxheti parashikon gati 3,3 miliardë sa i takon arsimit dhe formimit profesional. Fondet buxhetore kanë pësuar një rritje prej 9,4 milionë në krahasim me vitin 2019, sikurse jua përmenda me një rritje prej vetëm 1%.

Për vitin 2020 buxheti i planifikuar ka rritjen në zërat e shpenzimeve, siç janë shpenzime korrente me 169 milionë lekë, i cili është një fond i mjaftueshëm për të zhvilluar politikat ekzistuese dhe të reja në arsimin profesional; është planifikuar një rritje buxheti për bursat e nxënësve që ndjekin arsimin profesional. Për të ngushtuar hendekun gjinor në arsimin profesional, sikurse jua përmenda, pasi për ne është objektiv rritja e numrit të vajzave që ndjekin arsimin profesional, është bërë rishikimi i kurrikulave me bazë gjinore dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave për bursat; tashmë do të stimulohen me bursë nxënëset femra, të cilat ndjekin drejtime në arsimin profesional që nuk janë tipike ose nuk janë të perceptuara për vajzat.

Në përafrim me normat e BE-së është bërë edhe ulja e numrit të orëve të mësuesve të lëndëve të praktikave profesionale në rreth 30 orë nga 24 orë. Për realizimin e uljes së orëve të mësuesve është miratuar një shtesë prej 100 mësuesish në sistemin e arsimit dhe të formimit profesional, si dhe ka një rritje të shpenzimeve korrente për mallrat e shërbimit që do të përdoren dhe që janë të domosdoshme për praktikat profesionale.

Sa u takon shpenzimeve kapitale janë 525 milionë lekë që do të investohen në rikonstruktimin e shkollave, e cila ka filluar që në vitin 2018, e vetmja shkollë e parashikuar për vitin 2019 ku do të fillojë rikonstruksioni është shkolla e Dibrës “Nazmi Rushiti”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë kam një listë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papano” në Gjirokastrë ka filluar tashmë. Fondet e planifikuara për 2020 do të fokusohen në modernizimin e kuadrit ligjor të AFP-së, në rishikimin e programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja, sikurse edhe në zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe të instruktorëve të arsimit dhe të formimit

profesional. Kjo është një tablo e përgjithshme dhe jam e hapur t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve sipas nevojave që mund të keni.

Fatjona Dhimitri – Nga përfaqësuesit e ministrisë kush e do fjalën?

Fjala për relatoren.

(Diskutime pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Përgëzoj zonjën zëvendësministre për prezantimin, si dhe për gjithë punën në vijim për të realizuar objektivat e kësaj qeverie që lidhen me arsimin profesional!

Zonja zëvendësministre na shpjegoi se si buxheti i vitit 2020 do të mundësojë një rritje prej 4%, me më shumë të punësuar, pra nga 42% shkonte në 46% numri i nxënësve që mbarojnë shkollat profesionale, një rritje prej 300 nxënësish që nxjerr arsimit profesional, rritje në 55% të nxënësve që ndjekin arsimin profesional dhe vijnë nga zonat rurale; 30 nxënës më shumë me nevoja të veçanta, që do të ndjekin arsimin profesional; kemi, gjithashtu, një rritje prej 0,5% të nxënësve që mbarojnë shkollën 9-vjeçare, të cilët zgjedhin arsimin profesional në raport me gjimnazin. Pra, këta janë të gjithë tregues të matshëm që ky buxhet adreson për realizimin e tyre.

Këtë do të thosha në lidhje me raportimin e ministres, por përfitoj nga rasti për t'u ndalur edhe në tri momente kryesore që duhen sqaruar.

Do të doja të dija sa për qind e nxënësve që mbarojnë arsimin profesional shkojnë në shkollë të lartë? Sa dhe si është bërë për të modernizuar kurrikulat e arsimit profesional, përshtatur me nevojat e reja që tregu i punës kërkon? Si dhe sa po punohet për tekstet shkollore të arsimit profesional?

Gjithashtu, unë do të doja të dija për mënyrën e trajnimit të mësuesve të arsimit profesional: sa dhe si po realizohet ambicia që edhe punësimi i mësuesve në shkollat profesionale të bëhet përmes portalit “Mësues për Shqipërinë”?

Fatmir Velaj- Zonja zëvendësministre, para disa ditësh në Vjenë u zhvillua një takim në unionin më të madh të industrisë austriake, ku dëgjova emrin tuaj nga familja Çausi në Vjenë, e cila ju falënderon për vendosjen e emrit të shkollës profesionale ish- teknologjike, të “Drit Çausi”, këtij personaliteti të madh.

Me këtë rast, duke njohur edhe atë vetë personalisht, edhe familjen Çausi që janë “creme de la crème” të shqiptarizmit në Austri, doja t'ju falënderoja për këtë.

Musa Ulqini- Ka ardhur kastile nga Vjena.

Fate Velaj- Vetëm për këtë erdha.

Fatjona Dhimitri- Po, zonja zëvendësministre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse Lindita bëri disa pyetje

Milva Ekonomi- Ju falënderoj!

Sa herë vini në komision, ju dëgjojmë me kënaqësi kur flisni për evoluimin e arsimit profesional në Shqipëri dhe se çfarë bëhet për të arsimuar krahun e punës për të qenë të aftë për jetën.

Mbase është mospërqendrimi im, por desha të dija se çfarë po bëhet për arsimin profesional të personave me aftësi të kufizuar, pra do të doja një panoramë për këtë kategori nxënësish.

Dajna Sorensen- Sa i përket përqindjes së numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e lartë në momentin që mbarojnë shkollat e mesme profesionale, shifrat e sakta nuk i kam përpara në këtë moment, por ne kemi në arsimin profesional një sistem të mirëfilltë të gjurmimit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm profesional. Ky është viti i dytë që ne e kemi bërë dhe së shpejti do të fillojmë raundin e tretë të studimit të gjurmimit të rinjve që ndjekin arsimin profesional.

Çfarë ndodh me ta pasi ata diplomohen? Ajo që ne kemi bërë është se ka një variacion shumë të lartë, kemi shkolla ku edhe 90% e nxënësve që mbarojnë arsimin profesional ndjekin arsimin e lartë, kjo varet shumë nga lloji i profilit për të cilin flasim, sidomos shkollat që janë të fokusuara në IT, ku shumica e nxënësve vazhdojnë studimet universitare, por ama ka edhe drejtime të tjera për të cilat nxënësit janë më tepër të interesuar, sepse integrohen direkt në tregun e punës, sidomos në ato sektorë, siç është hoteleri-turizmi, ku kërkesa për krah pune të kualifikuar është shumë e lartë, sikurse kemi edhe një numër në rritje, që janë duke ndjekur arsimin pas të mesëm profesional, që ofrohet nga një gamë e gjerë institucionesh publike dhe private me programe dyvjeçare profesionale.

Të dyja raportet e dy vjetëve të fundit 2017 dhe 2018, janë dokumente publike të publikuara në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, që bën këtë gjurmim në mënyrë periodike dhe ka detyrë funksionale të vazhdojë edhe në vijimësi. Pra, të gjithë ata që diplomohen i ndjekim nëpërmjet studimit gjurmues. Është element shumë i rëndësishëm që sidomos në shkollat e arsimit të lartë duhet bërë, sepse gjurmueshmëria është një element shumë i rëndësishëm për të garantuar cilësinë në arsimin profesional.

Sa u përket kurrikulave, unë e përmenda shumë shkarazi që është Agjencia Kombëtare e Formimit Profesional dhe Kualifikimit, që merret me pjesën e përditësimit të kurrikulave, të cilat rishihen me një periodicitet çdo 4 vjet. Stavri mund të shtojë diçka në lidhje me këtë.

Stavri Loku - Në vijim të fjalës së zonjës zëvendësministre, në këtë agjenci, siç e thamë, grupet e punës, në të cilat marrin pjesë ekspertët e fushës, por edhe përfaqësues nga

komuniteti i biznesit, punojnë për hartimin e kurrikulave të reja për rishikimin e atyre ekzistuese dhe përditësimin e tyre. Ato kanë modalitetet e tyre, metodologjinë e tyre, e cila është e përditësuar edhe në faqen elektronike të agjencisë.

Dajna Sorensen- Një element që tashmë ne e kemi vënë re është se, pavarësisht se agjencia ka punuar për vënien në punë të kurrikulave të reja, ka një lloj rezistence edhe nga vetë ofruesit për të përdorur në maksimumin e tyre menynë e programeve dhe kurrikulave që janë zhvilluar me një tendencë për të ruajtur të njëjtat profile, që ata kanë ofruar në mënyrë të vazhdueshme.

Trajnimi i mësuesve, si funksion, ndahet ndërmjet agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional dhe Kualifikimit dhe atyre që ne i quajmë mundësi zhvillimi, që janë brenda institucioneve të arsimit të mesëm profesional. Bëhet fjalë për një trajnim 21 ditor për didaktikat dhe bazat e mësimdhënies në arsimin profesional për mësuesit e lëndëve profesionale.

Sa i përket portalit, ka një urdhër të ministrit të Financave, që ka pezulluar të gjitha rekrutimet e mësuesve të lëndëve të përgjithshme të shkollave profesionale jashtë portalit dhe ne jemi duke punuar së bashku me Ministrinë e Arsimit për të siguruar që të gjithë mësuesit e lëndëve të përgjithshme të rekrutohen vetëm përmes portalit.

Sa u përket personave me aftësi të kufizuara, unë mendoj se ndryshimi më i madh për rritjen e numrit të personave me aftësi të kufizuara, që ndjekin arsimin e mesëm profesional, është nominal në numra, nuk kemi mjaftueshëm të rinj dhe të reja me aftësi të kufizuara që janë duke ndjekur arsimin e mesëm profesional.

Me miratimin e ligjit të nxitjes së punësimit në mars të po këtij viti, është parashikuar ngritja e fondit social të punësimit, që është ekskluzivisht i bazuar në kontributet që biznesi do të japë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në atë ligj është parashikuar që çdo biznes që ka 24 persona të punësuar, i 25-ti duhet të jetë person me aftësi të kufizuara. Në momentin që biznesi nuk e punëson një person me aftësi të kufizuara, është i detyruar të derdhë pagën minimale për këtë person në një fond të dedikuar, që do të përdoret ekskluzivisht për formimin, trajnimin e individit me aftësi të kufizuara, që mund të jetë i të gjitha grupmoshave.

Ky projektligj do të hyjë në fuqi në pranverën e vitit 2020. Ne aktualisht jemi duke punuar për të ngritur bazën e zbatimit të këtij neni të ligjit të nxitjes së punësimit.

Së bashku me asistencën ndërkombëtare që kemi pasur në këtë rast, jemi duke dizenuar të gjitha programet që do t'ua vëmë në dispozicion personave me aftësi të kufizuara.

Ismet Beqiraj – Unë vij nga arsimi profesional dhe e di peshën dhe rëndësinë tij.

Sot nuk do të shtroj më problemin që Bashkia e Mallakastrës ose bashki të tjera janë instaluar si industri minerare të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, të metalurgjisë, por që është domosdoshmëri hapja e shkollave profesionale. Meqë jemi në kuadër të diskutimit të projektbuxhetit për institucionet e arsimit të lartë, është një apel dhe një mesazh.

Jo vetëm për mua, por edhe për deputetët e tjerë, shqetësimi ynë më i madh është që për shkak të arsyeve moshore dhe ciklit të mbushjes së aktivitetit në punë, po dalin në pension shumë njerëz. Sot nuk kam pse të mos e ndaj edhe me ju, por edhe me publikun një lajm të gëzuar, se më së fundi qeveria ka miratuar një VKM në zbatim të ligjit nr. 29/2019 për trajtimin financiar suplementar të minatorëve të nëntokës, naftëtarëve dhe të metalurgëve. Ky është një lajm i mirë, ku Ministria e Financës ka dhënë kontributin pozitiv. VKM-ja përcakton edhe të gjitha aktet dokumentare të kërkesave që do të kenë përfituesit nga zbatimi i këtij ligji. Unë po shfrytëzoj këtë diskutim në komision që të them se edhe dy draft-VKM-të e përfunduara tashmë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës do të marrin zbatim sa më shpejt. Ato kanë të bëjnë me përcaktimin e listës së personelit inxhiniero-teknik dhe të ndryshimeve përkatëse të VKM-së nr. 526, të datës 20.12.1958 “Për profesionet në Republikën e Shqipërisë”.

Këta janë sektorë të vështirë, duhet të nxiten dhe mbështeten, sepse jemi përballë kësaj situate në të cilën industrinë e naftës dhe të minierave e drejtojnë joprofesionistë, por këto janë pasuri kombëtare që ne do të duhet t'i vëmë në shfrytëzim dhe të fillojë prodhimi i vendit. Ishim me personelin inxhiniero-teknik në Vlorë dhe me Vilmën ndamë të njëjtin shqetësim, madje edhe kudo ku kam shkuar në qarkun e Fierit. Kjo del edhe si domosdoshmëri, zonja zëvendësministre, dhe sigurisht ne deputetët do ta kërkojmë që, pavarësisht se nuk janë planifikuar, del si domosdoshmëri që përgatitja e profesionistit në këta sektorë nuk bëhet për një ditë, ndaj do të kërkoja të stimulohen shkollat për të thithur nxënës, për ta thyer këtë raport, sepse e mendoni në vitin 2019 numri i nxënësve që mbarojnë 9-vjeçaren dhe hyjnë në të mesmen është 19,5% dhe objektivi ynë është 20,1%. Kjo është për pjesën e parë.

Fatjona Dhimitri- Ismet, gjithmonë më thua se nuk të jap fjalën, por duhet të respektojmë limitet kohore që kemi vendosur. Ta kam dhënë mjaftueshëm fjalën.

Ismet Beqiraj – Nuk ka limit kohor këtu.

Fatjona Dhimitri- Po, ka limit. A e ke miratuar vetë orarin e kalendarit?

Ismet Beqiraj– Unë sugjerova, nuk bëra pyetje. Kur jepen edhe lajme të mira, pse irritoheni ju drejtuesit e seancës?

Fatjona Dhimitri- Lëreni ironinë, Ismet!

Ismet Beqiraj – Ju lutem, nuk është ironi, por është lajm i mirë për minatorët, naftëtarët, metalurgët, që sot janë bërë me një vendim. Ne duhet të mbështesim këta sektorë me specialistë.

Te fondet buxhetore, lidhur me investimet kapitale të brendshme dhe të huaja, më rezultoi se planifikimi për vitin 2020 është më i vogël. Po ta marrësh në vlerë absolute, diferenca është me 243 mijë e 563, domethënë e kthyer në milionë, kjo është më pak, po t'i mbledhësh të dyja.

Fatjona Dhimitri – Po, zonja zëvendësministre.

Dajna Sorensen- Po, është vërtetë, sa u përket shpenzimeve kapitale, ka një reduktim. Unë e përmenda edhe gjatë fjalës sime që pjesa më e madhe e këtyre fondeve shkon për konkludimin e punëve të nisura gjatë vitit 2018, rikonstrukcionin e 7 prej shkollave profesionale dhe fillimin e një shkolle të re, që ishte shkolle në Dibër, por paralelisht me këtë ka një rritje të buxhetit në zërat e tjerë të tij dhe në total ne flasim për një vlerë më të lartë prej 9,4 milionë lekësh krahasuar me vitin 2018.

Stavri Loku - Edhe një koment desha të bëj unë në lidhje me atë që tha zoti Ismet. Në prezantimin që kemi bërë për fillimin e vitit shkollor para dy muajsh, kemi konstatuar se në disa rajone, si Korça dhe zona të tjera, ka rënie të numrit të nxënësve dhe ne jemi duke studiuar optimizimin, riorganizimin e ofruesve, i cili ka ndikuar që ne të mos jemi shumë agresivë në investime dhe rikonstrukcionet, por të shikojmë se çfarë mund të bëhet, se mund të mbyllën disa shkolla në Korçë.

Fatjona Dhimitri – Po, Vilma, shkurt, ose ti, ose Almira, do të vijoj edhe unë pak dhe do ta mbyll.

Almira Xhembulla - Unë nuk kam pyetje. Desha të falënderoj, zonjën Sorensen për prezantimin shterues.

Gjithashtu, duke qenë se ka gati më shumë se dy vjet që në këtë komision dhe në atë të Shëndetësisë i kam kërkuar mbështetje sa i përket shkollës profesionale “Nazmi Rushiti” në Peshkopi, dua të falënderoj zëvendësministren dhe stafin, për marrjen në konsideratë të këtij problemi, duke qenë se ajo është një zonë që ka numrin më të madh të atyre që marrin ndihmë ekonomike, zonë që ka nivel ekonomik të ulët dhe një zonë që ka potenciale turistike bujqësorë të panumërta, kështu që besoj se edhe kjo e justifikon gjithë investimin. Unë garantoj që edhe personalisht do të përpiqemi që bashkë me ekipin atje të shkollës ta përdorim dhe maksimalizojmë të gjithë këtë investim që ju keni planifikuar për zonën tonë.

Vilma Bello - Faleminderit! Ju falënderoj, zonja Soronsen, dhe është kënaqësi që ju kemi në komision.

Më vjen keq që nuk kam qenë në dëgjesën që keni bërë për fillimin e vitit shkollor, por do të ndalesha në njërin prej asaj që është thënë atë ditë në dëgjesë, duke përmendur shkollën e mesme industriale “Pavarësia” në Vlorë, si një nga shkollat me numrin më të madh të nxënësve. Gjithashtu, duke iu referuar kësaj, dua të sjell në vëmendjen tuaj edhe rritjen e numrit të nxënësve në Shkollën Tregtare në Vlorë, e cila këtë vit festoi 95 –vjetorin e krijimit. Kuptohet që ky institucion është shumë i rëndësishëm jo vetëm arsimor, por edhe kulturor, madje edhe historik, sepse pozicioni i vendndodhjes së Shkollës Tregtare në Vlorë ndikon shumë në numrin e nxënësve. Kështu, unë dua të vazhdoj që ta nxis këtë gjë, pasi e kemi diskutuar edhe herë të tjera, për t’u parë pozicioni i kësaj shkolle dhe, sigurisht, më pas duhet të ndikojmë të gjithë për ta arritur me anë të një buxheti.

Së dyti, këtë e kam më shumë në formën e një sugjerimi, unë dua të përshëndes uljen e numrit të normave të instruktorëve në shkollat profesionale. Kjo është vërtet për t’u përshëndetur dhe e vlerësoj këtë gjë, pasi e kemi diskutuar edhe me drejtuesit e shkollave profesionale. Unë dua t’ju pyes, ose le ta bëjmë në formën e një diskutimi apo sugjerimi, nëse e keni menduar që këto vakanca, këto hapësira të reja të krijuara për mësimdhënie në ato shkolla mund të mbulohen nga nxënës, të cilët e kanë mbaruar këtë shkollë dhe kanë kryer një praktikë të caktuar për 3 apo 4 vjet ose në biznese private, ose me iniciativat e tyre personale. A është parë kjo mundësi, sepse mund të ketë nxënës që kanë marrë një formim shumë të mirë te këto shkolla, të cilët mund ta kryejnë shumë mirë rolin e instruktorëve?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Po, zonja Zëvendësministre.

Dajna Sorensen – Dua të jap një përgjigje shumë të shkurtër lidhur me pyetjen e fundit. Faktikisht ne jemi duke parë udhëzimin për organizimin e ofruesve dhe procedurat për rekrutimin e stafit drejtues të mësuesve e të tjera. Një nga pikat, shpresoj të mos jem e gabuar, që ne kemi vendosur aty është që t’i japim prioritet lëndës së praktikave profesionale për mësuesit, të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme profesionale për atë drejtim, jo eksplicite për nxënësit, siç u shprehët ju, por për t’u dhënë prioritet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi shumë raste *de facto* të ketë ndodhur një gjë e tillë. Për shembull, te shkolla Hoteleri-Turizëm ka disa raste që nxënësit janë rikthyer dhe janë bërë mësuesit e ardhshëm.

Fatjona Dhimitri – Zonja Zëvendësministre, gjatë dëgjesës që kemi pasur, pak a shumë, i kemi konsumuar disa pyetje. Ajo që unë dua t’ju pyes, edhe në respekt të kohës, pasi jemi në limitet e saj, ose më mirë të themi e kemi tejkaluar kohën e parashikuar, ka lidhje me fondet e planifikuara për vitin 2020. Në relacionin tuaj ju theksoni se këto fonde do të

fokusohen në modernizimin e kuadrit ligjor që rregullojnë aktivitetin e ofruesve në sistemin e arsimit të formimit profesional. Si do të modernizohet kuadri ligjor, sipas parashikimeve tuaja në buxhet? Pra, a ka nevojë për fonde buxhetore ky kuadër ligjor? Kjo, pak a shumë, duket absurde. Gjithashtu, e njëjta pyetje është edhe për rishikimin programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirëse në zbatim të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Sërish e njëjta pyetje: a ka nevojë për fonde buxhetore ky kuadër ligjor për t’u rregulluar? Gjithashtu, sërish një ndër parashikimet tuaja në fondet e planifikuara për vitin 2020 është edhe zhvillimi i kompetencave të mësuesve dhe instruktorëve të arsimit të formimit profesional. Si do të realizohet zhvillimi i kompetencave të mësuesve dhe instruktorëve të arsimit të formimit profesional? Cili është buxheti sipas zërave dhe si do të shpërndahet ky buxhet? A e keni menduar ju këtë gjë?

Dajna Sorensen – Absolutisht po, sepse aty ka pa fund hapësira për t’u shprehur shumë më qartë dhe më mirë. Në rastin konkret janë dy agjenci që do të merren për të zbatuar pikërisht këto akte nënligjore, të cilat, tashmë, kanë dalë dhe kanë një kosto shumë të lartë të burimeve njerëzore. Këto dy agjenci do të angazhohen për të bërë qoftë kurrikulat e reja, qoftë edhe trajnimet e mësuesve.

Fatjona Dhimitri – Lidhur me këtë çështje, besoj se do të kemi një dëgjësë tjetër. Kështu që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne mund të kemi shumë pyetje, por më duhet të shkoj në Konferencën e Kryetarëve, kështu që seancën dëgjimore me zëvendësministren për buxhetin e vitin 2020 e përfundojmë këtu.

Unë ju kërkoj ndjesë, sepse më duhet të shkoj në Konferencën e Kryetarëve, kështu që në vazhdim mbledhjen do ta drejtojë zonja Milva. Faleminderit!

Mbyllet pika e katërt e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 12.30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

5.Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me RTSH-në.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Thoma Gëllici – drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Kristaq Traja - kryetar i KDRTSH-së,

Pandi Madhi - kryetar i Bordit të Administrimit në RTSH,

Sokol Gjoshi - drejtor në Drejtorinë Juridike në RTSH,

Etleva Kadcadej - drejtore në Drejtorinë Ekonomike në RTSH.

Vijon pika e pestë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Unë ju kërkoj ndjesë, në qoftë se jemi vonë, sepse kemi pasur dëgjesa të gjata me institucionet. Ju duhet të kuptoni se buxheti është gjithmonë kërkuar, pasi të gjithë kanë nevojë të sqarohen për të kuptuar se si është planifikuar.

Ne ju kemi thirrur sot për të na dhënë një panoramë se si e mendoni ju alokimin projektues të buxhetit për institucionin tuaj, nëse keni kërkesa shtesë, çfarë argumentesh keni dhe çfarë raporti do të na jepni. Ju na keni prezantuar diçka me shkrim për minimumin apo maksimumin e domosdoshëm të kërkesave që ju keni për këtë buxhet. Pasi ju të prezantoni kërkesat tuaja, pa dyshim që anëtarët e komisionit do t'ju bëjnë disa pyetje lidhur me propozimet që ju do të bëni.

Kështu, unë dua të falënderoj për prezencën sot, këtu, zotin Kristaq Traja, zotin Thoma Gëllçi, i cili pa dyshim iu është përgjigjur gjithmonë kërkesave tona, zotin Pandi Madhi, zotin Sokol Gjoshi dhe zonjën Etleva Kadcaj.

Unë nuk e di se si e keni menduar ju prezantimin, nëse do ta bëjë zoti Traja apo zoti Gëllçi.

Kristaq Traja – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Ne jemi mbledhur në këtë tryezë për të diskutuar disa pika shumë specifike financiare të axhendës. Më mirë për këtë çështje mund të flasë zoti Pandi ose drejtori i Përgjithshëm, kështu që, me lejen tuaj, po ua kaloj atyre fjalën.

Milva Ekonomi – Prezenca juaj këtu na bën të kuptojmë se për bordin e RTSH-së ose për Këshillin Drejtues të RTSH-së buxheti është një moment shumë i rëndësishëm, sepse vetë prezenca juaj këtu tregon se sa shumë rëndësi ka kjo çështje për ju.

Kristaq Traja – Absolutisht!

Ne këtë kompetencë kemi, nuk kemi të tjera.

Milva Ekonomi – Ligji ju jep më shumë, jo vetëm këtë.

Kristaq Traja – Po, për të qenë modestë.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Zoti Gëllçi, fjala për ju.

Thoma Gëllçi - Falënderoj anëtarët e Komisionit të Medies për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë RTSH-së në të gjitha kërkesat e saj, sidomos për mbështetjen që qeveria të na japë më shumë fonde nga buxheti i shtetit.

Unë dua t'ju raportoj se kërkesat tona për vitin 2019, me gjithë mbështetjen e komisionit tuaj dhe të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, në qoftë se e kujtoni ne bëmë edhe një

mbledhje në ambientet e RTSH-së, dhe të gjitha propozimet tona, edhe pse ju i miratuat, u hodhën poshtë, u zeruan dhe nuk na u dha asnjë qindarkë shtesë nga buxheti i shtetit. Kështu, më lejoni t'ju them se edhe për këtë vit unë nuk jam optimist që kërkesat tona do të merren parasysh nga qeveria. Përveç kësaj, gjatë vitit të kaluar Ministria e Financave na e ka shkurtuar fondin që ishte bërë për një procedurë tenderimi, sepse kjo kontratë ishte lidhur, duke e futur RTSH-në në borxh me një kompani private në shumën 100 milionë lekë. Është e pashembullt që për një kontratë të lidhur, të shkurohen fondet në mes të procedurës. Ne mund të përballemi me një gjyq me kompaninë private, të cilin, sigurisht, e kemi të humbur, sepse kjo kontratë duhet paguar. Me të gjitha premtimet që ka bërë Ministria e Financave në të gjitha takimet që kemi bërë se këtë çështje do ta zgjidhnin me një aktin normativ, deri tani nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim.

Gjithashtu, po ju them se buxheti i vitit 2020, që na ka ardhur neve, ka shkurtime në zërat përgjegjës. Këtu jo vetëm që nuk është parashikuar ndonjë ndihmë apo shtesë, por janë shkurtuar edhe zërat, që ligji i detyron në mënyrë taksative në buxhetin e shtetit që ta mbështesë RTSH-në. Në qoftë se këto shkurtime do të miratohen nga parlamenti siç janë propozuar nga Ministria e Financave, atëherë po ju them se vitin e ardhshëm do të kemi mbyllje ose shkurtime të Orkestrës Simfonike të RTSH-së, mbyllje të radios së jashtme, mbyllje të transmetimeve satelitore dhe pezullim të të gjitha reformave strukturore dhe teknologjike që janë ndërmarrë deri tani në RTSH, duke e lënë të mangët zhvillimin. Njëkohësisht, do të mbyllem edhe muksin e dytë të transmetimeve tona digjitale, në të cilin mbështeten të gjithë transmetuesit privatë të Republikës së Shqipërisë, por që financohet me humbje në transmetimet e RTSH-së. Për shembull, RTSH-ja ka katër transmetues në Kukës në zonat rurale, të cilat në muksin e dytë mbështeten vetëm nga televizioni i Kukësit dhe në muksin e parë nga RTSH-ja. Televizioni privat i Kukësit, sipas tarifave të përcaktuara nga AMA, duhet të paguajë rreth 450 euro në muaj, një shumë qesharake kjo duke llogaritur që vetëm një transmetues ka një shpenzim prej rreth 200 mijë lekësh të rinj në muaj harxhim të energjisë elektrike. Po kështu, është gjendja edhe në muksin e dytë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ministria e Financave, në vend që të shtojë fondin për përballimin e SLA-së, kontrata e shërbimit me kompaninë gjermane propozon që ta pakësojë atë. Siç e kemi raportuar edhe më parë, kontrata e SLA – së, me gjithë TVSH-në, është në shumën 2,2 milionë euro në vit, e cila, po të pjesëtohet me 2, është 1,1 milionë për RTSH-në dhe 1,1 milionë për muksin e dytë. Në qoftë se qeveria nuk do të na japë fonde, atëherë RTSH-ja është e detyruar që ta mbyllë muksin e dytë dhe operatorët privatë le të shkojnë ku të duan.

Megjithatë, pavarësisht pesimizmit tim, duke besuar se fjala juaj do të jetë në mbështetjen tonë dhe duke besuar se edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave do të arsyetojë për këto shkurtime, Ministria e Financave duhet të tërhiqet nga disa propozime. RTSH-ja ka disa nevoja urgjente, të cilat duan patjetër mbështetje nga buxheti i shtetit, sepse kështu e thotë edhe ligji. Për shembull, ne kërkojmë nga buxheti i shtetit rritje të financimit për programet “Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit” dhe “Shërbimi në gjuhë të huaj” në masën 100 milionë lekë, duke e argumentuar se RTSH-ja gjatë kësaj periudhe ka arritur të krijojë një sistem model, që siguron transmetimin e 2 programeve në HD, 4 programeve SD në satelit, si dhe 4 programeve në radio në standardin DVB-T2. Me investimet bëra në sistemin satelitor kudo që jetojnë shqiptarët në Europë, nga një kanal që ndiqnin para vitit 2017, sot ndjekin 6 kanale transmetimi dhe 4 kanale radioje, por të gjitha projektet dhe investimet tona kanë qenë me argumentin se ne duhet të kalojmë në një teknologji të re që të bëhet i mundur transmetimi i të gjithë paketës së RTSH-së në transmetimet satelitore, jo vetëm për shqiptarët jashtë atdheut, por edhe për shqiptarët që jetojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kontrata parashikon se 5% e popullsisë së Shqipërisë mbetet jashtë transmetimeve digjitale DVB-T2. Domethënë 5% e Shqipërisë, që janë të paktën 150 mijë banorë, nuk mbulohen nga transmetimet tokësore të RTSH-së dhe të asnjë platforme tjetër, të cilat duhet të mbulohen në transmetime satelitore, të barabarta me transmetimet tokësore. Kjo është edhe strategjia e qeverisë për digjitalizimin, por deri tani nuk është parashikuar asnjë fond mbështetës për këtë. Pra, ne kërkojmë një shtesë prej 100 milionë lekësh për kostot e shpenzimeve të *WaterSat*-it apo të ndryshimit të teknologjisë sonë.

Për Orkestrën Simfonike të RTSH-së ne kërkojmë një shtesë të financimit buxhetor në masën 35 milionë lekë, sepse e detyron ligji që ta bëjë këtë gjë. Shqiptarët nuk paguajnë asnjë tarifë për aparatin televiziv, në mënyrë që të sigurohet financimi i Radiotelevizionit publik për të mbuluar ato grapa që lë buxheti i shtetit.

Tarifa e aparatit që paguan populli duhet të përkthehet në programe me më shumë sport, më shumë koncerte, më shumë argëtim dhe më shumë informim dhe jo në më shumë antena, më shumë karburante e të tjera, sepse këto janë detyrime që i ka buxheti i shtetit.

Po kështu, edhe për shpenzimet Orkestrës Simfonie, që nuk i kemi llogaritur asnjëherë, janë shpenzime të cilat e rëndojnë buxhetin e RTSH-së.

Ne kërkojmë buxhet shtesë për investime në teknologji në vlerën minimale 355 milionë lekë, të cila ia kemi bërë të qartë qeverisë dhe juve që më përpara dhe nuk kemi lëvizur nga projektet e mëparshme, sidomos për gjendjen alarmante të pasurisë kombëtare që ndodhet në Radiotelevizionin Shqiptar, të arkivit. Pra, ne nuk po sigurojmë dot mirëmbajtjen fizike të këtij

arkivi dhe jo më ta bëjmë atë të aksesueshëm për të gjithë dhe të jetë një vlerë për programet e RTSH-së me digjitalizimin e saj.

Ne kemi nisur një projekt të digjitalizimit të arkivit modern të prodhimit të ri të RTSH-së, prodhimit digjital, por ama mbeten në një rrezik të lartë të gjithë prodhimet radiofonike të bëra që nga viti 1938 dhe transmetimet televizive që filluan në vitin 1970, pra është në rrezik shkatërrimi e gjithë kësaj pasurie të madhe kombëtare.

Gjithashtu, pavarësisht investimeve domethënëse që janë bërë në transmetimet televizive, rrjeti i radios ka rreth 40 vjet pa asnjë investim. Ne sot transmetojmë në tre radio, si: “Radio Tirana 1”, “Radio Tirana 2” dhe “Radio Tirana klasik” në FM. Me “Radio Tirana 2” dhe “Radio Tirana klasik” ne transmetojmë vetëm për Tiranën nga mali i Dajtit. Kjo e vë në një pozitë penalizuese të gjithë Shqipërinë. Por edhe “Radio Tirana 1” nuk ka mbulim të mirë në rrugët kombëtare, si në Rrugën e Kombit, por edhe në rrugët e reja që janë hapur apo ato ekzistuese. Kjo për shkak të mungesës së investimeve prej 40 vjetësh, pra që nga viti i largët 1980 nuk janë bërë investime në rrjetin FM.

Ne kemi bërë kërkesë për një projekt në rrjetin FM, që Radio Tirana të jetë njëloj siç është edhe në rrjetin e transmetimeve televizive, por për këtë kërkohej shtesa.

Të mos zgjatet shumë, sepse i kemi thënë të gjitha edhe në materialin që kemi paraqitur, ne kërkojmë një shtesë prej 585 milionë lekësh në total. Kjo shtesë duket e madhe, por nevojat janë shumë herë më të mëdha.

Po them një shembull nga Mali i Zi, që e kemi afër dhe që është vend më i vogël, vetëm për studion lëvizëse që ata blenë kohët e fundit, qeveria pagoi 5 milionë euro. Pra, ky është një investim për një studio prej vërteti. Ne nuk po kërkojmë këto shifra dhe këto lukse, por po sajojmë gjërat me mjete rrethanore, duke ndryshuar transmetimet. Unë nuk e di përse, por organet që merren me këtë punë nuk kuptojnë aq sa duhet nevojat e vërteta të RTSH-së, duke hapur një legjendë që në RTSH ka para me shumicë e të tjera.

RTSH-ja është e hapur për kontrollin financiar të të gjitha natyrave. Buxheti i RTSH-së është 17 milionë euro, nga të cilat 11 milionë euro kalojnë vetëm për transmetime digjitale dhe pjesa tjetër janë rroga, sigurime shoqërore dhe dieta. Pra, nuk mbetet asnjë qindarkë për financimin e studiove të reja, për programe dhe spektakle të mëdha që të rikthehet emri.

Vazhdimisht kërkohej që RTSH-ja të organizohet dhe të punojë si një korporatë private, por kjo gjë nuk duhet lejuar. RTSH-ja është pronë e popullit dhe duhet t’i shërbej popullit, nuk duhet t’u shërbejë atyre që bëjnë reklama në RTSH. Nëse do t’i kërkojmë RTSH-së të bëjë rolin e reklamuesve dhe të bëjmë programe sipas interesave të kompanive që duan reklama, që ne të marrim më shumë para, atëherë ne nuk do të bëjmë detyrën tonë përpara popullit. RTSH-

ja është një institucion publik, që duhet të veprojë me para publike. Ky është mendimi ynë, por jo me para të buxhetit, sepse ashtu do të bëjmë edhe lojën e buxhetit. Ne mendojmë që buxheti duhet të zbatojë detyrimet që ka në ligj dhe jo të financojë programet apo lajmet, sepse ato i financon taksa e popullit. Unë jam i hapur për pyetje. Nëse Pandi ka ndonjë gjë, mundet të shtojë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A keni nevojë të shtoni ndonjë gjë për buxhetin? A ka ndonjë pyetje nga deputetët për projektbuxhetin? Po, zoti Fadil.

Fladil Nasufi – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Të nderuar drejtues të bordit të RTSH-së,

Për të thënë të vërtetën, ne jemi të familjarizuar me problemet e RTSH-së, sepse i kemi dëgjuar disa herë dhe e kemi verifikuar situatën në vend edhe me vizitën që kemi bërë si komision. Gjithashtu, nuk më vjen mirë që trendi i financimeve ka rënie, sepse nuk ka zgjidhje të problematikave, siç e parashitroi edhe drejtori i Përgjithshëm. Pra, ne e kemi pasur një buxhet me 865 milionë në vitin 2017, ndërsa sot kemi 634 milionë në parashikimin e vitit 2020.

Televizioni Shqiptar është pronë publike dhe trashëgon një teknologji të prapambetur, ku i shtohen kostot sociale nga ndërhyrjet që i bëjmë ne me mosndërprerjen e kanaleve analoge dhe problemet e dekoderave që janë pjesë e kompensimit që duhet të marrin për kostot financiare që ata kanë dhe për përfitueshmëritë që vijnë nga funksionaliteti që ato kryejnë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Të gjithë e dimë që trendi në Televizionin publik shqiptar ka ardhur në rritje me programet që janë shtuar dhe stafi ka bërë të pamundurën që ta transformojë rrënjësisht në këto vite, që e drejtojnë i nderuari Traja dhe drejtori i Përgjithshëm, zoti Gëllçi, por e kanë të pamundur të konkurrojnë tregun privat. Ne nuk kemi përse ta fshehim që në studiot e RTSH-së, prezenca e personaliteteve të larta është e varfër dhe nuk e di se kush mund të ketë shkuar.

Unë mendoj që Komisioni i Ekonomisë duhet të shkojë dhe ta shikojë se në çfarë gjendje është kjo pasuri dhe se si arkiva mund të degradojë. Aty ruhet e gjithë historia dhe pasuritë filmike, të cilat një orë e më parë duhet të garantohen dhe të digjitalizohen.

Gjithashtu, mbështes Orkestrën Simfonike, si për nivelin e pagave, ashtu dhe për përfaqësimin që i bën vendit, sepse, në fund të fundit, Ansambli i Këngëve dhe Valleve, Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit dhe Banda janë përfaqësuese, pra janë konsumatorë të fondeve, por ata duhet t'i marrin ato para, sepse ne duhet të ruajmë identitetin dhe përfaqësimin tonë me institucionet tona kombëtare dhe ne duhet t'i mbështesim me politika, por edhe financiarisht e jo me tkurrje të buxheteve.

Zonja kryetare, unë mendoj se ne nuk kemi rituale që atë që kemi thënë vjet ta themi edhe këtë vit dhe të mos ndryshojnë shifrat, por ne duhet ta ngremë zërin dhe të mbështesim paketën financiare modeste, që duhet të ndryshojë të gjithë ato prioritete që parashtroi edhe Thomai sot.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Kush e do fjalën tjetër? Po, zonja Lindita.

Lindita Nikolla – Unë dua të falënderoj drejtorin e Përgjithshëm për të gjithë prezantimin dhe për të gjithë punën që është bërë në reformimin e këtij institucioni, por nevojat që ju keni janë 92%, po aq sa është buxheti. Unë nuk dua të zgjatem shumë, por për një vëmendje të shtuar të komisionit ndoshta duhet të rendisni edhe një rend prioritar të nevojave, në mënyrë që ne të jemi të mirorganizuar në kërkesën që do t'i bëjmë Komisionit të Ekonomisë, për të rishikuar dhe për të parë se çfarë mund të bëjmë për të shtuar buxhetin.

Milva Ekonomi – Po, Adelina.

Adelina Rista – Faktikisht, nuk ka sesi të mos rritet pesha e përgjegjësisë, kur shkalla e ndjeshmërisë është e lartë. Sa herë që dëgjojmë kërkesat e RTSH –së, Fadili e tha shumë mirë që tashmë jemi familjarizuar me to, nuk ke se si të mos ndihesh keq. Unë, si anëtare e komisionit, ndihem keq. Nuk kam nevojë të përfytyroj sesi është gjendja në RTSH, sepse e kam të qartë dhe e kam prekur nga afër së bashku me komisionin, të gjithë gjendjen e Radiotelevizionit. Vajtja jonë si komision na ndihmoi shumë për të perceptuar qartë nevojat që ka RTSH-ja. Pavarësisht pesimizmit të drejtorit, i cili ka të drejtë të jetë pesimist, ne edhe një vit më parë kemi qëndruar fort përpara Komisionit të Ekonomisë për të prezantuar të gjitha kërkesat që kishte RTSH-ja në mbështetjen financiare, si për rinovimin e teknologjisë, ashtu dhe për arkivin. Këtu do të qëndroj pak, sepse prodhimi radiofonik dhe prodhimi radioteleviziv është një vlerë kombëtare, prandaj duhet ta shikojmë në këtë këndvështrim. Pra, është një vlerë kombëtare e papërsëritshme dhe e pazëvendësueshme, prandaj ne duhet të ndërhyjmë fort që të mbështetet financiarisht dhe të shkojë drejt digjitalizimit.

Unë jam dakord me Linditën, si relatore e buxhetit në këtë komision, që të rreshtojmë të gjitha prioritetet. Mua më duket se të gjitha janë prioritete këtu, sepse edhe orkestra duhet mbështetur, që të mos shkojë drejt degradimit. Me sa di unë ju, paguani edhe kredinë për...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, prandaj RTSH-ja duhet mbështetur, nëse duam që të ecë dhe ta çojmë në modelin e standardeve ku janë edhe televizionet e tjera private, sepse nuk konkurren dot në

këtë gjendje që është sot me televizionet private. Pra, duhet mbështetur financiarisht dhe si komision duhet të qëndrojmë fort për prioritetet që ka Radiotelevizioni.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Unë dua të shtoj një gjë, Adelina, nuk është hera e parë që bëjmë dëgjese për projektbuxhetin e RTSH-së dhe nuk është hera e parë që ne, si komision, mendojmë se duhet të japim një shtesë buxheti, por nuk është detyra jonë të marrim vendim për këtë shtesë, sepse e dimë shumë mirë që vendimet merren nga Komisioni i Ekonomisë, për arsye të organizimit të punës në Kuvend.

Problemi që kemi është se ne duhet të rendisim prioritetet e RTSH-së, që të kërkojmë një minimum dhe një maksimum për shtesë. Pra, ky është diskutimi që mund të bëjmë, të rendisim prioritetet.

Nga ana tjetër, ne, si Komision i Edukimit, Kulturës dhe Medias, marrim pjesë në shumë aktivitete, por media ka qenë më sensitive këtë periudhë për arsye të lirisë, të vetërregullimit dhe të ndryshimeve që duhet të pësojë Enti Rregullator. Kudo që kemi shkuar, vlerësimet për progresin që ka bërë RTSH-ja kanë qenë të evidentuara nga kombëtarët dhe ndërkombëtarët.

Gjithashtu, edhe numri i programeve të RTSH-së është shtuar. Ndërkohë, i kemi edhe vetë të prekshme me anë të aplikacionit “RTSH Tani” në celular.

Tjetra, për ne është i rëndësishëm edhe transmetimi i veprimtarisë së Kuvendit në kanalin e dedikuar të RTSH-së. Pra, edhe kjo është një arritje. Mendoj të biem dakord në parim me diskutimet që bëjnë dhe përfaqësuesit e RTSH-së të na vënë minimumin e domosdoshëm në dije, sepse maksimumin e kemi kuptuar vetë.

Para se ta merrni fjalën ju, do t’i jepja një minutë kohë zotit Ulqini.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

Ismet Beqiraj – Unë u bashkohem shqetësimeve të kolegëve parafolës. Ne nuk i krahasojmë buxhetet me 6, 7, 8 apo 10 vjetët e kaluar, por me vetveten. E mbështes atë që tha Fadili, sepse bëjnë statistikën e trendit të buxhetimit që i bëhet këtij institucioni të rëndësishëm kombëtar, i cili është në rënie.

Pushteti i katërt mediatik, sidomos televizionet, janë kthyer gati në vaftin e katërt, që hahet në çdo kohë, pra shpirtëror për qytetarët dhe për publikun, ndaj edhe mbështetja e këtij institucioni është domosdoshmëri.

Jam plotësisht dakord me sugjerimin që bëri zonja Lindita dhe drejtuesja e mbledhjes, por kam një pyetje. E pyeta me zë të ulët, por do ta bëj me zë të lartë, që të regjistrohet dhe të dëgjohet ku duhet : zoti drejtor, sa përqind të taksës së televizionit merr RTSH-ja?

Thoma Gellçi – RTSH-ja merr 90%. 10% e mban OSHE-ja.

Ismet Beqiraj - Në vazhdim të fjalës sime, është një nga burimet ku ne duhet jo vetëm të vendosim prioritetet e kërkesave për të dhënë mendim, por duhet të mbështesim sidomos RTSH-në, sepse është një nga burimet. Por pse jo, unë dhe kolegët e komisionit si grup deputetësh, meqenëse tani po diskutohet buxheti, të bëjmë një amendim për ndryshimin e transfertës së kësaj takse në favor të RTSH-së, në mënyrë që digjitalizimin e arkivit, të memories së historisë së kombit tone, të mos e përdorin dhe shfrytëzojnë në studiot televizive televizionet periferike. Sinqerisht, nuk jam kundër tyre, por këtë pasuri të madhe ta ketë ky institucion. Në një kohë që të tjerët e përdorin duke bërë emisione, RTSH-ja nuk duhet të mbetet në atë situatë. Ne e kemi prekur këtë problem, ndaj si deputet kërkoj që edhe komisionet e tjera, së pari, Komisioni i Financave dhe Ekonomisë, të shkojë për ta parë.

Kemi një shqetësim. Bëhet transmetimi *online* i të gjithë veprimtarisë parlamentare, seancës dhe komisioneve. Sapo mbaron transmetimi, nuk e gjen në asnjë rrjet social, *youtube* ose medien elektronike këtë vlerë dhe pasuri, sepse, në fund të fundit, ne nuk prodhojmë vetëm politikë, por edhe ide dhe zhvillim. Këtë po e ngre si shqetësim.

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Fjalën e ka Ulqini.

Më pas, do të flisni ju.

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë do të bëj një koment dhe do të ndalem në tri çështje.

Së pari, për shkak të dështimit 100% vitin e kaluar, për të qenë të dobishëm për RTSH-në, megjithëse ne, si komision, si drejtues dhe si relatorë bëmë maksimumin më shumë se asnjë herë pranë komisionit përkatës, këtu në Kuvend.

Unë vërej se si asnjëherë tjetër në këta 30 vjet që ka një diferencë dhe diskordancë të jashtëzakonshme mes ndryshimit të përditshëm, që ndodh në RTSH për mirë, dhe mbështetjes së munguar nga qeveria, thjesht dhe vetëm në zbatim të ligjit që është në fuqi. Asgjë më shumë se kaq. Për shkak se unë kam parë në këta 30 vjet që transmetuesi publik të ketë mbështetje të hapur nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, të cilat mbulojnë çështjet e transmetimeve publike dhe qëndrimit që mban qeveria ndaj transmetuesit publik, nuk kam pyetje, nuk kam asgjë për të thënë, por do të shpreh vetëm keqardhje dhe dua të falënderoj kryesinë e këtij komisioni që për herë të parë më ka bërë një nder, duke mos më caktuar relator, sepse do ta

kisha shumë të vështirë të firmos diçka, për të cilën unë e di që do të jetë një formalitet dhe nuk do të ketë asnjë ndryshim. Nuk kam qenë më shumë pesimist në jetën time sesa jam sot për këtë çështje. Transmetuesi publik është pasuri kombëtare dhe kërkohet të fuqizohet si një e mirë e madhe publike. Kjo nuk ka lidhje me ata që drejojnë atje, por me një standard të kërkuar me forcë nga të gjitha institucionet demokratike që na monitorojnë në Bruksel, në Strasburg dhe kudo tjetër.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Zoti Gëllçi, dëshironi të shtoni diçka?

Thoma Gëllçi – Dua të them atë që më kërkuat, për prioritetet. Siç e tha zonja Nikolla dhe ju, ne kërkojmë shtesë po aq sa është parashikimi i buxhetit. Këto i kemi kërkuar edhe vitin e kaluar, ku u përdor e njëjta logjikë, por nga Ministria e Financave na u tha: “Shuma që kërkon është vërtet e domosdoshme, por janë shumë. Kërkoni më pak, që të mund t’jua japim, sepse kaq nuk jua japim dot.”. Pavarësisht se kjo shumë është e domosdoshme për investimet në arkiv, për investimet në radio apo për transformimin teknologjik të brendshëm të RTSH-së, pavarësisht se, në bazë të ligjit, këto nuk janë detyrime të tarifës së publikut për të financuar, por janë detyrime të buxhetit të shtetit, atëherë, le ta ndryshojnë ligjin dhe të thonë: “buxheti i shtetit heq dorë nga financimet e “Radios së Jashtme”, nga financimi për “Shqiptarët jashtë kufijve të Republikës Shqipërisë”, nga financimi për Orkestrën Simfonike dhe nga rinovimi teknologjik i RTSH-së.

Nëse gjatë 30 vjetëve do të ishin dhënë fonde në vite dhe nuk do të kishte prapambetje historike të trashëguar, nuk do të kishim këto kërkesa sot dhe RTSH-ja do të ishte në një pozitë më të mirë me tregun radioteleviziv. Mungesa e investimeve ka bërë që deri para një viti ne të transmetonim apo të prodhonim programe në formatin 4 me 3 në SD, kur transmetimet janë 16 me 9 në HD. Këto makina janë që nga koha e themelimit të Radiotelevizionit Shqiptar në vitet 1967-1970. Sot jemi në një pozitë më të mirë, sepse nuk kemi financuar shumë programe, kemi ndërtuar me mjete rrethanore një autobus në HD, prodhojmë në HD dhe vitin tjetër mendojmë të prodhojmë autobusin tjetër në HD.

Logjika e vjetshme ishte që të kërkonim në mënyrë të arsyeshme. Ne e besuam dhe thamë: “po, në mënyrë të arsyeshme është gjysma e buxhetit që ne kërkojmë dhe po mbajmë vetëm këto prioritate.”. Çfarë ndodhi? Ndodhi që u hoqën të gjitha.

Prioritet është orkestra, e cila, ose do të mbahet, ose do të shkurtohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, do të mbyllet.

Pra, ose do ta mbajmë, ose do ta heqim. Çfarë duhet të themi? Nëse buxheti nuk do të paguajë kontratën e shërbimit që ka marrë përsipër, të cilën e ka detyrim me kompaninë gjermane, ne do ta fikim muksin e dytë, sepse nuk kemi ndër mend të mbajmë me transmetime televizionet private. Do të shikojmë llogaritë ekonomike të RTSH-së. Nëse do të fiket muksi i dytë, do të ngelen pa transmetim 54 televizione private, por nuk kemi rrugë tjetër. Nëse buxheti i shtetit nuk do të paguajë para për transmetimet satelitore, ne do t'i mbyllim dhe do të ngushtohemi me aq para sa kemi.

Kërkesat tona nuk janë luks dhe prioritetet janë përcaktuar. Ne nuk lëvizim asnjë qindarkë të tyre, sepse janë prioritete urgjente.

Tjetra, programet dhe lajmet nuk duhet të financohen nga qeveria, sepse nëse do të ishte kështu, ne do t'i shërbenim qeverive. Ne i kërkojmë popullit rritjen e kontributit të tij në programet e RTSH-së, që RTSH-ja të garantojë financimin e programeve të veta, të garantojë blerjen e programeve cilësore dhe pavarësinë e vetë nga politika. Me detyrimet që janë, për mua ka vetëm një rrugë: që ligji të ndryshojë, qeveria të mos ketë detyrim për të ndihmuar RTSH-në dhe ne të ndërpresim transmetimin ose t'i përgjigjemi ligjit dhe të na jepni financimet që duhen. Nëse nuk jeni të kënaqur me menaxhimin e RTSH-së, parlamenti e shkarkon Këshillin Drejtues në moment. Një Këshill Drejtues i ri shkarkon edhe drejtorin dhe cakton një drejtor tjetër, që di ta bëjë më mirë punën, por ligji do të zbatohet një për një për financimet.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

E kuptuam.

Ne do të marrim një vendim për ta çuar në Komisionin e Ekonomisë të gjithë shtesën që ju kërkon. E kuptojmë se nuk mendoni që keni nevojë për *intermediar* në negociim, doni të jeni vetë në front të parë, por do ta diskutojmë.

Kam përshtypjen se disa detyra, pavarësisht nga buxheti, nuk mund të jenë të rrezikueshme dhe duhet të mendojmë për alternativa. Me këtë buxhet duhet të bëjmë më të mirën. Ndër vite buxheti është ulur pak, po ta krahasojmë me vitin 2017, por nëse e krahasojmë me vitin 2019, ka rritje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E keni shkruar ju.

Po ta mbajmë fiks te ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Mungesë incizimi)...

Etleva Kadcaj - ... i shkurtuar nga buxheti i paraqitur në muajin gusht. 61 milionë lekë janë ndryshuar brenda këtyre 2 muajve. Kjo është ulja që ka pësuar buxheti.

Thoma Gëllçi – Pa na vënë në dijeni.

Etleva Kadcadej - Në vitin 2019...

Thoma Gëllçi – I vitit 2020.

Milva Ekonomi – Nga planifikimi.

Ndërkohë, kam përshtypjen se nuk është një ngjarje e re. Buxheti është gjithmonë i negociueshëm, përderisa vjen në parlament.

Thoma Gëllçi – Tjetra, që dua të theksoj, sepse thashë edhe më parë, por më doli nga mendja sërish ...

Milva Ekonomi - Tek tabelat që keni sjellë, po ta mbajmë fikse, projektet teknike dhe investimet në mirëmbajtje, në vitin 2017 kanë qenë 665 milionë lekë, në vitin 2018 kanë qenë 665 milionë lekë, në vitin 2019 kanë qenë 624 milionë lekë. Për vitin 2020 parashikimi është 634 milionë lekë.

Etleva Kadcadej - Minusi 70 milionë lekësh, që është te vlera e investimeve, u takon investimeve të prapambetura të vitit 2018 dhe do të kalojë si vlerë automatikisht për borxhin që ne i kemi kompanisë private. Domethënë, viti 2019 fillon me zero investim dhe minus 10 milionë lekë nga të ardhurat e RTSH-së. Investimi për vitin 2020 del zero.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, po të shikoni se si ndërtohet buxheti afatmesëm, jo vetëm për RTSH-në, sepse mbase duhet të keni pak më shumë njohuri teknike për disa gjëra, më falni që e them këtë, por ne që jemi të interesuar për një komunitet të caktuar, sikurse secili nga deputetët është i interesuar për një komunitet të caktuar, zakonisht një investim merr vitet e kryerjes. Domethënë, fillon në vitin a dhe mbaron në vitin d, ku çdo vit ka një sasi parash që jepen për atë investim, pavarësisht se ka një plan fillestar.

Pandi Madhi – Ta sqarojmë këtë gjë.

Çështja është e thjeshtë. Në buxhet ishin parashikuar 100 milionë lekë për blerje pajisjesh. Pajisjet u blenë, por lekët nuk u paguan. Më 30 dhjetor, me akt normativ, u shkurtuan nga buxheti 100 milionë lekë, që ishin për RTSH-në. Borxhi vazhdon, sepse nuk u dhanë as në vitin 2019. Pra, në vitin 2020, edhe nëse i jepen 70 milionë, sërish duhet të paguajë me të ardhurat e veta, që të shlyejë detyrimin, sepse ka hyrë në konflikt me furnizuesin dhe procedurat janë bërë. Pra, duhen paguar lekët për pajisjet. Për atë bëhet fjalë. Kjo është historia. Buxheti ka ende borxhet e veta.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ne tashmë e kemi të qartë se si është situata.

Gjithsesi, do të jemi në kontakt gjatë periudhës që do të kalojë projektligji në parlament.

Punë të mbarë dhe faleminderit që transmetoni kur ne jemi në seancë!

(Mungesë incizimi.)

Mbyllet pika e pestë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

6.Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Eduard Makri – Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë,

Arben Lami - drejtor i Drejtorisë së projekteve në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë,

Marjela Zajmi - shefe e Sektorit të Shërbimeve dhe Financës në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë,

Shqiponja Dauti - juriste në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.

Vijon pika e gjashtë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Kur diskutojmë buxhetin, na rrëmben biseda me këdo që kemi para nesh në sesionin dëgjimor.

Kemi thirrur në dëgjësë ministren e Arsimit dhe ministren e Kulturës, që janë të rëndësishme për ju. Nuk kemi marrë asnjë informacion për shtesat që kanë parashikuar ato në buxhet, kështu që, me shumë dëshirë, jemi të gatshëm të dëgjojmë çfarë opinionin keni ju për buxhetin, çfarë mendoni, për çfarë kërkon t'ju mbështesim, pse e kërkon, si mendoni se do të kryhet?

Tjetra, për projektbuxhetin në komision ne kemi vendosur të punojmë në dy forma:

E para, kemi caktuar një relatore për buxhetin, që është procedurë e zakonshme, sepse e keni dëgjuar edhe vitin e kaluar, të paktën, kur kam qenë unë. Relatore është zonja Lindita Nikolla.

E dyta, çdo koment juaji duhet të vijë me shkrim në sekretarinë e komisionit.

Ju keni dërguar një informacion me shkrim. Nëse keni nevojë ta përmirësoni apo të bëni shtesa, kini parasysh që keni kohë deri të dielën, sepse do të kalojë diskutimi në parim i projektbuxhetit.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Eduard Makri – Para së gjithash, faleminderit për ftesën!

Lajmërimi erdhi me ngut, të them të drejtën, kishim diku 24 orë kohë. Materialin e kishim gati, por nëse do ta dinim që në fillim se mund të bënim disa shtesa, ndoshta mund t'i kishim parashikuar më parë.

Mua më quajnë Eduard Makri, meqenëse nuk njihem me të gjithë ju. Jam kryetari i ri i Qendrës.

Para se të lexoj materialin, dua të them se platforma ime e re në Qendër ka sjellë disa ndryshime, duke përfshirë ndryshimet ligjore, që do të ndodhin shumë shpejt në të ardhmen. Synimi i platformës sime për këtë mandat 4-vjeçar është të këmbëngulim drejt rritjes së cilësisë. Shqipëria është në një fazë të re të kinematografisë, sepse tani po ballafaqohet me botën. Ballafaqimi është i tillë që, në rast se nuk ke prodhime kinematografike cilësore, je në një pozicion inferior, në njëfarë mënyre, sepse do të seleksionohesh jashtë strukturave, jashtë financimeve e të tjera.

Platforma ime kryesisht synon në dyja drejtimet kryesore: në rritjen e cilësisë së prodhimeve kinematografike; në fuqizimin e prezantimit të filmit shqiptar në botë. Për fat të mirë, kemi pasur disa suksese, të cilat, në njëfarë mënyre, kanë qenë pjesë e rastësisë. Ndërkohë, këto suksese unë dua t'i bëj pjesë të sistemit, të mënyrës së funksionimit të Qendrës.

Në ndryshimet që kanë ndodhur deri tani, të cilat janë mbështetur te ligji i vjetër, është mënyra e zgjedhjes së Bordit dhe veçanërisht marrja pjesë e të huajve për herë të parë, që nga krijimi i Qendrës, në Bordin e seleksionit të projekteve. Pra, ka disa ndryshime për mirë. Nëse unë do të përdor një krahasim, Shqipëria ka pak a shumë “fshatin e vetë kinematografik”, ku të gjithë i njohin të gjithë. Bordet propozoheshin nga shoqatat, duke krijuar një klimë jo shumë objektive, jo në të gjitha rastet, por në përgjithësi kishte një mungesë objektiviteti në gjykimin e projekteve. Ne menduam ta ndryshojmë këtë gjë, për të sjellë një ndryshim më të mirë dhe më objektiv në përzgjedhjen dhe në cilësinë e projekteve. Nuk do të flas më gjatë, sepse ju do të bëni pyetje dhe do të lë kohë për përgjigjet. Do të lexoj materialin që keni edhe ju përpara, veçanërisht pjesën e parë, që është e rëndësishme, sepse pjesa tjetër është më e thjeshtë.

E nderuar zonja Ekonomi,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Qendra Kombëtare e Kinematografisë, si i vetmi institucion i specializuar në vend, që harton dhe zbaton politikat kinematografike dhe mbështet ekonomikisht prodhimin e filmit në Republikën e Shqipërisë, paraqet para jush kërkesën për rritjen e buxhetit, duke iu referuar argumentimeve që vijojnë:

Kinematografia shqiptare ndodhet në një moment kyç të zhvillimit të saj. Kjo rrjedh nga liria dhe demokratizimi i krijimtarisë, nga ballafaqimi me kinematografinë europiane dhe botërore, si dhe nga krijimi i mekanizmave të rinj ligjorë-ekonomikë, që do të rrisin buxhetin e financimit të kinematografisë shqiptare nga burime të tjera alternative. Aktualisht, kjo aplikohet në vendet e Ballkanit dhe të BE-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ekzistenca e strukturave të sipërpërmendura në vendet e BE-së dhe në Ballkan kabërë të mundur që këto rajone të kenë një kinematografi të zhvilluar, të suksesshme, të mirëfinancuar dhe të disiplinuar për sa u përket mekanizmave ligjore dhe ekonomike. Ky është fakt. Unë e kam verifikuar dhe e them me përgjegjësi, që Shqipëria ka buxhetin më të vogël krahasuar me vendet e Ballkanit dhe të Europës, përfshi këtu dhe Kosovën. Kjo ka ndikuar keq në potencialin e bashkëprodhimeve shqiptare, të cilat nuk kanë fuqi ekonomike të krijojnë një kusht të barasvlershëm financiar me prodhimet e vendeve të tjera, pavarësisht disa sukseseve në festivalet e ndryshme ndërkombëtare të viteve të fundit.

Unë do të bëj një parantezë të vogël, që ta kuptoni më mirë ku qëndron mosbarazpesha e prodhimeve. Unë jam anëtar i Euroimazhit dhe përfaqësoj Shqipërinë, kur diskutohen projekte të nivelit europian dhe ballkanik. Vihet re një problem, i cili është bërë i dukshëm tashmë. Vendet perëndimore, si Gjermania, Norvegjia, Finlanda e të tjera, që kanë buxhete të fuqishme, bashkëpunojnë shumë mirë me njëra-tjetrën, sepse, për shembull, një vend vendos gjysmë milioni dollarë, tjetri vendos 700 mijë, tjetri vendos 800 mijë dhe e kanë më të lehtë. Në një bashkëpunim të tillë ne do të shikonim, për shembull, nëse ata do të vendosnin gjysmë milioni dollarë, le të themi, por shifrat janë aproksimative, ne do të vendosim diku më pak se 100 mijë dollarë. Ata nuk kanë asnjë interes të bëjnë bashkëpunim me ne, ndërkohë që ne nuk kemi fuqi ekonomike në këtë bashkëpunim. Këtë po e them për ta kuptuar në parim. Ne kemi futur *majority compediction*. Pra, ka aplikime, që ata marrin *majority* në një vend tjetër dhe aplikojnë për *majority* këtu. Po flas për projekte shqiptare. Nëse *majority* në një vend tjetër është 200 mijë dollarë, te ne nuk e kalon 50 mijë dollarëshin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në euro.

Mosfinancimi i kinematografisë krijon një lloj racizmi financiar, i cili më vonë bën një presion në prezantimin e kulturës sonë. Pra, unë e kam ngritur këtë çështje edhe në Euroimazh dhe kam propozuar disa mekanizma, për të cilat do të ngrihen grupe pune për t'i përmirësuar. Çfarë ndodh? Nuk ka kultura të mëdha dhe kultura të vogla. Të gjitha kulturat kanë vlerat e tyre, të gjitha kinematografitë kanë vlerat e tyre. Ka kultura të njohura, kultura të panjohura, kultura të mirëfinancuara, të pakfinancuara ose të keqfinancuara. E bëra këtë parantezë, në mënyrë që të keni një ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga ana tjetër, lind si domosdoshmëri standardizimi i procedurave të ne në harmoni me sistemet ballkanike dhe europiane, për ta bërë sa më të lehtë bashkëpunimin kinematografik. Ne, gjithsesi, po bëjmë përpjekjet tona dhe do ta përfundojmë këtë proces ndoshta në 3-mujorin e parë të vitit që vjen, ku do të standardizojmë procedurat tona të aplikimit me Ballkanin dhe me Europën, në mënyrë që kineastët ta kenë të lehtë të aplikojnë në të gjitha vendet, pa pasur probleme burokratike, si të thuash.

Në këto kushte, platforma e re e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, e orientuar drejt cilësisë së prodhimeve kinematografike dhe njohjes së filmit shqiptar në arenën ndërkombëtare, po sjell nevojën për disa ndryshime të rëndësishme në ligjin për Kinematografinë. Këto ndryshime do të përfshijnë edhe futjen e mekanizmit ekonomik të taksës *ree bay* dhe do të ndihmojnë në tërheqjen e prodhimeve të huaja kinematografike në

Shqipëri. Interesimi për këto projekte është shumë i lartë nga kompanitë e huaja prodhuese, edhe sot që ne nuk e kemi këtë gjë.

Kam dy fjalë për të shtuar këtu.

I gjithë rajoni i Ballkanit dhe Europa, pak a shumë, e kanë këtë sistem. Vendi ynë dhe Kosova jemi të vetmit që nuk e kemi. Kosova po e përgatit tashmë. Në përgjithësi, nga eksperiencia europiane dhe ballkanike kjo taksë *ree bay-ti* do të thotë se nëse vjen një kompani kinematografike e huaj dhe sjell mbi 150 mijë dollarë amerikanë, le të themi, këtë limit do të vëmë ne, në mënyrë që të mos vijnë gjëra të vogla, që nuk kanë asnjë vlerë dhe, në momentin kur është verifikuar që subjekti nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, pra nuk ka projekte me dhunë, nxitje të urrejtës e të tjera, në momentin kur është pro Kushtetutës së vendit ku vjen, pra në Shqipëri, në momentin kur vërtetohet se ai shpenzon këto para në Shqipëri, i kthehet 30%-shi. Këtë e ka bërë gjithë rajoni. Kemi shembuj, veçanërisht në Kroaci, por edhe në Greqi. Greqia, në një mbledhje ku isha së fundi, e bëri 50%, pra e rriti në mënyrë të tillë që të jetë më konkurrenente. Duke e ditur që janë vende, të cilat funksionojnë në bazë të turizmit, automatikisht këto lloj politikash kanë një inkurajim për kinematografinë në vendet e tyre.

Pra, ideja është kjo: duke qenë se Shqipëria është një vend shumë i mirë turistik, arkeologjik, ka fabrika të vjetra të mbetura nga koha e komunizmit, që në rast se mund të përdoren me qëllime të ndryshme, grupe të ndryshme, në vend të investonin miliona për t'i ndërtuar, i kanë gati dhe me një qira që u intereson, vijnë e i përdorin. Këto gjëra ecin në mënyrë paralele. Në qoftë se turizmi në Shqipëri rritet... Ne po bëjmë një skemë, ku të lidhet turizmi i vërtetë shqiptar me publikun që do të ndjekë filmat shqiptarë. Për shembull, në qoftë se në Shqipëri është 2 milionë, do të shkojë 3 milionë, 4 milionë, 5 milionë. Njerëzit që vijnë, hanë bukë këtu dhe e njohin kulturën shqiptare. Në qoftë se në vendet e tyre do të dëgjojnë se ka një film shqiptar, do të jetë e pamundur të mos e kthejnë kokën dhe të mos jenë të interesuar për kulturën shqiptare, për të parë një film shqiptar.

Pra, ne po bëjmë një platformë që t'i lidhim këto të dyja në mënyrë logjike, si të thuash, të bëjmë të ndjeshme tregjet e huaja, që krijohen për arsye të tjera, me kinematografinë shqiptare.

Në këtë sens, le të themi, mekanizmi i *tax rebate*-it... Ne do të bëjmë një paketë dhe do t'i sjellim të gjitha aty, sepse kështu ndodh edhe në Europë, edhe në...

Ecja, mekanizmi i mekanizmave ligjorë dhe ekonomikë të kinematografisë, kalon në disa standarde dhe, në fund, si në Francë, përfundon në Kodin e Kinematografisë, siç është Kodi Ligjor, Kodi Rrugor, Kodi Penal... Të gjitha këto kanë një kod, ku të gjitha gjërat e

kinematografisë mblidhen aty. Ky është synimi për të ardhmen. A do të ndodhë në këta 4 vjet? Do të dojë pak kohë, por ky është synimi strategjik dhe afatgjatë.

Kthehemi te buxheti.

Tavanet e programit buxhetor afatmesëm nuk i përmbushin nevojat më të domosdoshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, e cila paraqet para jush kërkesën për rritje të buxhetit, duke iu referuar argumenteve që vijnë.

1. Shtesë fondi për projektin e rimbursimit të pjesshëm të investimeve të produksioneve të huaja, ku zhvillohen xhirime filmi në territorin e Republikës së Shqipërisë, në shumën 40 milionë lekë.

Pra, edhe para se ta miratojmë këtë ndryshim ligjor, tani nuk ka asnjë pengesë ligjore që ata të vijnë, ata vijnë pa marrë asnjë lloj kompensimi, sjellin paratë e tyre, i shpenzojnë këtu dhe ikin.

Çfarë ndodh? Në këtë mes ne duhet të kemi një shtesë minimale, në mënyrë që, nëse këta vijnë, ta kemi këtë fond, të mos i pengojmë dhe ata të mos tremben, sepse në qoftë se ata vijnë një herë dhe nuk e marrin këtë fond, ikin. Kështu do të krijohet ideja që është për Shqipërinë, se aty nuk investohet; aty shkon, por nuk i merr këto gjëra apo nuk ka mekanizma, kur, në fakt, duke qenë se jemi të rrethuar nga vende ku kjo funksion, nuk duhet të japim një shembull të keq në këtë pikë, sepse e kemi para punën që vjen.

Ideja e këtij projekti është që fillimisht të realizohet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe të krijohet një ofertë stimuluese, por, siç e thashë, ne do të mundohemi ta superojmë këtë gjë, ta fusim në ligj dhe të sjellim paketën ligjore, ta kalojmë njëherësh, në një kohë më të shkurtër dhe në mënyrë me efektive.

Duke iu referuar eksperiencave më të mira kombëtare, që kanë të bëjnë me politikat lehtësuese dhe nxitëse ndaj bizneseve të huaja, që investojnë në territore të caktuara, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka studiuar mundësinë e implementimit të këtyre skemave edhe në vendin tonë, me qëllim thithjen e investimeve të huaja në fushën e kinematografisë, veçanërisht, kur ata vijnë, po jap si shembull rastin e Sllovenisë...

Milva Ekonomi – E kemi rregulluar me ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Nga Ministria e Kulturës ka ardhur propozimi. Ky komision e ka miratuar. Edhe në parlament është miratuar peizazhi kulturor dhe peizazhi artistik. Kështu që, këtë problem të parë e keni të tejkaluar. Ne jemi familjarë me këto terma, ngaqë kemi punuar me atë ligj.

Eduard Makri – Shumë mirë.

Megjithatë, ky 30-përqindëshi, *tax rebate*, duhet të shprehet në mënyrë të tillë, sepse ka një lloj fature ekonomike, që pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë mirë, do të kombinojë me ta. Ne thjesht po themi që ky është synimi ynë, për ta bërë *de facto* këtë, që të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është gjynah që nuk është një i Ministrisë së Financave, sepse në të gjithë botën kjo funksionon në mënyrë të tillë, që këto gjëra kalojnë nëpërmjet Ministrisë së Financave. Madje, në disa vende është thjeshtuar sistemi në mënyrë shumë efikase, ku mbasi kalojnë në Ministrinë e Financave, angazhohet një bankë çfarëdo e nivelit të dytë dhe brenda një muaji nga data e mbarimit dhe verifikimit të dokumenteve të parave të shpenzuara në një vend të caktuar, Ministria e Financave direkt bën rimbursimin 30% nëpërmjet një banke të nivelit të dytë. Këtë e përdorin me shumë sukses Finlanda dhe Belgjika.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deri tani kanë ardhur 4, në mos gabo. Një po xhiron aktualisht në Gjirokastrë. Është një kompani ruse në një projekt të prapambetur dhe tani po punon. Kanë qenë dy filma amerikanë, që pak a shumë kanë mbaruar, me sa di unë. Janë gjermanë, janë edhe 2-3 që janë në proces për të ardhur. Faktikisht, këta kanë ardhur pa qenë në fuqi *tax rebate*-i. Mund të kishin ikur në Maqedoni, në Greqi e në vende të tjera, ku është *tax rebate*-i. Nga ana kompetitive nuk kanë asnjë arsye pse të vijnë këtu, por vijnë sepse interesohen për peizazhin tonë.

Ka edhe një lloj kompensimi tjetër. Duke qenë se industria kinematografike nuk e ka të barazuar tregun për pagesat e grupit të filmit në rajon, atëherë ata bëjnë balancat e tyre, në këtë mënyrë kursejnë pak dhe, si të thuash, humbasin nga ana tjetër. Ndërkohë, në të ardhmen kjo nuk do të ndodhë më, sepse me ardhjen e shumë grupeve të xhirimit, në njëfarë mënyre, kur ne të mos kemi njerëz për t'i përballuar këto, do të marrim nga Mali i Zi, nga Kosova dhe pagesat do të barazohen. Kështu që, i vetmi element konkurrimi do të jetë *tax rebate*-i. Këtë nuk duhet ta harrojmë. Në qoftë se do të ketë një sulm të këtyre kompanive, që vijnë për të përfituar, por edhe për të realizuar prodhimet e tyre, në një moment të caktuar ne mund të ndodhemi në një krizë. Po erdhën 5 kompani, ne mund të mos kemi...

Milva Ekonomi – Në qoftë se do të ishte bërë *tax rebate*-i 30%, siç mendoni ju, sa do të kishte qenë kontributi i shtetit në këtë rast? Kthimi mbrapsht i këtyre kompanive, sa do t'i...?

Eduard Makri – Varet nga sasia e parave që ata sjellin këtu, se mund të ketë prodhime që janë... Ne kemi vënë...

Milva Ekonomi – A keni ndonjë ide të përafërt?

Eduard Makri – Ajo varet nga...

Për shembull, sa është prodhimi rus...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – *Tax rebate*. Ardhja është 2 milionë apo *tax rebate*-i?

Arben Lami – 2 milionë është *tax rebate*-i. Pra, duke hequr 30-përqindëshin, i shtohet... Ata që kanë 30-përqindëshin do të marrin te ky 2-milionëshi, që mund të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjatë gjithë vitit.

Ne mendojmë të futet taksa *cash rebate* edhe te bashkëprodhimet. Për shembull, ne sot kemi një film rus që po xhiron në Gjirokastër. Ai vjen me një buxhet më të madh se ne. Në këtë rast mund të marrësh më pak *cash rebate*, por është e domosdoshme...

Eduard Makri – Do të ulim përqindjen.

Arben Lami – ...se në çdo lloj bashkëprodhimi është njësoj sikur vjen edhe një kompani tjetër, që xhiron jo me bashkëprodhues, plus që edhe qeveria e ka këtë çështjen e punësimit. Në ardhjen e këtyre janë dy gjëra, se nuk e vendosin... Vendi ynë thotë gjithmonë se nuk ka investime. Investimi i filmit është shumë i shpejtë. Për 3 muaj mbaron një film ose për 2 muaj mbarojnë xhirimet e çdo gjë. Imagjinoni që brenda një muaji të futen në punë dhe të ketë investime të huaja për një vit me një shumë tepër të madhe! Mund të vijë një film amerikan, që mbase nuk mund t'i japim...

Eduard Makri - Ka ardhur në Kroaci, faktikisht.

Arben Lami – ... thjesht *cash rebate*, se mund të vijë me 20 milionë apo me 100 milionë dollarë. Këto duhet të merren të gjitha parasysh. Për shembull, sot kanë ardhur për të xhiruar filmin “Skënderbeu”. Ai fliste për 300 milionë dollarë, kishte vetë... Çfarë përgjigje t’u japësh atyre?!

Eduard Makri – Greqia, për shembull, në një mbledhje që isha unë, në një formulë që kemi, South Easter Cinema Network, në parlamentin e saj, megjithëse është në krizë, tani po del, mesa duket, e rriti në 50 milionë euro fondin e filmave të huaj që vijnë. E ka rritur rreth një javë apo dy javë më parë. Pse? Sepse e di që kjo është njëra nga mënyrat për të fuqizuar industrinë kinematografike dhe se është vend turistik. Ajo e di që filmi i fuqizuar do të shfaqet tek të gjithë turistët që vijnë në Greqi, që kanë...

Nga ana tjetër, ne mendojmë që *tax rebate*-in ta vëmë edhe për paratë private të shqiptarëve, por më ulët, në mënyrë që t’i interesojmë ata të financojnë në kinematografinë e tyre.

Një mënyrë tjetër, që ne do ta parashikojmë në paketën ligjore që duhet të bëjmë... Ne kemi probleme të mëdha. Televizionet, mediet, platformat, shfaqin filma shqiptarë, veçanërisht

të prodhuar para viteve '90, pa paguar asnjë lek. Nxjerrin fitime të mëdha nga këto dhe nuk paguajnë asnjë lek, qoftë lekë që të shkojnë në thesarin e shtetit dhe nga këto të përcaktohet që një pjesë e tyre të vijë në buxhetin e kinematografisë. Buxheti i kinematografisë nuk rritet vit për vit. Unë mendoj gjithmonë mënyrat e tjera alternative.

Një ide tjetër është kjo: mekanizmi kinematografik vepron në mënyrë të tillë që sjell të ardhura në thesar. Mua, si kryetar i Qendrës, ne duhet të bëjmë propozime konkrete, nuk më duket e drejtë që të gjitha këto të ardhura që sjell sistemi të shkojnë vetëm në thesar dhe asnjë pjesë e tyre, qoftë në një përqindje të caktuar, nuk shkon si shtesë buxheti çdo vit në financimin e filmit shqiptar. Prandaj jemi në këtë gjendje, se kur qeveria, le të themi, nuk ka mundësi të rrisë buxhetin për kinematografinë, në njëfarë mënyre, ne jemi të varur nga rritja ose jo e buxhetit, ndërsa kur ka mekanizma alternativë të miratuar dhe ligjorë, buxheti rritet në mënyrë alternative vazhdimisht, pra, si të thuash, ndodh diçka në buxhet. Gjithsesi, të gjitha këto do të vijë me shkrim.

Po ju jap edhe një shembull tjetër, që ta dini. Shembujt jepen për gjërat që janë realizuar. Në Kroaci, kompania që bëri "Lord of the rings" pa gjithë terrenin, shkoi në Maqedoni, për pak sa nuk qëndroi në Maqedoni, erdhi në Greqi, për pak sa nuk qëndroi në Greqi, dhe duke parë që sistemi ligjor i Kroacisë ishte shumë i mirë, investoi 10 milionë dollarë në një vend dhe xhirooi filmin. Çfarë ndodhi me ata tani? Sa të mençur janë! Dekori, që u ngrit për "Lord of dhe rings", u la tek ai fshati, që mori miliona dollarë, sepse vajti gjithë grupi... U la si objekt turistik dhe vazhdon të shfrytëzohet e të nxjerrë para. Po jap një shembull se si funksionon për shtetet që janë të mençura dhe thithin... Kjo ka ndodhur rreth 3-4 vjet më parë dhe vazhdon të gjenerojë të ardhura edhe sot e kësaj dite. Ky ishte një shembull, që është realitet dhe tashmë ka dhënë rezultatin konkret. Nuk po themi që është një aspiratë dhe mund të ndodhë, por ka ndodhur dhe funksionoi.

Këtë gjë e bën edhe Hollivudi. Për të gjithë filmat e mëdhenj milionadollarësh, ju e dini shumë mirë, ata krijojnë kënde për fëmijët, që, mbasi e kanë parë filmin, shkojnë me gjithë familjet dhe i mbajnë setet, i vizitojnë dhe ata vazhdojnë të nxjerrin të ardhura.

Po japim disa shembuj. Në rajonin e Puljas, në Itali, investohen rreth 50 milionë euro në vit nga xhirimet e filmave të huaj apo rasti i Kroacisë, që e përmenda.

Në rastet e sipërpërmendura, si dhe në rastet e ngjashme, të ardhurat direkte nga investimet e xhirimeve janë njëra anë e medaljes, ndërkohë, ana tjetër, aspak për t'u neglizhuar, është benefiti në aspektin e promocionit të territorit me konsekuencë të pashmangshme në rritjen e turizmit kulturor dhe tregut kinematografik.

Vijmë te pika 2. Kërkojmë një shtesë fondi për projektin “Festivali i 14-të mbarëkombëtar i filmit shqiptar”, në shumën prej 3 milionë lekësh.

Festivali i 14-të mbarëkombëtar i filmit shqiptar, përveçse një manifestim tradicional i vlerave të filmit shqiptar, është menduar të jetë një stacion shumë i rëndësishëm i analizës dhe i ballafaqimit të sfidave dhe problemeve të vështirësisë që ka kinemaja sot në këtë konkurrencë të re, ku po hyn dhe në këtë luftë që bën për të ruajtur fytyrën e vet kombëtare. Festivali i fundit është bërë në 2012-n. Tani jemi në 2019-n. Për 6 vjet nuk ka pasur një festival filmi, ndërkohë që prurje ka çdo vit. Ka shumë prurje dhe ideja është që ky festival të bëhet i përvitshëm, sepse ka filma shqiptarë që bëhen edhe në rajon dhe ne duam ta grumbullojmë dhe ta ballafaqojmë gjithë këtë kinema të rajonit që ndodh këtu te ne.

Ky event është menduar të jetë në tri shtylla kryesore: shfaqja dhe konkurrimi i filmave shqiptarë; tryeza e debatit nëpërmjet kineastëve, lidhur me nivelin e filmit shqiptar, problematikat dhe vizionin për të ardhmen, si dhe organizimi i masterklasave të ndryshme me kineastë të të gjithë brezave dhe me emra shumë të njohur lektorësh të huaj në kinematografinë europiane dhe botërore.

Pra, festivali do të shërbejë edhe si një prurje eksperience konkrete, jo thjesht për të bërë një aktivitet, por një shkëmbim eksperience konkrete, që do të ndikojë direkt në cilësinë e prodhimeve të ardhshme.

Kam edhe pak dhe do të mbarojmë.

Ky do të jetë dhe synimi i këtij aktiviteti masiv, në të cilin garantojmë që me një financim modest të realizohet në nivel shumë dinjioz.

Sukseset e reformës që kemi ndër mend të ndërmarrim, që nga ndryshimet ligjore e krijimi i mekanizmave të rinj, si modeli më i mirë në vend i politikave kulturore, sigurisht, kanë pasur ndikimin e vet edhe në këtë ecuri.

Tashmë kineastët kanë privilegjin, me gjithë buxhetin e vogël që jepet për ta nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, i cili, siç thashë, mbetet më i vogël në Ballkan, të kenë institucionin e tyre dhe tashmë po kuptojnë një filozofi të tyre, që, përveç fondeve që marrin nga shteti, duhet të lëvizin vetë. Ne po i edukojmë të lëvizin vetë dhe të bëhen aktivë edhe në bashkëpunimin me Ballkanin dhe Europën, në ndërtimin e formulave efikase të prodhimit kinematografik. Kjo është shumë e rëndësishme.

Iniciativat dhe realitetet e reja të krijuara së fundi në fushën e edukimit të kineastëve të rinj, ballafaqimi, sfidat dhe mundësitë e zgjerimit të tyre, do të kenë një vëmendje dhe një kujdes të veçantë gjatë këtij aktiviteti. Është koha që publiku të ketë një aktivitet, ku të ndihet që filmi shqiptar po e kalon krizën dhe ka filluar të shënojë rritje.

Për sa më sipër, gjatë diskutimit të projektbuxhetit do t'ju lutesha të merrni në konsideratë kërkesën e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, që në vlerën totale të buxhetit prej 164,3 milionë lekësh të shtohet edhe fondi prej 27 milionë lekësh në buxhetin e vitit 2019! Kjo rritje e buxhetit do të ishte sinjali më i mirë që mund të japë qeveria në mbështetje të punës sonë dhe vizionit të përbashkët që kanë gjithë kineastët, të cilët kanë mbështetur reformën në kinematografi.

Gjithsesi, ne nuk kemi parashikuar ato që thatë ju, që, në njëfarë mënyrë... Pra, është kërkesa më minimale që mund të bëjmë. Ne do të këshillohemi edhe një herë dhe në qoftë se ekziston mundësia që thatë ju, që ne mund të bëjmë ndonjë korrigjim apo...

Milva Ekonomi- Ne...

Mbarojeni, pastaj...!

Eduard Makri – Mbarova. Kjo ishte.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ne nuk e kemi fuqinë për të ndryshuar buxhetin tuaj, sepse atë e ka në dorë vetëm Ministria e Financave dhe diskutimi që bëhet në Komisionin e Ekonomisë. Ne kemi në dorë të llojmë për disa çështje për të cilat ju keni nevojë.

Lobimin që kërkuat për çështjen e festivalit të filmit, ne e kemi ndjekur edhe vjet. Edhe kërkesën për të pasur më shumë fonde për t'i *merge*-ur me kompanitë ndërkombëtare, e kemi ndjekur edhe vjet dhe komisioni ynë ia ka çuar si kërkesë Komisionit të Ekonomisë. E kemi të qartë, prandaj e njohim. Edhe te peizazhi e dimë sa i rëndësishëm është. Kemi informacion për këtë dhe kur të mbarojmë dëgjesat e para për ta kaluar në parim projektbuxhetin, me siguri, së bashku me zonjën Nikolla, do të bëjmë gati një mendim të përgjithshëm të komisionit për kërkesat që mund t'i bëjmë Komisionit të Ekonomisë. Do t'ju vëmë një dijeni për këto gjëra. Pa merak fare!

Edhe për dijeninë tuaj, në komision kemi të ftuar në mënyrë permanente Ministrinë e Financave. Deri tani kanë qenë dy përfaqësues të Ministrisë së Financave, që nuk janë mbrapa jush, për fat të keq, kanë qenë më parë, por për këto që diskutuam bashkë, mikrofonat bëjnë të mundur të regjistrohet çdo fjalë dhe procesverbali i zbardhur i shkon Ministrisë së Financave. Kështu që, mos kini merak as për këtë! Do të jetë pak më e vonshme marrja e informacionit, por informacioni shkon.

Eduard Makri – Përveç kësaj, do të doja të lobonit edhe për një gjë tjetër, që është shumë e thjeshtë dhe, si të thuash, nuk kërkon energji ekstra. Në këto ndryshime ligjore, që ne po kërkojmë të bëjmë, nga eksperiencia ime, vonesat më të mëdha zakonisht na kanë ardhur nga Ministria e Financave. Është normale, sepse çdo ndryshim ligjor ka një efekt ekonomik

dhe ata detyrimisht do ta shohin këtë dhe shumë mirë bëjnë. Në njëfarë mënyre, ky është vizioni dhe filozofia juaj, e cila ndihmon Ministrinë e Financave të kuptojë më mirë kërkesat tona, që të ecim para. E kam fjalën kryesisht për paketën ligjore që do të sjellim, ku do të përfshihen të gjitha këto, në mënyrë që kjo të kalojë shpejt, sepse në qoftë se një ligj nuk kalon shpejt, ngadalësohet vënia e tij në praktikë dhe ngadalësohen proceset që lidhen me të. Vetëm kaq.

Milva Ekonomi – Mos kini merak!

Faleminderit shumë!

Punë të mbarë!

Mbyllet pika e gjashtë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

7.Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit ”Për Buxhetin e Vitit 2020” me Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Marenglen Verdhi – Kryetar i Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Vijon pika e shtatë e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri - Për arsye se nesër do të kemi një seancë plenare të paparashikuar, e cila u vendos sot në Konferencën e Kryetarëve, menduam që seancën dëgjimore të ditës së nesërme ta kalojmë sot.

Vijojmë me seancën dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Akademinë e Studimeve Albanologjike. I ftuar është akademiku profesor, doktor Marenglen Verdhi.

Profesor, mirë se erdhët!

Ne kemi marrë shkresën e Akademisë dhe jemi njohur me problematikat dhe kërkesat që keni shfaqur lidhur me buxhetin e vitit 2020.

Fjala për ju, profesor!

Marenglen Verdhi – Unë e di që problematika financiare është e vështirë për të marrë zgjidhje.

Fillimisht dua t’ju falënderoj të gjithëve!

Është e disata herë që marr pjesë në këtë komision dhe të them të drejtën ndjehem shumë i kënaqur që jam mirëpritur. Pavarësisht përkatësive partiake të këtij komisioni, kam gjetur mirëkuptim dhe jam i lumtur që kemi marrë vlerësime për punën tonë.

Shumë herë nëpunësit që merren me financat, shkurtimet i bëjnë në adresën tonë, por këtu ju kam paraqitur disa nga gjërat që do të kenë impakt.

Në qoftë se vendi e shikon si strategji zhvillimin e turizmit, me materialet arkeologjike dhe etnografike që disponojmë, përkatësisht mbi 80 mijë eksponate dhe mbi 30 mijë eksponate në njërin apo tjetrin rast, mund të shërbenin për të krijuar 2 muzeume jo vetëm në nivel ballkanik, por edhe në atë europian.

Ne kemi një muze didaktik që ka rreth 2 mijë e 100 eksponate, por imagjinoni që 80 mijë të tjera ndodhen në fond dhe vazhdimisht shtohen nga ekspeditat arkeologjike.

Duhet thënë, ndoshta me shumë mungesa, përveç pagave, vitet e fundit ne kemi pasur një buxhet që në rastin më të mirë ka arritur rreth 270 milionë lekë të vjetër. Po të llogarisësh që 70-80 shkojnë vetëm për rojet, të cilët i kemi në të tria godinat, për fat, një godinë e paguan

Akademia e Shkencave, pasi është pjesë e asaj strukture ndërtimore, na mbetet të paguajmë vetëm dy palë roje.

Në drejtimit e tjera, po të llogaritësh që po shtohen botimet, nga 10, 15 po arrijmë në 30, 40 edhe 50 botime në vit, po të marrësh parasysh që ato botime duhet të bëhen në mënyrë cilësore një pjesë, si rasti i albumeve, rasti i botimeve të arkeologjisë e raste të tjera, për të qenë të barasvlershme si cilësi botimesh me botimet më të zakonshme që nxjerrin të gjitha shtëpitë botuese, kuptohet pastaj se çfarë mbetet për honorare, udhëtime, shërbime, dieta, deri te zëvendësimi i një kompjuteri apo gjëra më të rëndomta, si lapsi, letra e të tjera.

Mund t'ju them që në aspektin financiar jemi vërtet shumë keq, sepse vjet, shifrën e së cilës e kam parasysh, rreth 6 milionë e 800 mijë lekë të vjetër, e kishim për shërbime dhe dieta për konferencat jashtë apo brenda vendit që, po t'i pjesëtosh për profesoratin tonë, i thonë treçerek dite jashtë vendit, apo dy ditë shërbim brenda vendit, janë shifra të pamjaftueshme. Është angazhimi dhe pasioni i njerëzve që ndonjëherë udhëtojnë edhe për të plotësuar kriteret për profesor apo asistent profesor dhe nisen për udhëtime jashtë vendit me paratë e shtëpisë për të pasqyruar arritjet shkencore.

Lidhur me përshkrimin që u kam bërë artikujve 231 dhe 602, mund të shikoni që në rastin e dytë ne kemi marrë më pak se 40 % të asaj që na duhet; përpiqemi gjithmonë të mos e teprojmë me një laps kursimtar gjirokastriti.

Duke pasur parasysh se ku duhet të bëhen shpenzimet, dhe ju i dini vetë vlerësimet që do të bëni për ato që kemi parashtruar, shfrytëzoj rastin për të thënë nja dy gjëra që nuk duan para, por ndoshta gjej mirëkuptimin tuaj për të më ndihmuar: ne kemi gati 200 tituj shkencorë dhe cilësorë të realizuar nga botimet e viteve të fundit në Sektorin e Albanologjisë. Në kuadrin e asaj që libri të shkojë te studenti, nismë e fundit, të shkojë te bibliotekat, ne kemi arritur t'i shpërndajmë këto edhe në institucionet kryesore, ndoshta edhe me një farë guximi, se mundet që ndonjë audit i çuditshëm të na e quajë shkelje, në Kryeministri, në Kuvend, në Presidencë, në Ministrinë e Arsimit dhe të njëjtat institucione edhe në Kosovë i kanë marrë prej nesh. Ndërkohë, kemi bërë të njëjtën gjë edhe me institucionet arsimore të larta publike brenda vendit dhe në Kosovë, nëpërmjet marrëveshjeve të shkëmbimit të shumë gjërave, ndër të tjera dhe të literaturës. Po çajmë me vështirësi dhe i kemi propozuar disa kërkesa ministrisë, që e njëjta gjë të bëhet edhe me 50-60 gjimnazet kryesore të Shqipërisë që kanë potencial dhe biblioteka, që libri të shkojë edhe tek ata.

Unë do të shkoja edhe pak më tutje, te bibliotekat e qyteteve, 50 apo 60, po të fusim edhe minibashkitë e Tiranës, ndoshta shkojnë 70-80, ne jemi gati falas, vetëm të mos quhet shkelje që edhe në adresë të tyre ta çonim këtë material, madje do të shkoja edhe më tutje, te Ministria e Diasporës dhe Ministria e Jashtme, por duke rritur buxhetin që do të vijë, në mënyrë që botimin tonë ta bënim me një tirazh më të madh, sepse jemi në minimumin e lejueshëm, ndonjëherë edhe 200 kopje, për të kursyer dhe për të botuar më shumë tituj. Në vend që miqve të Shqipërisë ambasadat t'u dhurojnë një qeleshe të qëndisur, për shembull, t'u dhurojnë një album etnografie apo arkeologjie, që do të kishte impakt dhe do të tregonte kulturën tonë kombëtare dhe arritjet e shkencës sonë.

Pra, nëse duhem këshilluar me ndihmën tuaj për të bërë ndonjë kërkesë, më thoni ta bëj, se në këtë punë di më pak se si duhet vepruar sesa për punën për të cilën jemi mbledhur në institucion. Unë jam gati të bëj çdo hap administrativ të mbështetur ligjërisht.

Një gjë që do të kishte impakt të menjëhershëm është zbatimi i ligjit për honoraret, qoftë edhe sikur të paguhet pjesërisht, pasi edhe në kuotën e pagave jemi në dy herë e gjysmë më pak në krahasim me analogët në Kosovë. Në qoftë se kjo do të zbatohet, atëherë vetëm në këtë mënyrë do të kemi mundësi të diferencojmë aktivët, edhe ata që nuk janë aktivë, t'i bëjmë të tillë. Në këtë mënyrë do të mund të rekrutojmë edhe elemente cilësorë, njerëz që njohin gjuhët e vdekura si latinishtja, osmanishtja e të tjera, por me këto pagesa që bëjmë ne, njerëzit e rekrutuar nga ne, nuk kanë cilësinë e atyre që po largohen me moshë në mënyrë të natyrshme duke u pensionuar. Të paktën kjo levë, të cilën e përdor gjithë bota kapitaliste, pagesa e honorareve, thashë, qoftë edhe pjesërisht, do të bënte që rekrutimet të ishin më cilësore dhe prodhimi ynë të shtohet edhe më tepër.

Kam kënaqësinë të them që me të njëjtat para, nga 10-15 tituj në vit që botonim para disa vjetësh, kemi shkuar në 30-40, ndoshta edhe 50 tituj në vit. Ka edhe çështje të tjera, si, për shembull, zbatimi i legjislacionit për Bordin e Administrimit. Pas demonstratës së studentëve u vendos që ky bord të përbëhet nga 3 të dërguar nga ministria, 3 nga ne dhe një i zgjedhur nga studentët, por ka një vit që kjo nuk funksionon. Me thënë të drejtën, raportet tona me Bordin e Administrimit, nuk kam turp ta deklaroj, nuk janë në nivel si profesori ynë për cilësinë e tyre si studiues. Duhet të kemi mundësinë të veprojmë me një bord funksional, sepse sivjet kemi pasur shumë vështirësi. Ne jemi brenda ligjit të arsimit të lartë dhe ky bord është i domosdoshëm për të miratuar çfarëdolloj gjëje. Sivjet unë kam pasur probleme, pasi mund të dilja me zero libra në ditët e albanologjisë.

Promovimet i bëjmë zakonisht javën e parë të dhjetorit, sivjet i kemi në datën 10 dhjetor, dhe është i mirëpritur kushdo që do të dëshironte për të parë produktin e këtij viti. Ky projekt mund të dështonte, sepse në kushtet që punojmë ne, duhet parë me një sy më realist për të krijuar lehtësi dhe jo vështirësi për produktet tona. Ne ofrojmë maksimalen, duke kërkuar minimalen.

Diçka jua them me bindje, një gjë që sot do të kushtonte 1 lek, mbas 10 vjetësh asnjë s'do të pranojë ta bëjë pa marrë 100 lekë, sepse të gjithë njerëzit po përpiqen t'u përshtaten standardeve ndërkombëtare në këto punë, ndaj edhe ka rrjedhje të trurit e të tjera, gjë e cila na ka ndodhur edhe neve. 10 studiues, disa shumë cilësorë, 4-5 vjetët e fundit kanë ikur në universitetet private, sepse andej paguhen dyfishin e pagës sonë, apo më tepër.

Më falni se ndoshta u zgjata edhe jashtë problemit për të cilin u thirra, por ndjehem mirë për shkak të dashamirësisë që tregoni për t'ju folur më tepër sesa halli për të cilin më thirrët.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor, për prezantimin e kërkesave financiare të Akademisë së Studimeve Albanologjike!

Edhe në shkresën që kemi ndër duar, shohim që investimet ndaj institucionit tuaj kanë munguar prej vitesh, duke filluar që nga kërkesat bazike, si kompjuterat dhe printerat, instrumentet dhe pajisjet e tjera të punës, programet kompjuterike, raftet metalike për bibliotekën dhe arkivat e më tej. Më pas shohim edhe kërkesën tuaj për shpenzimet operative.

Ju siguroj që të gjitha këto kërkesa do të trajtohen në komisionin tonë, do të paraqiten në relacionin përfundimtar dhe do t'i dërgohen Komisionit të Ekonomisë, pasi ne jemi komision për dhënie mendimi. Uroj shumë që të gjitha kërkesat të merren parasysh për një efikasitet më të lartë në punën tuaj.

Marenglen Verdhi – Synimi ynë është që profesorët me një trajtim të kujdesshëm dhe pa ndonjë shpenzim të ndjeshëm nga shteti, në vend që të dalin në pension me 4-5 libra, të dalin me 30 libra. Rezultati për kosto libri dhe për t'i vjelë trurin një profesori që mezi përgatitet, kuptohet që është disa fish rentabël.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

Shpresoj që kërkesat tuaja në buxhetin e vitit 2020 të merren parasysh.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Marenglen Verdhi – Në datën 10 do të bëjmë prezantimin e 30 titujve të librave, ku ju ftoj të jeni pjesëmarrës!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Mbyllet pika e shtatë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 15:20

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

8. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit "Për Buxhetin e Vitit 2020" me ATSH - në.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Përparim Kadiu - shefi i Financës në ATSH.

Vijon pika e tetë e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri - Do të vijojmë seancën dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Agjencinë Telegrafike Shqiptare.

Ftesës i është përgjigjur zoti Përparim Kadiu, shefi i Financës së Agjencisë Telegrafike Shqiptare.

Zoti Kadiu, mund të referoni disa nga kërkesat tuaja për buxhetin e vitit 2020.

Përparim Kadiu – Në radhë të parë, ju falënderoj për ftesën dhe një falënderim vjen për atë çfarë kemi marrë nga ky komision vitin e kaluar. Vitin e kaluar kemi kërkuar një shtesë fondi për digjitalizimin e albumeve fotografike, që është një pasuri e madhe e ATSH-së, na kemi ndihmuar dhe ky proces ka filluar. Kjo gjë është bërë për herë të parë në Shqipëri dhe për këtë merrni falënderime të veçanta nga ne.

Së dyti, unë nuk kam ndonjë kërkesë specifike për vitin 2020, kështu që po i bie shumë shkurt dhe nuk po e lexoj materialin që kam përpara.

Puna e Agjencisë nga viti në vit është relativisht në rritje. Është rritur bashkëpunimi me disa agjenci të tjera. Këto ditë përgatitemi për një konferencë të Aleancës së Agjencive Ballkanike të Lajmeve në fushën e turizmit prej datës 21-23 nëntor. Për zhvillimin e këtyre aktiviteteve domosdoshmërisht kemi pasur nevojë edhe për fonde, të cilat i kemi zgjidhur nëpërmjet Ministrisë së Financave me disa rialokime dhe forma të tjera ligjore.

Së pari, duke ju falënderuar, do t’ju kërkoja që të vazhdonim procesin e digjitalizimit të albumeve, të fotove dhe të gjithë arkivës sonë. Kjo është një ngjarje historike për ATSH-në. Gjatë këtij viti u dha një fond me të cilin po punohet dhe kërkojmë që ky fond të mos përdoret për një vit, se ndoshta edhe mundësitë financiare nuk janë të mundura, por të ndahet në 3 periudha në vitet 2019, 2020 dhe 2021. Të jepet një fond 4 deri në 5 milionë lekë. Këtë vendoseni dhe gjykojeni ju, ne thjesht bëjmë kërkesën.

Kërkesa e dytë është se ne kemi nevojë për rinovimin e teknologjisë. Kemi bazën e kamerave, kompjuterave, pajisjet, serverat, sepse jemi një institucion që punojmë me këto. Për vitin aktual që jemi, nuk kemi pasur asnjë fond për këto investime. Për vitin që vjen është planifikuar një fond prej 1 milion lekësh, që është i pamjaftueshëm. Nëse komisioni do të ketë mundësi, duhet të shikojë që nga viti 2020 deri në vitet 2021-2022 të bëjmë një rinovim total

të teknologjisë me jo më shumë se 3-4 milionë të rinj në vit. Nuk kërkojmë të bëhet menjëherë procesi i rifreskimit të teknologjisë, por të shtrirë në 2-3 vjet, ashtu si procesin e digjitalizimit që e kërkojmë. Kjo është e mjaftueshme. Nuk po flas për gjëra të tjera, pasi i rregullojmë vetë dhe me atë që kemi mundësi i kemi zgjidhur me Ministrinë e Financave.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Kadiu!

(Diskutim pa mikrofon)

Përparim Kadiu – Për vitin 2020 është 69 milionë lekë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ju na dhatë vitin e kaluar fond për dixhitalizimin dhe nuk është dhënë për vitin 2020. Nisi si proces, i morëm 4 milionë, por duhet të vazhdojë të paktën edhe 2 vjet të tjerë që ta mbyllim këtë cikël. Kjo është ndoshta ngjarja më e rëndësishme historike e ATSH-së, sepse dokumentohet nga viti 1930 deri më sot. Ju e dini që arkiva më e vjetër në Shqipëri është ATSH-ja. Nuk e di cila është tjetër.

Për teknologjinë është tjetër gjë, sa të keni mundësi shikojeni. Që nga viti 2012 pothuajse nuk është investuar në teknologji...

Fatjona Dhimitri – Lidhur me këto projekte, si arkivimi i fotografisë apo buletinet e shkruara, për digjitalizimin e tyre do të ishte mirë të kishim një tabelë të zërave të shpenzimeve, në mënyrë që lehtësonim procedurën në momentin që do të hartonim...

Përparim Kadiu – Është vazhdimësia e projektit që kemi pasur. Vjet kemi kërkuar rreth 80-90 mijë euro dhe, meqë ju na dhatë 4 milionë, ky proces nuk duhet të ndërpritet, se ç'kuptim ka po mbeti në vend. Do të bëhet një sasi albumesh, u bë kjo dhe mbetet, por duhet të mbarojnë të gjitha. Ju e dini se çfarë efektesh ka digjitalizimi i arkivës, ia dini vlerën më shumë se unë, ndoshta.

Faleminderit, zoti Kadiu!

Fatjona Dhimitri – Po ashtu, të gjitha kërkesat tuaja do t'i reflektojmë në relacionin që do të hartohet nga komisioni dhe më tej do t'i paraqitet Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës. Urojmë që ju t'i realizoni projektet tuaja, sipas vendimmarrjes në buxhetin e vitit 2020.

Përparim Kadiu – Gjithmonë në bashkëpunim me ju!

Çfarëdo që të jepni, do t'ju themi faleminderit! Po nuk u bë për 2 vjet, do të bëhet për 3 apo për 4, por kjo punë duhet të përfundojë.

Fatjona Dhimitri – Mirë është që të realizohen projektet sa më shpejt dhe brenda afatit kohor.

Përparim Kadiu – Ne mund t'i realizojmë edhe brenda vitit të gjitha këto që thamë.

Fatjona Dhimitri – Për këtë ju nevojiten më tepër fonde. Kjo është arsyeja që sot jeni këtu, apo jo.

Faleminderit!

Nëse nuk ka vërejtje apo diskutime, e mbyllim seancën dëgjimore për ditën e sotme. Ka qenë një ditë e ngarkuar. Nesër do të vijojmë sërish me seancën dëgjimore me rektorët e universiteteve publike, më pas me Akademinë e Shkencave.

Ora e seancave dëgjimore do t'ju njoftohet nga shërbimet e komisioneve.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA

